




Ndjekja penale e krimit të urrejtjes në udhëkryqin midis krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale

UDHËZUES PRAKTIK



osce
ODIHR

Ndjekja penale e krimit të urrejtjes në udhëkryqin midis krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale

UDHËZUES PRAKTIK



***Ndjekja penale e krimit të urrejtjes në udhëkryqin midis
krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër
penale: udhëzues praktik***

Varshavë, 2025 OSCE/ODIHR

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike
dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)
ul. Miodowa 10
00-251 Varshavë

Poloni

www.osce.org/odihr

© OSCE/ODIHR 2025 Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet
lirisht për qëllime edukative dhe të tjera jokomerciale, me
kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me një shpjegim
ku pohohet se burimi është OSBE/ODIHR-i.

ISBN: 978-92-9271-449-9

Dizajni nga Homework



Falënderime

Hartimi i këtij udhëzuesi u mbështet nga **Joanna Perry**, Konsulente Ndërkombëtare për Krimet e Urrejtjes dhe hartuese kryesore, bazuar në intervista individuale të zhvilluara gjatë vitit 2023 dhe takime konsultative të organizuara në shkurt dhe qershor të vitit 2024 në Varshavë, si dhe në një rishikim të tekstit të versionit fillestar të udhëzuesit nga profesionistë të fushës. ODHR-i dëshiron të falënderojë për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre personat e mëposhtëm: **Edo Sujoldžić**, Këshilltar Ligjor Kombëtar, Misioni i OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë; **Alexandre François**, Zëvendës Prokuror Publik dhe Magjistrat Referues për Diskriminimin, Zyra e Prokurorit Publik të Liezhës, Belgjikë; **Aleš Gjašo Hanek**, Ekspert Ndërkombëtar për Krimet e Urrejtjes; **Eszter Polgári**, Drejtore e Programit Ligjor, Shoqata Háttér, Hungari; **Michael Wiener**, Zyrtar për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut; **Juha-Mikko Hämmäläinen**, Ish-Prokuror i Qarkut i dalë në pension, Finlandë; **Eleanor Farrow**, Këshilltare e Lartë për Politikë, Politikë për Krimet e Urrejtjes, Drejtoria për Strategji dhe Politikë, Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, Mbretëria e Bashkuar; **Kalliopi Theologitou**, Zëvendës Prokurore Publike e Gjykatës së Apelit, Athinë, Greqi; **Maciej Młynarczyk**, Prokuror, Zyra e Prokurorisë së Qarkut të Varshavës, Poloni; **Lasha Mchedlishvili**, Prokuror, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Gjeorgjisë; **Aleksandar Markoski**, Prokuror Publik, Zyra e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut; **Maria Teresa Verdugo Moreno**, Prokurore për Krimet e Urrejtjes, Zyra e Prokurorit të Malagës, Spanjë; **Marta Marquina Bertrán**, Njësia për Krimet e Urrejtjes dhe Diskriminimin, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm të Shtetit, Spanjë; **Melissa Sonnino**, Drejtore e Rrjetit Facing Facts, CEJI; **Klára Kalibová**, Drejtore, In iustitia, Republika Çeke.

Udhëzuesi gjithashtu u rishikua nga kolegë përfaqësues të Komisionit Evropian, Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore, Këshillit të Evropës, Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Mostolerancës, Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krime.

PËRMBAJTJE

Hyrje	7
Historiku	10
Pse është i rëndësishëm ky udhëzues	11
Si të përdoret ky udhëzues	14
1. Krimet e urrejtjes dhe “gjuha e urrejtjes” si vepër penale: dallime konceptuale	16
1.1 Krimet e urrejtjes	16
1.2 “Gjuha e urrejtjes” si vepër penale	17
1.3 Pasojat praktike	18
2. Dispozitat ligjore që trajtojnë krimin e urrejtjes dhe “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale	26
2.1 Ndjekjet penale të krimeve të urrejtjes	26
2.2 Dispozitat ligjore që trajtojnë “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale	30
2.3 Veprat penale në udhëkryq	38
3. Pema e Vendimmarrjes së Prokurorit	44
4. Shembuj të ndjekjeve penale në praktikë	56
4.1 Zbatimi i dispozitave të “gjuhës së urrejtjes” për ndjekjen penale të krimeve të urrejtjes	56
4.1.1 Rasti 1	56
4.1.2 Rasti 2	60
4.2 Përdorimi i dispozitave të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale në mungesë të dispozitave përkatëse të krimit të urrejtjes	63
4.2.1 Rasti 3	64

4.3	Raste të përziera: incidentet që përfshijnë krimin e urrejtjes dhe veprat penale të “gjuhës së urrejtjes”	66
4.3.1	Rasti 4	66
4.4	Trajtimi i abuzimit verbal dhe akteve të gjuhës në kufi të krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes”	70
4.4.1	Rasti 5	70
4.4.2	Rasti 6	73
5.	Qasja në drejtësi dhe implikimet mbështetëse për viktimat	78
5.1	E drejta për hetim efektiv	79
5.2	Qasja në mbështetje	80
5.3	Qasja në të drejtat e pjesëmarrjes	80
6.	Zhvillimi i të dhënave dhe politikave	82
7.	Rekomandime	84
Shtojcë: Standardet ndërkombëtare dhe burime mbi “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale		87

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së përgjegjës për dimensionin njerëzor me mandatin për të ofruar ndihmë për shtetet pjesëmarrëse në përpjekjet e tyre për të zbatuar angazhimet në fushën e krimeve të urrejtjes¹. Për këtë qëllim, ODIHR-i ka projektuar dhe zbatuar programe për rritjen e kapaciteteve dhe ofrimin e ndihmës praktike dhe të burimeve për organet e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe shoqërinë civile. Këto mbështesin një qasje gjithëpërfshirëse për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes në përkrahje të viktimave dhe komuniteteve në të gjithë rajonin e OSBE-së².

Gjatë punës së lidhur me krimet e urrejtjes³, ODIHR-i ka konstatuar mangësi të mëdha sa i takon kuptimit nga profesionistët të zbatimit korrekt të ligjeve mbi krimet e urrejtjes, siç dëshmohej nga zbatimi i gabuar i ligjeve mbi “gjuhën e urrejtjes” për të ndjekur penalisht krimet e urrejtjes.

Ky udhëzues plotëson udhëzimet ekzistuese të ODIHR-it mbi ndjekjen penale të krimeve të urrejtjes duke:

- përshkruar dallimet ligjore dhe konceptuale midis krimeve të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale;
- përshkruar pasojat e përdorimit të gabuar të dispozitave mbi “gjuhën e urrejtjes” për të ndjekur penalisht krimet e urrejtjes dhe duke ofruar udhëzime praktike për ta shmangur këtë praktikë; dhe
- dhënë rekomandime për përmirësimin e praktikave në nivel kombëtar.

Ky botim nuk jep udhëzime mbi trajtimin e rasteve individuale të ndonjë forme të “gjuhës së urrejtjes” të parashikuar si vepër penale dhe as nuk sugjeron se cilat forma të sjelljes duhet të kriminalizohen.

- 1 Vendimi i Këshillit Ministror nr. 9/09, “Lufta kundër krimeve të urrejtjes”, OSBE, Athinë, 2 dhjetor 2009; Vendimi i Këshillit Ministror nr. 4/03, “Toleranca dhe mosdiskriminimi”, OSBE, Maastricht, 2 dhjetor 2003. Për një përshkrim të plotë të mandatit të ODIHR-it dhe angazhimeve përkatëse të OSBE-së, shihni [këtu](#).
- 2 Trajnim kundër krimeve të urrejtjes për organet e zbatimit të ligjit (TAHCLE), OSBE/ODIHR, 4 tetor 2012; Trajnim për prokurorët dhe krimet e urrejtjes (PAHCT), OSBE/ODIHR, 29 shtator 2014; Trajnim për krimin e urrejtjes për shoqërinë civile, faqja e internetit e OSBE-së/ODIHR-it për raportin e krimeve të urrejtjes; Paketa Informative kundër Krimeve të Urrëjtjes (INFAHCT), OSBE/ODIHR, 29 gusht 2018; Projekti “Përmirësimi i Mbështetjes së Viktimave të Krimit të Urrëjtjes” (ESTAR), OSBE/ODIHR, 1 janar 2020 deri më 30 prill 2022.
- 3 Kryesisht [raporti vjetor i ODIHR-it për krimin e urrejtjes](#), programet TAHCLE, PAHCT, INFAHCT dhe ESTAR.

Krimet e urrejtjes janë vepra penale të kryera me një motiv paragjykimi⁴. Një krim urrejtjeje ndodh kur autori merr në shënjestër qëllimisht një individ ose pronë për shkak të një ose më shumë karakteristikave të lidhura me identitetin, të tilla si “raca”,⁵ gjuha, feja ose besimi, etnia, kombësia, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, aftësia e kufizuar ose ndonjë tipar tjetër i përbashkët që është thelbësor për identitetin, ose shpreh armiqësi ndaj këtyre karakteristikave të lidhura me identitetin gjatë kryerjes së krimit. Persona ose prona të lidhura me një grup të cilin e bashkon një karakteristikë e lidhur me identitetin - ose të perceptuara si pjesë e këtij grupi - mund të jenë gjithashtu objektiva të krimeve të urrejtjes, si mbrojtësit e të drejtave të njeriut, organizata të shoqërisë civile që punojnë me ose përfaqësojnë një grup të caktuar, qendrat komunitare ose vende adhurimi.⁶

Nuk ekziston një përkufizim i pranuar ndërkombëtarisht i “**gjuhës së urrejtjes**”, megjithatë organizatat ndërqeveritare kanë dhënë udhëzime mbi elementet themelore të fenomenit, i cili mund të përfshijë një gamë të gjerë veprash penale dhe jo penale⁷. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e dënojnë “gjuhën e urrejtjes” dhe diskurset jotolerante,⁸ përfshirë diskurset publike raciste, ksenofobike dhe diskriminuese⁹, dhe kanë theksuar nevojën për të ngritur zërin kundër akteve dhe shfaqjeve të urrejtjes.¹⁰

Gjithashtu, e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (DNDNJ) nuk jep një përkufizim universal dhe ligjor për “gjuhën e urrejtjes”. Kriminalizimi i “gjuhës së urrejtjes” kufizohet rreptësisht nga detyrimi për të baraspeshuar të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim me të drejtën për lirinë e shprehjes, siç garantohet nga neni 19 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP)¹¹ dhe neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹² (KEDNJ). Nxitja e diskriminimit,

4 OSBE, [Vendimi i Këshillit Ministror Nr. 9/09](#).

5 Përdorimi i termit “racë” në këtë udhëzues nuk nënkupton miratimin nga OSBE-ja/ODIHR-i të asnjë teorie të bazuar mbi ekzistencën e racave të ndryshme. Ai është një term i përdorur gjerësisht në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe në legjislacionin kombëtar. Ky udhëzues e përdor këtë term për të siguruar që njerëzit që keqperceptohen se i përkasin një “race” tjetër, të mbrohen nga krimet e urrejtjes.

6 Faqja e internetit e [raportit të OSBE/ODIHR-it për krimin e urrejtjes](#).

7 Shih, për shembull, Strategjinë dhe Planin e Veprimit të OKB-së për gjuhën e urrejtjes, (18 qershor 2019), e cila e përcakton gjuhën e urrejtjes si “**çdo lloj komunikimi** me gojë, shkrim ose sjellje, që **sulmon** ose përdor gjuhë **poshtëruese** ose **diskriminuese** në lidhje me një person ose një grup personash në bazë të **asaj që janë**, me fjalë të tjera, për shkak të fesë, përkatësisë etnike, kombësisë, racës, ngjyrës, prejardhjes, gjinisë ose ndonjë faktori tjetër të lidhur me identitetin e tyre”; dhe [Rekomandimin e Këshillit të Evropës CM/Rec \(2022\)16](#), datë 22 maj 2022 mbi Luftën kundër Gjuhës së Urrëjtjes, Shtojca e Rekomandimit, para. 2: “Për qëllimet e këtij rekomandimi, gjuha e urrejtjes kuptohet si të gjitha llojet e shprehjeve që nxisin, shtojnë, përhapin ose justifikojnë dhunën, urrejtjen ose diskriminimin ndaj një personi ose grupi personash, ose që i denigrojnë ata, për arsye të karakteristikave ose statusit personal të vërteta ose që u atribuohen, si “raca”, ngjyra, gjuha, feja, kombësia, origjina kombëtare ose etnike, moshë, paaftësia, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.”

8 [Vendimi i Këshillit Ministror Nr. 6/02](#), “Toleranca dhe mosdiskriminimi”, OSBE, Porto, 7 dhjetor 2002.

9 [Vendimi i Këshillit Ministror Nr. 13/06](#), “Luftimi i Mostolerancës dhe Diskriminimit dhe Promovimi i Respektit dhe Mirëkuptimit Reciprok”, OSBE, Bruksel, 5 dhjetor 2006.

10 [Vendim i Këshillit Ministror, Vendimi Nr. 10/05](#), “Toleranca dhe mosdiskriminimi: Promovimi i respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë”, OSBE, Lubjanë, 6 dhjetor 2005.

11 [Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike \(PNDKP\)](#), UNGA Res. 2200A (xxi), 16 dhjetor 1966.

12 [Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#), (KEDNJ), Këshilli i Evropës, 4 nëntor 1950.

armiqësisë ose dhunës për shkaqe kombësie, race ose feje ndalohe sipas nenit 20(2) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP)¹³ dhe nenit 4(a) të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KNEDR)¹⁴, nenit 1 të Vendimit Kuadër të Këshillit të BE-së 2008/913/JHA për luftimin e disa formave dhe shprehjeve të racizmit dhe ksenofobisë përmes ligjit penal (Vendimi Kuadër i BE-së)¹⁵, dhe Rekomandimit të Këshillit të Evropës për luftimin e “gjuhës së urrejtjes”¹⁶. Tekstet e këtyre standardeve gjenden në [Shtojcë](#).

Si krimet e urrejtjes ashtu edhe “gjuha e urrejtjes” cenojnë dinjitetin e personave të cilëve u drejtohen dhe krijojnë një mjedis armiqësor dhe poshtërues për grupet e marginalizuara. Ky udhëzues synon të mbështesë prokurorët për të bërë dallimin midis krimeve të urrejtjes dhe formave të “gjuhës së urrejtjes” të përcaktuara si vepra penale, në mënyrë që ata të zgjedhin cilësimin e duhur për veprën e duhur. Ky është një parim themelor për respektimin e së drejtës për një mjet juridik efektiv për viktimat dhe të drejtës për siguri juridike për të pandehurit.

Ky udhëzues është veçanërisht i rëndësishëm sepse, ndryshe nga format e “gjuhës së urrejtjes” të parashikuara si vepra penale, krimet e urrejtjes (dhe mjetet ligjore për t'i trajtuar ato) janë më pak të dukshme për policinë dhe prokurorët. Kjo ndodh për tri arsye kryesore:

- Së pari, në shumë vende, aktet e “gjuhës së urrejtjes” që përbëjnë vepër penale, si nxitja e dhunës dhe urrejtjes, janë të përcaktuara mirë dhe kuptohen si deklaratat themelore kundër disa prej kërcënimeve më serioze ndaj demokracive pluraliste dhe paqes dhe sigurisë. Këto vepra zakonisht janë relativisht më të pranishme në kodet penale dhe më të konsoliduara sesa dispozitat që trajtojnë krimet e urrejtjes. Ato gjithashtu në shumë vende kuptohen si pjesë e pandashme e koncepteve kombëtare për krimet e urrejtjes dhe nuk dallohen nga këto krime në vetvete në politikat dhe planet kombëtare të veprimit.
- Së dyti, krimet e urrejtjes si dukuri janë më pak të dukshme, sepse ato zakonisht shënjestrojnë individë të cilët, siç tregojnë provat, hezitojnë të raportojnë përvojat e tyre te policia¹⁷. Në të kundërt, “gjuha e urrejtjes” zakonisht është publike dhe për këtë arsye ka më shumë gjasa të identifikohet dhe raportohet.
- Së treti, në nivel praktik, ligjet më të zakonshme për krimet e urrejtjes - rritjet e përgjithshme të dënimit - janë më pak të dukshme për

13 OKB, PNDKP.

14 Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, (KNEFDR), OKB GA Res. 2107 (xx), 21 dhjetor 1965.

15 Vendimi Kuadër i Këshillit Evropian të BE-së 2008/913/JHA për luftimin e formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal, 28 nëntor 2008.

16 Rekomandim për Luftimin e Gjuhës së Urrëjtjes, Këshilli i Evropës, CM/Rec (2022) 16, 20 maj 2022.

17 Shih, për shembull, praktikën e regjistrimit të krimeve të urrejtjes dhe mbledhjes së të dhënave në të gjithë BE-në, Agjencia për të Drejtat Themelore e BE-së (FRA), 21 qershor 2018.

profesionistët, pasi ato zakonisht përfshihen në pjesën e përgjithshme të kodeve penale dhe nuk përbëjnë dispozita të veprave themelore. Për këtë arsye, ato nuk përfshihen në akuzë dhe zbatohen vetëm në fazën e dënimit, gjë që ul gjasat që ato të përdoren nga gjykatat.¹⁸ Ligjet më të zakonshme që e parashikojnë “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale kanë formën më të dukshme të veprave konkrete ose themelore në kodin penal dhe, për këtë arsye, policia dhe prokurorët janë më të njohur me to.

Për më tepër, në disa juridiksione, dallimet konceptuale midis krimeve të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale mund të perceptohen si të parëndësishme, sepse të dyja janë forma të kriminalizuara të urrejtjes në legjislacionin e brendshëm dhe, për këtë arsye, kuptohen si krime urrejtjeje. Në vende të tjera, ky dallim është thelbësor, sepse mbrojtjet kushtetuese për lirinë e shprehjes ndalojnë kriminalizimin e shprehjes së pastër pothuajse në çdo formë.

Duke u mbështetur në shembuj të ligjeve dhe praktikave nga mbarë rajoni i OSBE-së, ky udhëzues synon të mbështesë ndjekjen penale efektive, të drejtë dhe profesionale të veprave të krimeve të urrejtjes, veçanërisht aty ku ato ndërthuren me “gjuhën e urrejtjes” të parashikuar si vepër penale, duke rritur në fund qasjen në drejtësi, sigurinë dhe mbështetjen për viktimat, si dhe sigurinë juridike për të pandehurit. Ai plotëson botimet ekzistuese të ODIHR-it të përmendura përgjatë tekstit.

HISTORIKU

Në vitin 2023, ODIHR-i zhvilloi një ushtrim hartëzimi, duke përfshirë prokurorë, politikëbërës dhe avokatë që punojnë drejtpërdrejt me viktimat e krimeve të urrejtjes, ku dokumentoi sfidat e përbashkëta dhe identifikoi nevojën urgjente për udhëzime praktike dhe trajnim. Gjatë një seminari të organizuar në shkurt të vitit 2024, prokurorë dhe avokatë me përvojë në përfaqësimin e viktimave të krimeve të urrejtjes prezantuan raste studimore që përshkruanin aspekte praktike dhe konceptuale që duhet të trajtohen nga ky udhëzues.

Në qershor të vitit 2024, ODIHR-i organizoi një konsultim përfundimtar me përfaqësues të organizatave dhe agjencive ndërqeveritare, si dhe të organizatave ndërkombëtare joqeveritare (ONJQ), për të njohur rritjen e bashkëpunimit në këtë fushë dhe rëndësinë e harmonizimit të qasjeve në nivel ndërkombëtar. Gjatë seminarit u mblodhën komente, ndërsa pjesëmarrësit diskutuan dhe ranë dakord mbi mënyrat për të ndërtuar sinergji dhe për të koordinuar veprimtaritë për rritjen e kapaciteteve dhe monitoruese në fushën e trajtimit të krimeve të urrejtjes.

¹⁸ Kur rritjet e përgjithshme të dënimeve përdoren për të ndëshkuar krimet e urrejtjes, zakonisht merret parasysh çështja e motivit të paragjykitimit në rastet kur autori dënohet. Për një shpjegim dhe diskutim të rritjes së përgjithshme të dënimeve, shih seksionin 2.1.3 të këtij udhëzuesi dhe [ligjet për krimin e urrejtjes: udhëzues praktik, botim i rishikuar](#), OSBE/ODIHR, 23 shtator 2022, f. 59.

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM KY UDHËZUES

Ndërkohë që roli dhe statusi i prokurorëve ndryshon ndjeshëm ndërmjet shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, në të gjitha juridiksionet, prokurorët zënë një pozicion kryesor në sistemin e drejtësisë penale dhe ushtrojnë kompetenca dhe përgjegjësi të konsiderueshme.¹⁹ Prokurorët luajnë rol thelbësor për mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Kur ata vendosin nëse duhet të vazhdojë ndjekja penale dhe mbi cilat akuza, prokurorët duhet të marrin parasysh provat që përcaktojnë se sa rëndë është vepra në fjalë. Identifikimi dhe mbledhja e provave të motivit të paragjykitimit është thelbësore për këto vendime, dhe mosveprimi mbi bazën e këtyre provave është konsideruar si shkelje e standardeve të të drejtave të njeriut.²⁰ Për shembull, në çështjen “Lakatošová dhe Lakatoš kundër Sllovakisë”, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) konstatoi se është detyrë e prokurorit të udhëzojë hetimin për të mbledhur prova të motivit të paragjykitimit dhe për të bërë cilësimin e duhur juridik. Mosveprimi në këtë drejtim u konsiderua si shkelje e nenit 2 në lidhje me nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nga GJEDNJ-ja.²¹ Gjithashtu, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor konstatoi se dënimi penal që nuk merr parasysh në mënyrë të qartë motivin e paragjykitimit të të pandehurit përbën shkelje të së drejtës për mbrojtje efektive dhe mjete juridike kundër diskriminimit.²²

Prokurorët gjithashtu luajnë një rol kyç sa i takon koordinimit me policinë për të siguruar një hetim efektiv dhe mbështetjes së gjykatave për të shqyrtuar natyrën e veprës që u paraqitet dhe faktorët e saj, si motivi i paragjykitimit, që mund të jenë faktorë rëndues ndaj dënimit. Për viktimat, prokurorët luajnë rol thelbësor për identifikimin e nevojave që burojnë nga të qenit shënjestër e urrejtjes ose armiqësisë, si mbështetja emocionale, psikologjike ose praktike dhe kushtet specifike gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre për pjesëmarrje.

Ndjekja efektive penale e krimeve të urrejtjes dhe akteve të “gjuhës së urrejtjes” të përcaktuara si vepra penale kërkon njohuri të thelluara mbi legjislacionin kombëtar dhe njëtrajtshmëri sa i takon cilësimit të duhur të veprave të bazuara në urrejtje. Qartësia konceptuale lidhur me aktet e “gjuhës së urrejtjes” të parashikuara si vepra penale dhe krimet e urrejtjes forcon njëtrajtshmërinë e përgjigjeve në nivel kombëtar dhe përforcohet prej saj. Për shkak të pozicionit të tyre në procesin e drejtësisë penale midis fazave të hetimit dhe gjykimit, prokurorët mund të luajnë një rol përcaktues për sigurimin e kësaj njëtrajtshmërie përmes udhëzimit të hetimeve, si dhe zgjedhjes së saktë dhe, kur është e nevojshme, ndryshimit të

19 Statusi dhe Roli i Prokurorëve, Udhëzues i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Udhëzuesi i Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve, UNODC, Nju-Jork, 2014.

20 “Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë”, çështja nr. 43577/98 dhe 43579/98, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), 6 korrik 2005, §§ 160 e në vazhdim; Demaskimi i motiveve të paragjykitimit në krime: raste të përzgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, FRA, 27 nëntor 2018.

21 “Lakatošová dhe Lakatoš kundër Sllovakisë”, çështja nr. 655/16, GJEDNJ, 11 dhjetor 2018.

22 “Belemvire kundër Republikës së Moldavisë”, CERD/C/94/D/57/2015, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor, 26 tetor 2018, §§ 7.3–8.

cilësimit të akuzave. Kjo qasje gjithashtu vë më në dukje rëndësinë e një përgjigjeje gjithëpërfshirëse ndaj krimeve të urrejtjes në nivel kombëtar dhe mbështet koherencën konceptuale dhe sinergjitë në nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Dispozitat mbi “gjuhën e urrejtjes” të përcaktuara si vepra penale mund të zbatohen në mënyrë të gabuar për të ndjekur penalisht raste të krimeve të urrejtjes aty ku legjislacioni kombëtar për krimet e urrejtjes është i paplotë ose relativisht i dobët. Për shembull, kjo ndodh kur dispozitat ekzistuese përfshijnë vetëm një rritje të përgjithshme të dënimit për të njohur motivin e paragjykit, kur formulimi i dispozitave është i paqartë ose kur përfshihen vetëm një numër i kufizuar karakteristikash të mbrojtura. Disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë mangësi të mëdha në dispozitat e tyre për krimet e urrejtjes, duke zvogëluar kështu gamën e mjeteve të disponueshme për prokurorët kur ata trajtojnë raste të tilla.²³ Dispozita të caktuara, si rritjet e përgjithshme të dënimit,²⁴ mund të shpërfillen, sepse prokurorët nuk janë në dijeni për ekzistencën e tyre, nuk dinë si dhe kur t'i zbatojnë, ose nuk kanë njohuri dhe aftësi për të provuar para gjykatës se si këto dispozita zbatohen për çështjen konkrete. Gjithashtu, gjyqtarët mund të mos jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e rritjeve të zbatueshme të dënimit dhe, për këtë arsye, mund të mos i zbatojnë ato në çështjet përkatëse. Në këto kontekste, dispozitat penale për “gjuhën e urrejtjes” që përfshijnë vepra themelore, si nxitja për urrejtje ose dhunë, janë ndjeshëm më të “dukshme” dhe të aksesueshme për prokurorët dhe gjyqtarët dhe, për këtë arsye, kanë më shumë të ngjarë të zbatohen.

Megjithatë, moszbatimi i saktë i ligjit nënkupton dështimin për të përmbushur qëllimet specifike të synuara nga ligjvënësit kombëtarë për kriminalizimin e veprave të caktuara. Dispozitat e ndryshme penale kanë për qëllim të mbrojnë të drejta, interesa ose vlera të ndryshme, të cilat pasqyrohen në elementet e veprës që duhet të provohen. Për shembull, vepra e nxitjes për dhunë ndaj një grupi të mbrojtur synon të mbrojë pjesë të shoqërisë nga dhuna dhe të parandalojë përshkallëzimin e këtyre veprave në trazira më të gjera publike dhe madje deri në akte të mundshme gjenocidi. Nga ana tjetër, vepra e sulmit të motivuar nga racizmi synon të mbrojë integritetin fizik të viktimës së shënjestruar, e cila është dëmtuar më tej dhe në mënyrë unike nga motivi i paragjykit.

Cilësimi juridik dhe ndëshkimi i saktë i një veprë kërkon një shqyrtim të kujdesshëm të qëllimit të ligjvënësit kur ai miraton dispozitat penale. Në rastet kur ka një mospërputhje midis qëllimit legjislativ dhe praktikës ligjore, mund të cenohet qëllimi i sanksionimit, i cili duhet të jetë proporcional me shkëlqet e autorit. Nëse zgjidhet një cilësim juridik i gabuar, për shembull, duke ngritur një akuzë për nxitje të urrejtjes ose dhunës në vend që vepra të cilësohet saktë si krim urrejtjeje, prokurorët mund të hasin vështirësi për të vërtetuar elementet e kërkuara të veprës,

23 Për shembull, në ciklin e raportimit të krimeve të urrejtjes të ODIHR-it në vitin 2022, dhjetë shteteve iu caktua një vëzhgim kryesor në lidhje me përmirësimin e legjislacionit të tyre për krimet e urrejtjes.

24 Rritjet e përgjithshme të dënimeve janë dispozita dënimi që zbatohen për të gjitha veprat penale që nuk i përfshijnë paragjykimet si një nga elementët përbërës. Shih seksionin 2.1.3 të këtij udhëzuesi.

gjë që mund të çojë në shfajësim për të gjitha akuzat. Nëse akuzat e gabuara vazhdojnë të ekzistojnë pas shqyrtimit gjyqësor, mund të krijohet jurisprudencë e bazuar në përshkrime faktike që nuk përputhen me elementet e veprës së pretenduar. Kjo vë në pikëpyetje ligjshmërinë dhe drejtësinë e proceseve gjyqësore, gjë e cila ka pasoja mbi besimin në sistemin e drejtësisë penale në tërësi.

Përvoja e viktimës mund të jetë e ndryshme në rastet e krimeve të urrejtjes dhe veprave të “gjuhës së urrejtjes”, në varësi të mënyrës se si ato përcaktohen në legjislacionin kombëtar. Cilësimi i krimeve të urrejtjes si “gjuhë urrejtjeje” mund të ushtrojë ndikim mbi rolin e viktimës në proceset penale, duke i lënë ato në disa raste pa mbështetje ose pa qasje në të drejtat e tyre për pjesëmarrje.

PASOJAT E CILËSIMIT TË GABUAR TË KRIMIT TË URREJTJES



CILËSIMI I GABUAR

Nuk arrin të realizojë qëllimin specifik të synuar nga ligjvënësi kombëtar për kriminalizimin e veprave të caktuara.

Dëmton sigurinë juridike për të pandehurit.

Zvogëlon qasjen e viktimave në të drejtat për pjesëmarrje në procese penale.

Rrezikon kufizimin e qasjes te mbështetja dhe mbrojtja e specializuar për viktimat.

Siguron një vlerësim të pasaktë të natyrës dhe nivelit të krimeve të urrejtjes.

Prodhon politika dhe përgjigje ligjore të keqinformuara.



CILËSIMI I SAKTË

Ofron **siguri juridike** për të pandehurit.

Rrit qasjen te të drejtat për pjesëmarrje në procese penale dhe qasjen te mbështetja dhe mbrojtja e specializuar për viktimat.

Përmirëson pasqyrimin e krimeve të urrejtjes në dokumentacionin e policisë, statistikat zyrtare të krimit, politikat kombëtare dhe të dhënat ndërkombëtare, si Raporti Vjetor për Krimet e Urrejtjes i ODIHR-it.

Shërben si bazë informimi për përgjigje strategjike efektive nga autoritetet kombëtare, përfshirë shërbimet e prokurorisë.

Rrit pasqyrimin e një përgjigjeje gjithëpërfshirëse ndaj krimeve të urrejtjes në nivel kombëtar dhe koherencën konceptuale dhe sinergjitë në nivel ndërkombëtar.

Cilësimi i gabuar i veprave çon në prodhimin e të dhënave hetimore dhe ndjekjeve penale që mund të krijojnë një panoramë të pasaktë të natyrës dhe nivelit të veprave të urrejtjes, duke çuar në politika dhe përgjigje ligjore të keqinformuara. Në të kundërt, cilësimi i saktë i veprave të urrejtjes nga prokurorët mbështet një pasqyrim më të mirë të krimeve të urrejtjes në statistika, politika dhe dokumentacionet e policisë, si dhe në të dhënat e raportimit të ODIHR-it,²⁵ dhe kontribuon për përgjigje strategjike më të mira nga autoritetet kombëtare, veçanërisht shërbimet e prokurorisë.

SI TË PËRDORET KY UDHËZUES

Ky udhëzues u drejtohet kryesisht prokurorëve kombëtarë. Ai plotëson udhëzimet ekzistuese të ODIHR-it mbi mënyrën se si të ndiqen penalisht krimet e urrejtjes²⁶ dhe demonstroi dallimet kryesore midis krimeve të urrejtjes dhe veprave penale të “gjuhës së urrejtjes”, duke u përqendruar te veprat e nxitjes për dhunë ose urrejtje.

Udhëzuesi do të jetë gjithashtu i dobishëm për vendimmarrësit, përfshirë politikëbërësit dhe ligjvënësit, për t’i ndihmuar ata të vlerësojnë efektivitetin e politikave, praktikave dhe legjislacionit aktual dhe për të vendosur nëse nevojiten udhëzime specifike operativ kombëtare për prokurorët. Gjithashtu, udhëzuesi mund të ndihmojë organizatat e shoqërisë civile në aktivitetet e tyre këshillimore.

Kreu 1 përqendrohet te dallimet ligjore dhe **konceptuale midis krimeve të urrejtjes dhe veprave penale të “gjuhës së urrejtjes”**, në kontekstin e standardeve ndërkombëtare, duke i kushtuar rëndësi të veçantë “nxitjes për diskriminim, armiqësi ose dhunë”, siç përcaktohet nga neni 20 i KNDKP-së²⁷, dhe ndikimet për strategjitë e ndjekjes penale.

Kreu 2 jep një **përmbledhje të dispozitave të zakonshme ligjore për krimet e urrejtjes dhe veprat penale të “gjuhës së urrejtjes”**, me shembuj.

Kreu 3 prezanton **Pemën e Vendimmarrjes së Prokurorit**, e cila tregon se si duhet të zbatohen dispozitat për krimet e urrejtjes dhe si dallohen ato nga veprat e “gjuhës së urrejtjes”. Ai gjithashtu skicon veprat e tjera përkatëse që ndodhen në ndërthurjen midis krimeve të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale.

Kreu 4 paraqet **shembuj të rasteve studimore mbi këtë fushë komplekse të praktikës së ndjekjes penale**. Shembujt janë marrë nga kontekste të ndryshme kombëtare në rajonin e OSBE-së dhe mbulojnë praktikën e zbatimit të dispozitave

25 Faqja e internetit e raportit të OSBE/ODIHR-it për krimet e urrejtjes.

26 Ndjekja penale e krimeve të urrejtjes, Udhëzues Praktik, OSBE/ODIHR, 29 shtator 2014.

27 OKB, KNDKP.

mbi “gjuhën e urrejtjes” për ndjekjen penale të krimeve të urrejtjes (përfshirë rastet ku mungojnë ligje të zbatueshme për krimet e urrejtjes) dhe cilësimin juridik të gabuar dhe ashpërsinë e veprave të krimeve të urrejtjes. Ky kre shqyrton gjithashtu raste në ndërthurjen midis krimeve të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale.

Kreu 5 përqendrohet te mundësia për të përdorur gjykatat dhe pasojat e lidhura me mbështetjen e viktimave, **përfshirë të drejtën për hetim efektiv** dhe qasjen te të drejtat për pjesëmarrje dhe mbështetje.

Kreu 6 shqyrton rëndësinë e **regjistrimit të saktë të ndjekjeve penale për krimet e urrejtjes** dhe analizon implikimet më të gjera për politikën, si dhe mundësitë për përmirësimin e ndjekjes penale dhe marrëdhënieve me komunitetin në këtë fushë.

Kreu 7 **jep rekomandime** se si të zbatohen këto rekomandime në nivel kombëtar.

1 Krimet e urrejtjes dhe “gjuha e urrejtjes” si vepër penale: dallime konceptuale

Ky kre përkufizon krimet e urrejtjes dhe “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale bazuar në standardet ndërkombëtare. Ai përshkruan implikimet praktike të dallimeve midis këtyre dy koncepteve për prokurorët dhe pse ato kërkojnë përgjigje të ndryshme institucionale, përfshirë sa u përket mundësive për trajnim dhe rritjen e kapaciteteve.

1.1 KRIMET E URREJTJES

Krimet e urrejtjes gjithmonë përbëhen nga dy elemente: një vepër penale dhe një motiv paragjykimi. Elementi i parë është vepra penale: akti duhet të jetë i parashikuar si vepër penale sipas legjislacionit të zakonshëm penal.²⁸ Udhëzimet e ODIHR-it e njohin këtë vepër penale si “vepra bazë”.²⁹ Për shkak të ndryshimeve në dispozitat ligjore që ekzistojnë nga një shtet në tjetrin, ka disa dallime sa i takon llojit të sjelljes që përbën krim. Megjithatë, shumica e shteteve zakonisht kriminalizojnë të njëjtat lloje aktesh të dhunshme. Pothuajse çdo krim i përfshirë në një kod penal mund të jetë një krim urrejtjeje; pa veprën bazë nuk ka krim urrejtjeje.

Elementi i dytë është motivimi: akti penal duhet të kryhet me një motiv të veçantë, të cilit udhëzimet e ODIHR-it i referohen si “paragjykim”.³⁰ Motivimi manifestohet ose në *përzgjedhjen e objektivit* ose te armiqësia e *shprehur* gjatë krimit. Për t’u cilësuar si të tillë, krimet e urrejtjes duhet të synojnë një ose më shumë anëtarë të një grupi ose njerëz ose pronë të lidhur me një grup që ka një karakteristikë të përbashkët. Këto quhen karakteristika të mbrojtura. Një karakteristikë e mbrojtur është karakteristikë e përbashkët e një grupi, si për shembull “raca”, ngjyra, gjuha, feja ose besimi, kombësia, prejardhja kombëtare ose etnike, mosha, aftësia e kufizuar, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual, ose ndonjë veçori tjetër e përbashkët që është thelbësore për identitetin e tyre. Krimet e urrejtjes zakonisht kanë një viktimë të drejtpërdrejtë.³¹

28 Shumë shtete bëjnë dallimin midis krimeve dhe shkeljeve më pak të rënda, të tilla si “kundërvajtjet”, megjithëse ato përshkruhen në mënyra të ndryshme. Në udhëzimin e ODIHR-it, “veprat” u referohen të gjitha dispozitave të ligjit penal; për rrjedhojë, shkeljet administrative janë të përjashtuara.

29 Për shembuj të tjerë të modelit të përzgjedhjes diskriminuese të ligjeve për krimet e urrejtjes, shih OSBE/ODIHR, [Ndjekja e krimeve të urrejtjes](#), seksioni 3.

30 Po aty, f. 15. Shih gjithashtu Këshilli Evropian i BE-së, [Vendimi Kuadër 2008/913/JHA](#), neni 4.

31 OSCE/ODIHR, [Ndjekja penale e krimeve të urrejtjes](#), f. 1.

1.2 “GJUHA E URREJTJES” SI VEPËR PENALE

Neni 20, paragrafi 2 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP) parashikon se: “Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohet me ligj.”³² Ky standard, i përshkruar si “gjuhë nxitëse”,³³ përfshihet gjithashtu edhe në nenin 4(a) të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KNEDR), nenin 1 të Vendimit Kuadër të BE-së dhe në dy standarde të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës: Rekomandimi për luftimin e “gjuhës së urrejtjes” dhe Protokolli Shtesë për Konventën për Krimin Kibernetik, në lidhje me kriminalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike.³⁴ (Shih Shtojcën për tekstet e plota.) Vendimi Kuadër i BE-së udhëzon gjithashtu shtetet anëtare të sigurojnë që përhapja publike ose qarkullimi i traktateve, fotografive ose materialeve të tjera që nxisin urrejtje ose dhunë, si dhe tolerimi, mohimi dhe minimizimi i konsiderueshëm i krimeve ndërkombëtare të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës të parashikohen si vepra penale “kur sjellja kryhet në një mënyrë që ka të ngjarë të nxisë dhunë ose urrejtje kundër një grupi të tillë ose një anëtar të një grupi të tillë.”³⁵

Prokurorë nga shumë juridiksione janë të vetëdijshëm se kodet penale kombëtare përmbajnë dispozita shtesë për kriminalizimin e “gjuhës së urrejtjes”, si shpifja që synon individë ose grupe që kanë një karakteristikë të mbrojtur, fyerjet e motivuara nga paragjykim, si dhe veprat për përhapjen e materialeve të lidhura me urrejtjen dhe mohimin ose minimizimin e krimeve, që nuk kërkojnë kushtin që ato të kenë të ngjarë të nxisin dhunë ose urrejtje. Këto dispozita dhe zbatimi i tyre përshkruhen më tej në seksionin 2.2 dhe në rastet studimore të dhëna në krerët vijues të udhëzuesit.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se veprat e “gjuhës së urrejtjes” që nuk arrijnë pragun penal mund të jenë shumë të dëmshme për viktimat, mund të krijojnë dhe ushqejnë një mjedis armiqësor për komunitetet e marginalizuara dhe mund të kërcënojnë paqen dhe sigurinë shoqërore. Një kuadër i qartë dhe i konsoliduar i mjeteve administrative dhe civile është thelbësor për të luftuar këto efekte të dëmshme dhe për të siguruar kompensim për viktimat. Këto çështje diskutohen në më shumë detaje në seksionet e mëposhtme.

Ky botim nuk jep udhëzime për ndjekjen penale të “gjuhës së urrejtjes” aty ku ajo përbën vepër penale dhe as nuk mbështet kriminalizimin e shprehjes së urrejtjes përtej asaj që përcaktohet në nenin 20(2) të KNDKP-së. Në nivel kombëtar ekziston një larmi e madhe qasjesh sa i takon kriminalizimit të shprehjes, të cilat jo gjithmonë

32 OKB, KNDKP.

33 Një faqe për “nxitjen e urrejtjes”, ZKLDNJ, (pa datë).

34 Shih Shtojcën 1 për fragmentet përkatëse të këtyre standardeve. OKB KNEDC; Këshilli Evropian i BE-së, Vendimi Kuadër 2008/913/JHA; Rekomandim për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes; Protokolli shtesë i Konventës për krimin kibernetik, lidhur me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike, Këshilli i Evropës, 28 janar 2003.

35 Këshilli Evropian i BE-së, Vendimi Kuadër 2008/913/JHA.

përputhen me standardet ndërkombëtare. Një studim i fundit mbi ligjet për shpifjen dhe fyerjen në rajonin e OSBE-së konstatoi se “ligjet penale për shpifjen vazhdojnë të zbatohen në një nivel të caktuar rregullsie në rajonin e OSBE-së, përfshirë kundër mediave.”³⁶ Gjithashtu, është e rëndësishme të vërehen shqetësimet, të shprehura për shembull nga Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për Lirinë e Fesë ose Besimit, në lidhje me formulimin e paqartë të disa dispozitave ligjore kombëtare që synojnë luftimin e nxitjes së urrejtjes, përçarjes dhe mostolerancës.³⁷

Ky seksion shqyrton ndryshimet kryesore konceptuale dhe praktike midis krimeve të urrejtjes dhe “gjuhës nxitëse” për dy arsye. Së pari, standardet ndërkombëtare janë të harmonizuara sa i takon kërkesës ose rekomandimit për kriminalizimin e gjuhës që nxit urrejtje apo dhunë. Nuk ndodh kështu për format e tjera rëndom të kriminalizuara të “gjuhës së urrejtjes” që nuk kërkojnë kushtin e nxitjes së urrejtjes ose dhunës të cilat gjenden në kodet penale kombëtare. Këtu përfshihen vepra të tilla si shpifja, përhapja publike e materialeve të urrejtjes dhe tolerimi, mohimi dhe minimizimi i konsiderueshëm i krimeve ndërkombëtare të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës. Së dyti, pikërisht në këtë kryqëzim ODIHR-i ka konstatuar se, për ndjekjen penale të krimeve të urrejtjes, prokurorët mund të kenë më shumë të ngjarë të përdorin në mënyrë të gabuar dispozitat për nxitjen e urrejtjes ose dhunës.

1.3 PASOJAT PRAKTIKE

Grafiku më poshtë paraqet dallimet e rëndësishme midis veprave të krimeve të urrejtjes dhe veprave të nxitjes për dhunë ose urrejtje, ose “gjuhës nxitëse”, nga perspektiva e profesionistëve.

Zakonisht, pikënisja për një krim urrejtjeje është fakti që, pas një hetimi të plotë dhe mbledhjes së provave, konstatohet se është kryer një vepër penale bazë, si për shembull një kërcënim, sulm, vrasje ose dëmtim prone. Pyetja teknike dhe sfida kryesore është që të vërtetohet se vepra është motivuar nga paragjykimi.

Nga ana tjetër, pikënisja e zakonshme për veprat e “gjuhës nxitëse” është se prania e paragjykimit ose urrejtjes ndaj një karakteristike të mbrojtur është e qartë nga përmbajtja e shprehjes. Pyetja teknike për prokurorët është nëse ka ndodhur një krim; me fjalë të tjera, nëse shprehja e urrejtjes shkon përtej mbrojtjeve të lirisë së shprehjes, e cila është një gur themeli e shoqërive demokratike, dhe nëse ajo tejkalon pragun penal.

36 Scott Griffen, *Ligjet për shpifjen dhe fyerjen në rajonin e OSBE-së: Një studim krahasues*, Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias (RFOM), mars 2017, f. 5.

37 Shih, për shembull, Raportin e Raportuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara për Lirinë e Fesë ose Besimit për Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku Raportuesi i Posaçëm vuri në dukje se neni 319 i Kodit Penal kombëtar dyshohet se ishte keqpërdorur kundër një lideri fetar të caktuar. Shih A/HRC/13/40/Add.2, para. 47. Këshilli Evropian i BE-së, *Vendimi Kuadër 2008/913/JHA*.

ÇËSHTJE KONCEPTUALE NË UDHËKRYQIN MIDIS KRIMEVE TË URREJTJES DHE “GJUHËS NXITËSE”

KRIM URREJTJEJE



PROVA E
PARAGJYKIMIT



VEPËR PENALE

Sfida kryesore në praktikë: Vërtetimi i motivit të paragjykimit.

Objektiv specifik: Synon persona ose pronë specifike të një komuniteti të caktuar ose të lidhur me të / individ që i përket një komuniteti të caktuar (dëmi i shkaktuar mund të jetë më i gjerë).

Vepra bazë: Prokurorët duhet të vërtetojnë elementet e veprës penale bazë (p.sh., sulm, vjedhje, kërcënim, etj.)

“GJUHË NXITËSE”



PROVA E
PARAGJYKIMIT



VEPËR PENALE


Sfida kryesore në praktikë: Përcaktimi nëse gjuha/shprehja mbulohet nga mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe është e ligjshme, apo nëse është e pambrojtur dhe, për rrjedhojë, përbën vepër penale.

Natyra publike: Qëllimi është të mobilizojë/ nxitë të tjerët në urrejtje ose dhunë kundër një grupi/personi specifik bazuar në një karakteristikë të mbrojtur.

Vepra e papërfunduar: Prokurorët duhet të vërtetojnë probabilitetin e arsyeshëm që gjuha ose shprehja shërben për nxitjen e dhunës ose urrejtjes edhe nëse vetë akti ose aktet nuk janë kryer ose nuk do të kryhen kurrë.

Një arsye pse mund të ketë paqartësi për prokurorët nëse ata duhet ta trajtojnë një incident si vepër penale të “gjuhës së urrejtjes”, ose si vepër të krimit të urrejtjes është kur vetë **gjuha ose shprehja është në fakt dëshmi e një paragjykimi ose motivi diskriminues**. Për shembull, kur një dhunues e shan viktimën për racën para, gjatë ose pas sulmit fizik të viktimës. Kjo pikë shtjelohet më tej në rastet studimore.

Jo vetëm që liria e shprehjes me të drejtë shihet si një e drejtë themelore që duhet mbrojtur në çdo demokraci të shëndetshme, por ekziston **një sfidë shtesë kur politikanët ose individët me profil të lartë janë autorë të mundshëm**.³⁸ Prokurorët do të duhet të trajnohen dhe të jenë të njohur me jurisprudencën përkatëse ndërkombëtare dhe kombëtare dhe, aty ku është e zbatueshme, me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe mekanizmave të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara. Sfidat tjera teknike lidhen me faktin nëse mund të sigurohen provat, veçanërisht në lidhje me veprat në internet dhe/ose nëse kërkohet zbatim ose bashkëpunim ndërkufitar.



Udhëzuesi për Politikën e ODIHR-it mbi Lirinë e Fesë ose Besimit dhe Sigurisë³⁹ **inkurajon shtetet që të trajnojnë organet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet gjyqësore për të kuptuar dhe zbatuar testin prej gjashtë pjesësh të përcaktuar në Planin e Veprimit të Rabatit**,⁴⁰ për të përcaktuar nëse përmbushet pragu i nxitjes për dhunë ose urrejtja. Gjatë përcaktimit të kësaj pyetjeje në rastet e shkeljeve të “gjuhës nxitëse”, testi me gjashtë pjesë i udhëzon prokurorët të përcaktojnë: (1) kontekstin e deklaratës/shprehjes, (2) pozicionin ose statusin e folësit, (3) qëllimin për të nxitur një audiencë kundër një grupi të synuar, (4) përmbajtjen dhe formën e deklaratës ose shprehjes, (5) shkallën e përhapjes së saj dhe (6) mundësinë e dëmtimit, përfshirë kur mund të shkaktohet ai.

38 Po aty, shtojcë, para. 36: “Udhëheqësit politikë dhe fetarë duhet të përmbahen nga përdorimi i mesazheve të mostolerancës ose shprehjeve që mund të nxisin dhunë, armiqësi ose diskriminim; por ata gjithashtu kanë një rol vendimtar për të folur në mënyrë të vendosur dhe të shpejtë kundër mostolerancës, stereotipeve diskriminuese dhe rasteve të gjuhës së urrejtjes. Duhet të bëhet e qartë se dhuna nuk mund të tolerohet kurrë si përgjigje ndaj nxitjes së urrejtjes.” Shih gjithashtu [Deklaratën e Bejrutit dhe 18 zotimet e saj mbi “Besimin për të Drejtat”](#), A/HRC/40/58, Shtojca I dhe II.

39 [Liria e Fesë ose Besimit dhe Udhëzimet për Politikën e Sigurisë](#), OSCE/ODIHR, 9 shtator 2019; shih gjithashtu ZKLDNJ, Një faqe mbi “nxitjen e urrejtjes”; Memorandumi shpjegues për CM/Rec (2022)16 mbi Luftën kundër Gjuhës së Urrëjtjes, Këshilli i Evropës, § 32; Fleta e të dhënave – Gjuha e urrejtjes, GJEDNJ, nëntor 2023.

40 [Plani i Veprimit i Rabatit](#), 4 tetor 2012, UN ZKLDNJ, A/HRC/22/17/Add.4.

PERKUFIZIME TË NDRYSHME TË “URREJTJES”



“GJUHA E NXITJES”

Neni 20 i PNDKP-së e përkufizon “urrejtjen” dhe “armiqësinë” si **“emocione të forta dhe jo racionale të përçmimit, armiqësisë dhe urrejtjes ndaj grupit të synuar”**.

KRIMI I URREJTJES

Udhëzimet e OSBE-së: “Në shumë raste të krimeve të urrejtjes, autori **as nuk ndjen “urrejtje” ndaj objektivit të tij** dhe as nuk nxitet nga përvoja që ka me viktimën. Përkundrazi, autori motivohet nga stereotipet, idetë e paramenduara ose mostoleranca ndaj një grupi të caktuar njerëzish dhe karakteristikave të mbrojtura që ata kanë të përbashkëta.”

Përcaktime të ndryshme të urrejtjes përdoren për të përkufizuar veprat e krimeve të urrejtjes në krahasim me veprat e “gjuhës nxitëse”, siç ilustron në grafikun më poshtë.

Kur termat “urrejtje” ose “armiqësi” përfshihen në ligjet kombëtare për krimet e urrejtjes, kuptimi i tyre në fund përcaktohet nga gjykatat. Megjithatë, duke marrë parasysh nevojën për mbrojtje të fuqishme të lirisë së shprehjes kur kriminalizohet shprehja e urrejtjes, kuptimi i termave “urrejtje” ose “armiqësi” zakonisht përcjell një nivel më të lartë të ashpërsisë për “gjuhën nxitëse” krahasuar me krimet e urrejtjes. Për shembull, udhëzimet e OSBE-së shpjegojnë: “Në shumë raste të krimeve të urrejtjes, autori as nuk ndjen “urrejtje” ndaj objektivit të tij dhe as nuk nxitet nga përvoja që ka me viktimën. Përkundrazi, autori motivohet nga stereotipet, idetë e paramenduara ose mostoleranca ndaj një grupi të caktuar njerëzish dhe karakteristikave të mbrojtura që ata kanë të përbashkëta.”⁴¹ Nga ana tjetër, udhëzimet e ZKLDNJ-së mbi nenin 20 të KNDCP-së e përkufizojnë “urrejtjen” dhe “armiqësinë” si “emocione të forta dhe joracionale të përbuzjes, armiqësisë dhe neverisë ndaj grupit të synuar.”⁴²

41 OSBE/ODIHR, [Ligjet mbi krimet e urrejtjes](#).

42 ZKLDNJ, [Një faqe mbi “nxitjen e urrejtjes”](#); [Parimet e Camden-it për Lirinë e Shprehjes dhe Barazinë](#), neni 19, prill 2009, Parimi 12.1 (i).

Dallimi i përkufizimeve të “urrejtjes” në krimet e urrejtjes dhe veprave të “gjuhës nxitëse” është gjithashtu i pranishëm në kodet penale kombëtare që përdorin të dyja, modelin “përzgjedhje diskriminuese” dhe modelin “animus” të legjislacionit për krimet e urrejtjes.

Shembuj të përkufizimeve të ndryshme të “urrejtjes”⁴³ në dispozitat e legjislacionit penal kombëtar⁴⁴

Përkufizime të ndryshme të “urrejtjes” mund të shihen në Kodin Penal të Sllovenisë,⁴⁵ ku dispozitat për krimin e urrejtjes, në formën e një rritjeje të përgjithshme të dënimit, kërkojnë dëshmi të “pirjes” për të kryer një krim bazuar në një karakteristikë të mbrojtur.

Neni 49: Rregulla të përgjithshme për vlerësimin e dënimeve

“[...] (3) Nëse **pirja për të kryer një krim**⁴⁶ bazohet në kombësinë, racën, fenë ose përkatësinë etnike, gjininë, ngjyrën e lëkurës, origjinën, gjendjen financiare, arsimin, pozitën sociale, bindjen politike ose ndonjë bindje tjetër, paaftësinë, orientimin seksual ose çdo rrethanë tjetër personale të viktimës, kjo merret parasysh si rrethanë rënduese.”

Në të kundërt, dispozita e nxitjes së urrejtjes e Sllovenisë kërkon që “urrejtja” etj., të nxitet “publikisht” dhe të përmbajë një prag më të lartë urrejtjeje.

Neni 297: Nxitja publike e urrejtjes, dhunës ose mostolerancës

(1) Kushdo që nxit ose promovon urrejtje, dhunë ose mostolerancë publikisht në lidhje me kombësinë, racën, fenë, përkatësinë etnike, gjininë, ngjyrën e lëkurës, origjinën, gjendjen financiare, arsimin, pozitën shoqërore, bindjet politike ose të tjera, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual, ose ndonjë rrethanë tjetër personale, dhe kryen një veprim në një mënyrë që mund të rrezikojë ose prishë ligjin dhe rendin publik, ose përdor kërcënime, abuzime verbale ose fyerje, dënohet me burgim deri në dy vjet.

43 Për shembuj të tjerë të modelit të legjislacionit të bazuar te “përzgjedhja diskriminuese” për krimet e urrejtjes shih Kreun 2; Mbretëria e Bashkuar: [Seksioni 29 i Aktit për Krimet dhe Mungesën e Rendit 1998](#), Sulmet e rënduara racore ose fetare; Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, [Krimi Racist dhe i Urrëjtjes Fetare – Udhëzimet e Prokurorisë](#), 2022.

44 Ju lutemi mbani parasysh se të gjitha referencat ndaj kodeve penale në këtë kre u referohen kodeve penale në fuqi në datën e botimit të këtij udhëzuesi.

45 [Kodi Penal i Sllovenisë](#), (në sllovenisht, përkthim jozyrtar).

46 Ju lutemi mbani parasysh se përdorimi i shkronjave të zeza të theksuara këtu dhe në të gjitha citimet e tjera në këtë udhëzues janë shtuar nga ODIHR-i dhe nuk përbën pjesë të teksteve origjinale.

Maqedonia e Veriut përdor gjithashtu modelin e “përzgjedhjes diskriminuese” të legjislacionit për krimet e urrejtjes siç përcaktohet në nenin 122 (42) të Kodit Penal të saj.⁴⁷

“Krimi i urrejtjes, i parashikuar shprehimisht në dispozitat e këtij Kodi, konsiderohet krimi kundër një personi fizik ose juridik dhe personave të lidhur me të, ose kundër një pasurie, **i kryer tërësisht ose pjesërisht për shkak të një karakteristike reale ose spekulative (imagjinare, të hame-ndësuar) ose lidhje të personit** dhe lidhet me racën, ngjyrën e lëkurës, kombësinë, origjinën etnike, fenë ose bindjen, paaftësinë mendore ose trupore, seksin, identitetin gjinor, orientimin seksual dhe bindjet politike”.

Sigurisht, ka një larmi qasjesh në të gjithë rajonin. Disa shtete kanë përdorur modelin e “armiqësisë” ose “animus” në hartimin e legjislacionit të tyre për krimet e urrejtjes, duke kërkuar dëshmi të armiqësisë për të provuar krimet e urrejtjes. Për shembull, kur ndjekin penalisht një krim urrejtjeje në Angli dhe Uells, prokurorët duhet të vërtetojnë se vepra ishte ose e motivuar nga armiqësia ndaj një karakteristike të mbrojtur, ose se armiqësia është demonstruar para, gjatë ose menjëherë pas kryerjes së veprës. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë model ligjor, është e rëndësishme të theksohet se udhëzuesi për prokurorinë mbi kuptimin e “armiqësisë” nënkupton një prag të ulët për termin, duke shpjeguar se: “Armiqësia nuk është e përcaktuar në legjislacion. Duhet t’u kushtohet vëmendje përkufizimeve të zakonshme në fjalorë, të cilat përfshijnë keqdashjen, keqardhjen, inatin, paragjykimin, mosdashurinë, antagonizmin, pakënaqësinë dhe mospëlqimin.”⁴⁸

Një tjetër ndryshim kyç lidhet me **elementin publik të “gjuhës nxitëse” në krahasim me krimin e urrejtjes, i cili synon një person, grup njerëzish ose pronë të caktuar**. Në shembullin e një sulmi racist, viktima individuale është objektivi i drejtpërdrejtë i mesazhit të urrejtjes, ndërsa grupi që ajo “përfaqëson” është viktima e tërthortë. Nga ana tjetër, “gjuha nxitëse” synon të mobilizojë ose të nxisë të tjerët kundër një grupi të caktuar, duke ndikuar në këtë mënyrë potencialisht mbi komunitetin më të gjerë të cilit i përket grupi.⁴⁹ Natyra e synuar e krimit të urrejtjes përfshin **gjithashtu aspekte specifike në lidhje me mbështetjen e viktimave**.

Duhet të merret parasysh gjithashtu edhe synimi i ligjvënësit kur në hartimin e ligjeve për krimin e urrejtjes dhe “gjuhën e urrejtjes”, sepse **objekti i mbrojtjes**

47 Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut, (në gjuhën maqedonase, përkthim jozyrtar).

48 Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, Krimi Racist dhe Fetar i Urrëjtjes – Udhëzime për Prokurorinë, 2022. Për shembuj të tjerë të modelit të legjislacionit bazuar te “përzgjedhja diskriminuese” për krimet e urrejtjes, shihni seksionin 3 të këtij udhëzuesi.

49 Këto tipare kryesore të “gjuhës nxitëse” dhe qasjet ndaj kriminalizimit, hetimit dhe ndjekjes penale të tyre trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse në udhëzuesin e ZKLDNJ-së dhe gjashtë testet e pragut të përcaktuara në Planin e Veprimit të Rabatit, të mbështetura gjithashtu në vendimet e GJEDNJ-së.

për krimet e urrejtjes dhe ligjet për “nxitje të gjuhës së urrejtjes” janë të ndryshme. Kjo pyetje, së bashku me marrjen parasysh të parimeve të përgjithshme ligjore, duke përfshirë ligjshmërinë dhe proporcionalitetin, është e rëndësishme kur zgjidhet cilësimi i dhur juridik për një vepër penale. Për shembull, kur shqyrtojnë nëse një akt bie brenda kufijve të krimit të urrejtjes, prokurorët duhet të marrin parasysh nëse autori kishte për qëllim të lëndonte një individ (ose disa individë), të kërcënonte jetën e tyre ose të dëmtonte pronën e tyre, me dëmin e shtuar të një motivi diskriminues. Kur shqyrtojnë nëse një akt bie brenda kufijve të nxitjes, prokurorët duhet të marrin parasysh nëse autori synonte të nxiste publikisht dhunë ose urrejtje kundër grupeve ose individëve të veçantë që kanë një karakteristikë të mbrojtur.

Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të pranohet se “gjuha nxitëse” dhe dispozita të tjera të “gjuhës së urrejtjes” që kriminalizojnë sjelljen përtej asaj që parashikohet nga standardet ndërkombëtare mund të gjenden në të njëjtat kre të Kodit Penal.⁵⁰ Kjo për shkak se ligjvënësit i kuptojnë ato se përfshijnë shprehjen publike të ideve që janë thellësisht fyese dhe lënduese për një pjesë të popullsisë në mënyrë të atillë që mund të kontribuojnë për rritjen e urrejtjes dhe dhunës dhe të kërcënojnë paqen dhe sigurinë sociale, qoftë edhe pa pasur një lidhje me një provokim ose shprehje nxitëse të qartë. Mbledhja e gamës së krimeve të urrejtjes dhe veprave të “gjuhës së urrejtjes” së bashku në kodet penale kombëtare tregon se ligjvënësit i kuptojnë ato si mjete të ndërlidhura në një përgjigje të përgjithshme për të parandaluar dhunën e bazuar në grup, mosmarrëveshjet dhe aktet sociale që minojnë përfshirjen dhe kohezionin shoqëror.

Shembull i dallimit të krimeve të urrejtjes dhe veprave të kriminalizuara të “gjuhës së urrejtjes” në një kod penal kombëtar

Kodi Penal i Republikës Çeke,⁵¹ ka tri dispozita të veçanta që trajtojnë “dhunën kundër një grupi” (krimin e urrejtjes) (neni 352), “shpifjen ndaj një grupi” (“gjuhë urrejtjeje” si vepër penale) (neni 355) dhe “nxitjen e urrejtjes” (“gjuhë nxitëse” si vepër penale) (neni 356) të cilat përfshihen të gjitha nën titullin “Veprat penale që prishin bashkëjetesën”.

Në rastet kur forma të ndryshme të “gjuhës së urrejtjes” mbulohen në të njëjtin nen të Kodit Penal, mund të jetë e vështirë të cilësohet me saktësi sjellja e kryer në një incident të caktuar. Çelësi për prokurorët është që ata të shqyrtojnë me kujdes sjelljen e kryer dhe të synojnë të zgjedhin dispozitën penale më të përshtatshme,

⁵⁰ Shih seksionin 2.2.2 të këtij udhëzuesi.

⁵¹ Republika Çeke, *Zákon trestní zákoník* [Kodi Penal], (në çekisht, përkthim jozyrtar).

duke mbajtur parasysh objektin e mbrojtjes të synuar nga ligjvënësi në kontekstin e standardeve ndërkombëtare.

Së fundi, **“gjuha nxitëse” është një vepër e papërfunduar**, e cila kërkon një strategji të veçantë ndjekjeje penale.

Siç shpjegohet në udhëzuesin e Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ):

“Nxitja, si përkufizim, është një krim i papërfunduar. Veprimi i nxitur përmes “gjuhës nxitëse” nuk është e nevojshme të kryhet në mënyrë që gjuha e përmendur të konsiderohet krim. Megjithatë, duhet të identifikohet një shkallë e rrezikut të dëmtimit. **Kjo do të thotë se gjykatat do të duhet të përcaktojnë se ekziston një probabilitet i arsyeshëm që gjuha e tillë çon në nxitjen e veprimit konkret kundër grupit të synuar, duke pranuar se lidhja shkak-pasojë është mjaft e drejtpërdrejtë.**”⁵²

52 ZKLDNJ, një faqe mbi “nxitjen për urrejtje”.

2 Dispozitat ligjore që trajtojnë krimin e urrejtjes dhe “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale

Ky kre përbëhet nga tri seksione. Seksioni 1 shpjegon elementet kryesore të ndjekjes penale të krimeve të urrejtjes dhe llojet përkatëse të dispozitave ligjore, me shembuj. Seksioni 2 përshkruan dy lloje kryesore të dispozitave të “gjuhës së urrejtjes”: “gjuhën e nxitjes” dhe forma të tjera të “gjuhës së urrejtjes” të përcaaktuara si vepra penale. Seksioni 3 shqyrton aktet kriminale që bien në kufirin e krimit të urrejtjes dhe të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale.

2.1 NDEKJET PENALE TË KRIMEVE TË URREJTJES

Prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm për dispozitat legjislative kombëtare që mbështesin të **dyja** elementet e ndjekjes penale të krimit të urrejtjes: 1) vërtetimin e veprës penale bazë dhe 2) vërtetimin e motivit të paragjykit. Roli i prokurorit për nxitjen e policisë për të zbuluar të gjitha provat e disponueshme të motivit të paragjykit që në fazat më të hershme të hetimit nuk mund të theksohet sa duhet. Pa prova të motivit të paragjykit, të mbledhura nga treguesit e paragjykit,⁵³ shanset për një ndjekje penale të suksesshme ulen ndjeshëm.

Këto dispozita marrin tri forma kryesore: vepra themelore, rritja specifike e dënimit dhe rritja e përgjithshme e dënimit. Është e rëndësishme të theksohet që në fillim se prokurorët kanë disa detyra të rëndësishme ndaj viktimave të mundshme të krimit të urrejtjes, veçanërisht në lidhje me përcaktimin dhe sigurimin e mbrojtjes dhe mbështetjes së duhur. Kjo trajtohet në kreun 5 të këtij udhëzuesi dhe në botime të tjera të ODIHR-it.⁵⁴

53 Treguesit e paragjyqimeve janë “fakte objektive, rrethana ose modele që shoqërojnë një akt ose disa akte kriminale, të cilat, duke qëndruar të vetme ose në lidhje me fakte ose rrethana të tjera, sugjerojnë se veprimet e autorit ishin të motivuara, tërësisht ose pjesërisht, nga çdo lloj forme paragjykimi.” Për më shumë informacion, shihni Pemën e Vendimarrjes së Prokurorit në Kreun 3.

54 Shihni burimet e projektit [eSTAR Rritja e Ndërgjegjësimi të Palëve të Interesit dhe Burimeve për Mbështetjen e Viktimave të Krimit të Urrejtjes](#), OSBE/ODIHR; shih veçanërisht [Viktimat e Krimit të Urrejtjes në Sistemin e Drejtësisë Penale, Një Udhëzues Praktik](#), OSBE/ODIHR, 9 prill 2022.

2.1.1 VEPRAT THEMELORE

Veprat themelore janë vepra të veçanta që përfshijnë motivin e paragjykit si një element përbërës të përkufizimit ligjor të veprës. Ato janë forma më pak e zakonshme e dispozitave ligjore për krimet e urrejtjes në rajonin e OSBE-së.⁵⁵

Shembull i një dispozite të një vepre themelore

Neni 119 (1) i Kodit Penal të Polonisë⁵⁶ parashikon: “Kushdo që përdor dhunë ose bën kërcënime të paligjshme ndaj një grupi njerëzish ose një personi të caktuar **për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare, etnike, racore, politike ose fetare, ose për shkak të mungesës së besimeve fetare** i nënshtrohet dënimit me heqje lirie për një periudhë nga tre muaj deri në pesë vjet.”

Në këto lloj dispozitash ligjore, elementi i parë për ndjekjen penale të krimit të urrejtjes, vepra themelore (“dhuna” ose “kërcënimet e paligjshme”) dhe elementi i dytë, motivi i paragjykit (“për shkak të përkatësisë së tyre kombëtare, etnike, racore, politike ose fetare, ose për shkak të mungesës së besimeve fetare”) përfshihen në të njëjtën dispozitë. Nga këndvështrimi i prokurorisë, veprat themelore paraqesin disa përparësi. Policia ka më shumë të ngjarë të jetë në dijeni të veprave penale dhe për këtë arsye të kërkojë prova të paragjykit; autori e ka të qartë saktësisht se për çfarë akuzohet; dhe, nëse ato akuzat vërtetohen, autori shpallet fajtor për të dyja elementet e veprës penale, duke lejuar transparencë për viktimat dhe komunitetet e prekura. Veprat penale janë gjithashtu shumë më lehtë të identifikueshme në të dhënat e krimit dhe ndjekjes penale, duke lejuar gjurmim më të lehtë në të gjithë procesin e drejtësisë penale.

2.1.2 RITJET SPECIFIKE TË DËNIMIT

Rritjet specifike të dënimit janë dispozita të lidhura me vepra bazë të caktuara. Këto zakonisht përfshijnë vepra të rënda kundër personit, të tilla si vrasja ose dëmtimi trupor. Në kodet penale, rritjet specifike të dënimit shpesh paraqiten si nënseksione të dispozitave që lidhen me veprën bazë dhe kërkojnë vendosjen e një dënimi më të ashpër, për shembull, duke rritur drejtpërdrejt gamën e dënimeve për kryerjen e veprës bazë me një motiv paragjykimi.

⁵⁵ OSCE/ODIHR, *Ligjet mbi Krimet e Urrëjtjes*.

⁵⁶ *Kodi Penal i Polonisë*, (në polonisht, përkthim jozyrtar).

Shembull i një dispozite për rritje specifike të dënimit

Kodi Penal i Ukrainës, neni 115⁵⁷

1. Vrasja me dashje dhe e paligjshme që çon në vdekjen e një personi tjetër, dënohet me burgim për një periudhë nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
2. Vrasja:
(14) e kryer mbi bazën e mostolerancës racore, kombëtare ose fetare, dënohet me burgim për një periudhë nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet, ose me burgim të përjetshëm dhe konfiskim të pasurisë në rastin e parashikuar në nënparagrafin 6 të paragrafit 2 të këtij neni.

Elementi i parë për ndjekjen penale të një krimi urrejtjeje, vepra bazë e “vrasjes”, përfshihet në nenin 115(1), ndërsa elementi i dytë, motivi i paragjykit, përfshihet në nenin cilësues 115(2).

Nga perspektiva e ndjekjes penale, në këto lloje dispozitash ligjore ka një avantazh pasi dispozita është e lehtë për t'u gjetur dhe u ngjan dispozitave për veprat themelore për shkak se motivi i paragjykit është një element përbërës i veprës. Prokurori gjithashtu duhet të përpiqet të sigurojë që policia të jetë e vetëdijshme për nevojën e mbledhjes së provave të paragjykit për të mbështetur një ndjekje penale të suksesshme të një krimi urrejtjeje.

2.1.3 RITJET E PËRGJITHSHME TË DËNIMIT

Në parim, rritjet e përgjithshme të dënimeve zbatohen për çdo krim në kodin penal që nuk e përfshin paragjykimin si një nga elementët përbërës të tij.

Shembull i një dispozite për rritjen e përgjithshme të dënimit

Neni 22 [Rrethanat rënduese] të Kodit Penal të Spanjës⁵⁸

Rrethanat e mëposhtme konsiderohen si rënduese:

⁵⁷ Kodi Penal i Ukrainës, (në gjuhën ukrainase, përkthim jozyrtar).

⁵⁸ Kodi Penal i Spanjës, (në spanjisht, përkthim jozyrtar).

(...)

(4) Kryerja e veprës penale për arsye raciste, antisemite, antirome ose për çdo lloj tjetër diskriminimi që lidhet me ideologjinë, fenë ose bindjet e viktimës, grupin etnik, racën ose kombin ku ai/ajo bën pjesë, gjininë, moshën, orientimin ose identitetin seksual ose gjinor, arsye të gjinisë, aporofobisë⁵⁹ ose përjashtimit shoqëror, sëmundjes që ai/ajo vuan ose paaftësisë së tij/saj, pavarësisht nëse këto kushte ose rrethana janë realisht të pranishme tek personi ndaj të cilit kryhet veprimi (...).

Në këto lloj dispozitash ligjore, në varësi të llojit të veprës penale (p.sh., sulm, vjedhje, vrasje, sulm seksual, etj.), elementi i parë për ndjekjen penale të një krimi urrejtjeje, vepra themelore, mund të gjendet në pjesën përkatëse të Kodit. Për shembull, nëse vepra është një sulm për shkak të racës, elementi i parë për ndjekjen penale të një krimi urrejtjeje do të jetë dispozita që përcakton sulmet fizike në Kodin Penal kombëtar. Elementi i dytë, motivi i paragjykitimit, gjendet në dispozitën për rritjen e përgjithshme të dënimit, në këtë rast, nenin 22 të Kodit Penal të Spanjës.

Kur përdoren rritjet e përgjithshme të dënimeve për të ndëshkuar krimet e urrejtjes, çështja e motivit të paragjykitimit zakonisht merret parasysh gjatë dënimit të autorit. Me fjalë të tjera, autori duhet fillimisht të shpallet fajtor për veprën themelore dhe më pas gjykata shqyrton nëse ka prova të mjaftueshme për paragjykim për të zbatuar një rritje dënimi. Në juridiksionet e së drejtës zakonore, kjo bëhet gjatë fazës së dënimit. Në juridiksionet e së drejtës civile, përcaktimi i fajësisë dhe dënimit nuk janë faza të ndara dhe gjyqtari i shqyrton provat e motivit që ndikojnë në dënim si pjesë e të njëjtit procesi.

Ka disa kufizime të rritjeve të përgjithshme të dënimeve që ulin efektivitetin e tyre si mjet për t'i bërë të dukshme ndjekjet penale për krime urrejtjeje dhe për të ndëshkuar autorët në mënyrë të përshtatshme. Së pari, prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm për ekzistencën e tyre në mënyrë që t'i tërheqin vëmendjen gjykatës. Së dyti, ndryshe nga rritjet specifike të dënimeve të cilat çojnë në ri-cilësimin juridik dhe rrisin ashpërsinë e veprës fillestare, rritjet e përgjithshme rëndojnë dënimin e autorit gjatë fazës së dënimit. Së treti, vendimi përfundimtar i gjykatës mund të mos përmbajë të gjithë arsyetimin për dënimin e vendosur, sepse provat e motivit të paragjykitimit konsiderohen së bashku me faktorët e tjerë rëndues dhe lehtësues të përfshirë në çështje. Së katërti, të dhënat gjyqësore tentojnë të regjistrojnë vendimet sipas dispozitës së kodit penal për të cilën autori shpallet fajtor, duke përjashtuar të dhëna specifike mbi zbatimin e rritjeve të përgjithshme të dënimeve.

59 Aporofobia - qëndrime dhe ndjenja negative ndaj varfërisë dhe njerëzve të varfër.

2.2 DISPOZITAT LIGJORE QË TRAJTOJNË “GJUHËN E URREJTJES” SI VEPËR PENALE

Ky seksion përshkruan dy lloje kryesore të dispozitave penale të “gjuhës së urrejtjes”: “gjuhën nxitëse” dhe forma të tjera të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale. Seksioni nuk ka për qëllim të japë udhëzime për përcaktimin ose zbatimin e dispozitave penale mbi “gjuhën e urrejtjes”. Qëllimi është të ndihmojë prokurorët për identifikimin dhe hartimin e mjeteve ligjore kombëtare të rëndësishme për ndjekjen penale të veprave që lidhen me “gjuhën e urrejtjes”, në kontekstin e standardeve ndërkombëtare, dhe të jenë në gjendje t’i dallojnë ato nga dispozitat për krimet e urrejtjes.⁶⁰

2.2.1 VEPRAT PENALE TË “GJUHËS NXITËSE”

“Gjuha nxitëse” është ajo që nxit publikisht diskriminim, urrejtje, armiqësi ose dhunë kundër një grupi njerëzish ose anëtarëve të një grupi që gëzon një gamë karakteristikash të mbrojtura. Kjo sjellje trajtohet nga një sërë standardesh ndërkombëtare të shpjeguara në Seksionin 1.2 dhe të renditura në Shtojcë.

Siç shpjegohet në Seksionin 1.2, veprat penale të “gjuhës nxitëse” paraqesin sfida teknike të zakonshme për prokurorët, të cilat janë të ndryshme nga veprat e krimeve të urrejtjes. Këto përfshijnë vërtetimin e një veprë të papërfunduar, përcaktimin nëse gjuha është e mbrojtur dhe përcaktimin nëse vepra shkakton nxitje publike. Këto aspekte teknike trajtohen plotësisht në Planin e Rabatit⁶¹ përmes testit me gjashtë pika dhe në Parimet e Camden-it.⁶²

Shembull i një dispozite mbi “gjuhën nxitëse”

Neni 1 [Nxitja e urrejtjes, dhunës dhe dëmtimit të pronës] i Ligjit të Greqisë 927/1979, i ndryshuar me Ligjet 1419/1984, 2910/2001, 4285/2014 dhe 4491/2017⁶³

1. Çdo person që publikisht nxit, provokon ose shkakton, qoftë me gojë ose përmes shtypit, Internetit, ose ndonjë mënyre tjetër, akte dhune ose urrejtjeje kundër një personi ose grupi personash ose një anëtar

60 Siç shpjegohet diku tjetër, ky botim nuk jep udhëzime për ndjekjen penale të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale. Ai as nuk mbështet kriminalizimin e shprehjes së urrejtjes, përtej asaj që përcaktohet nga neni 20(2) i KNDKP-së.

61 OKB ZKLDNJ, [Plani i Veprimit i Rabatit](#).

62 Neni 19, [Parimet e Camden-it mbi lirinë e shprehjes dhe barazinë](#); Shih Shtojcën për detaje të mëtejshme.

63 Shih [Greqia: Ligji i ri kriminalizon mohimin e gjenocidit, gjuhën e urrejtjes dhe aktet e tjera të racizmit](#), Biblioteka e Kongresit, 24 shtator 2014.

të një grupi të tillë të përcaktuar në bazë të racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, karakteristikave gjinore ose aftësisë së kufizuar, në një mënyrë që rrezikon rendin publik dhe ekspozon jetën, integritetin fizik dhe lirinë e personave të përcaktuar më sipër ndaj rrezikut, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet dhe një gjobë nga 5,000 deri në 20,000 euro.

2. Çdo person që publikisht nxit, provokon ose shkakton, qoftë me gojë ose përmes shtypit, Internetit, ose ndonjë mënyrë tjetër, akte shkatërrimi ndaj pasurisë së një personi ose grupi personash të tillë të përcaktuar në bazë të racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, karakteristikave gjinore ose aftësisë së kufizuar, në një mënyrë që rrezikon rendin publik dhe ekspozon jetën, integritetin fizik dhe lirinë e personave të përcaktuar më sipër ndaj rrezikut, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet dhe një gjobë nga 5,000 deri në 20,000 euro.

Është e rëndësishme që prokurorët të jenë të vetëdijshëm për ndryshimet e mëdha në nivel kombëtar se si parashikohen veprat penale të “gjuhës nxitëse” në kodet penale kombëtare dhe se si trajtohen ato në fazat e hetimit dhe drejtësisë penale. Për shembull, Plani i Rabatit vëren një “dikotomi të përhapur” ku (1) autorët e incidenteve që arrijnë pragun e nenit 20 të KNPKP-së “nuk ndiqen penalisht dhe nuk dënohen” dhe ku (2) “persekutimi i pakicave nën maskën e legjislacionit kombëtar për nxitjen” mund të jetë tepër i paqartë.⁶⁴

Për shembull, në raportin e Këshillit të të Drejtave të Njeriut të vitit 2009 mbi Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë⁶⁵, Raportuesi i Posaqëm vuri në dukje se neni 319 i Kodit Penal⁶⁶ ishte, sipas tij, keqpërdorur kundër një udhëheqësi

64 [Plani i Veprimit i Rabatit](#) për ndalimin e avokimit të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë, Përfundime dhe rekomandime nga katër seminarët rajonale të ekspertëve të organizuara nga ZKLDNJ-së në vitin 2011, A/HRC/22/17/Add.4, f. 7, Marok, 5 tetor 2012.

65 [Raporti i Raportuesit Special për lirinë e fesë ose besimit, Asma Jahangir](#), UN HRC, A/HRC/13/40/Add.2, 28 dhjetor 2009, para. 47.

66 [Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut](#), “Neni 319 [Shkaktimi i urrejtjes, mosmarrëveshjeve ose mostolerancës për shkaqe diskriminuese kombëtare, racore, fetare ose çfarëdo arsye tjetër] 1. Kushdo që me dhunë, keqtrajtim, duke vënë në rrezik sigurinë, duke u tallur me simbolet kombëtare, etnike, fetare etj., duke djegur, shkatërruar ose në ndonjë mënyrë tjetër duke dëmtuar flamurin e Republikës së Maqedonisë ose flamurit e shteteve të tjera, duke dëmtuar objektet e njerëzve të tjerë, duke përdhosur monumente, varre, ose në çfarëdo mënyrë tjetër diskriminuese, drejtpërdrejt ose tërthorazi, shkakton ose nxit urrejtje, mosmarrëveshje ose mostolerancë për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë në grupe të marginalizuara, përkatësisë etnike, gjuhës, kombësisë, prejardhjes sociale, besimit fetar, besimeve të tjera, arsimimit, përkatësisë politike, statusit personal ose social, dëmtimit mendor ose fizik, moshës, familjes ose gjendjes martesore, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore ose për ndonjë shkak tjetër të parashikuar me ligjin për marrëveshjen e ratifikuar ndërkombëtare, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”, (në maqedonisht, përkthim jozyrtar).

fetar të caktuar, Peshkopit Jovan (Zoran Vraniskovski).⁶⁷ Në vitin 2004, gjykatat e vendit konstatuan se, duke lënë Kishën Ortodokse Maqedonase dhe duke krijuar Kryepeshkopatën Ortodokse të Ohrit, i akuzuari kishte shkaktuar një përçarje që **shkaktonte urrejtje fetare, përçarje dhe mostolerancë**.⁶⁸ Megjithatë, fakti që ai u dënua për nxitjen e urrejtjes ndaj vetes nga persona me besime të ndryshme u komentua si “befasuese”⁶⁹ pasi “gjuha nxitëse” kërkon qëllimin e folësit për të promovuar urrejtje publikisht ndaj grupit të synuar (Parimi i Camden-it 12.1), domethënë, një marrëdhënie trekëndëshe⁷⁰ midis folësit, audiencës dhe objektivit. ODHR-i, me kontributin e ekspertëve nga Paneli i Ekspertëve për Lirinë e Fesë ose Besimit, gjithashtu shprehu shqetësime për qasjen e gjykatës.⁷¹

Sipas Raportuesit të Posaçëm të OKB-së për lirinë e fesë ose besimit, “rreziku që dispozitat ligjore që ndalojnë “gjuhën e urrejtjes” të interpretohen sipërfaqësisht dhe të zbatohen në mënyrë të përzgjedhur nga autoritetet thekson rëndësinë e të pasurit një gjuhe të qartë dhe hartimin e masave mbrojtëse efektive për të parandaluar keqpërdorimet e ligjit. [...] Pasiguria juridike e shkaktuar nga formulimi i vagullt i dispozitave për nxitje mund të ketë efekt pengues mbi gatishmërinë e individëve për të ushtruar lirinë e shprehjes si dhe lirinë e fesë ose besimit, për shembull duke ushtruar ndikim mbi aftësinë e tyre për të ndryshuar fenë, për të krijuar organizata të reja fetare ose besimi, ose për të shfaqur fenë ose besimin e tyre në adhurim, respektim, ushtrim dhe mësim në përputhje me bindjet e tyre.”⁷²

67 Raporti i Raportuesit Special për lirinë e fesë ose besimit, Asma Jahangir, Shtojcë, Misioni në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, A/HRC/13/40/Add.2, para. 47–48.

68 Gjykata e Shkallës së Parë Manastir konstatoi se Peshkopi Jovan “kishte nxitur urrejtje ndaj tij dhe pasuesve të tij. Revolta dhe mostoleranca që pasoi ishin shkaktuar nga cenimi i ndjeshmërisë fetare të njerëzve, të cilët kishin kërkuar nga autoritetet shtetërore të ndërhyjnë. Madje ai ishte kërcënuar edhe me sulm.” Shih “Vraniskoski kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, Çështja nr. 37973/05, 26 maj 2009. Përkufizimi i punës i shtrembërimit dhe mohimit të Holokaustit, IHRA

69 Heiner Bielefeldt, Nazila Ghanea dhe Michael Wiener, Freedom of Religion or Belief: An International Law Commentary, Oxford University Press, 2016, f. 497.

70 Plani i Veprimit i Rabatit, shtojca, para. 29; Strategjia dhe Plani i Veprimit i Kombeve të Bashkuara për gjuhën e urrejtjes, Udhëzues i Detajuar për Zbatimin për Prezencat në terren të Kombeve të Bashkuara, OKB, 2020, f. 13.

71 Opinion për rastin e Peshkopit Jovan (Zoran Vraniskovski), Opinion-Nr.: ForRB – MK/035/2005, Paneli i Ekspertëve për ForRB/IU, 27 korrik 2005, para. 8.

72 Raporti i Raportuesit Special për lirinë e fesë ose besimit, Asma Jahangir, shtojcë, Misioni në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, A/HRC/13/40/Shtoj.2, para. 48 dhe 60.

2.2.2 VEPRA TË TJERA PENALE TË “GJUHËS SË URREJTJES”

Përveç dispozitave që mbështesin ndjekjen penale të veprave të “gjuhës nxitëse”, disa kode penale kombëtare mund të përmbajnë dispozita për të ndjekur penalisht vepra të tjera të “gjuhës së urrejtjes”. Ky seksion jep shembuj të këtyre dispozitave së bashku me referenca të zgjedhura nga kuadri ndërkombëtar, për të ndihmuar prokurorët si për skicimin e dispozitave të “gjuhës së urrejtjes” si vepra penale në nivel kombëtar, ashtu edhe për dallimin e tyre nga dispozitat për krimet e urrejtjes.⁷³

Veprat e mohimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe minimizimit të konsiderueshëm

Disa vende e parashikojnë mohimin e Holokaustit⁷⁴ si vepër penale pa kërkesën që ajo të çojë në nxitje të urrejtjes ose dhunës. Kjo, për shembull, është në kundërshtim me Vendimin Kuadër të BE-së, i cili parashikon kriminalizimin e këtyre llojeve të veprave vetëm kur sjellja kryhet në mënyrë të tillë që nxit dhunë ose urrejtje kundër një grupi njerëzish ose një anëtar të një grupi të tillë të përcaktuar për shkak të “racës”, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike.⁷⁵

Shembuj të dispozitave të mohimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe minimizimit të konsiderueshëm⁷⁶

Neni 6 i Urdhëresës së Emergjencës nr. 31 të Rumanisë⁷⁷ parashikon se: “Mohimi, kundërshtimi, aprovimi, justifikimi ose minimizimi në mënyrë të qartë me çfarëdo mjeti në publik i Holokaustit ose pasojave të tij dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet ose me gjobë.” E njëjta gjë zbatohet edhe për gjenocidin, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Nëse për kryerjen e kësaj veprë përdoret një sistem kompjuterik, zbatohet dënimi me burg nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Në Francë, Ligji Gayssot⁷⁸ kriminalizon aktin e “kundërshtimit” të krimeve kundër njerëzimit siç përcaktohet në nenin 6 të Kartës së Tribunalit

73 Siç shpjegohet diku tjetër, as ky seksion dhe as udhëzuesi në tërësi nuk japin udhëzime për ndjekjen penale të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale. Ai as nuk mbështet kriminalizimin e shprehjes së urrejtjes, përtej asaj që përcaktohet nga neni 20(2) i KNDKP-së.

74 Përkufizimi i punës i shtrembërimit dhe mohimit të Holokaustit, IHRA.

75 Shih Këshilli Evropian i BE-së, Vendimi Kuadër 2008/913/JHA, neni 1(c) dhe neni 1(d).

76 Mohimi i Holokaustit në të drejtën penale, Raportim i Parlamentit Evropian, janar 2022.

77 Rumani, ORDONANȚA DE URGENTĂ nr. 31 [Urdhëresa e urgjencës nr. 31], 13 mars 2022, neni 6, i ndryshuar me ligjin nr. 217, datë 23 korrik 2015, (në rumanisht, përkthim jozyrtar).

78 France, Loi n° 90-615 du 13 juillet 1990 tendant à réprimer tout acte raciste, antisémite ou xénophobe [Ligji nr. 90-615 i 13 korrikut 1990 mbi shtypjen e çdo akti racist, anti-semitik ose ksenofobik], (në frëngjisht, përkthim jozyrtar).

Ndërkombëtar Ushtarak, bashkëlidhur marrëveshjes së Londrës të vitit 1945. Në Austri, sipas nenit 3h të Ligjit të Ndalimit⁷⁹, kushdo që “mohon publikisht, minimizon, aprovon ose përpiket të justifikojë gjenocidin nazist ose krime të tjera naziste kundër njerëzimit” dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Nëse vepra kryhet në shtyp, në radio ose në një mjet tjetër, ose në një mënyrë që bëhet e aksesueshme për shumë njerëz, ajo dënohet me burg nga një deri në dhjetë vjet. Në rastet më të rënda, dënimi mund të jetë burg nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Veprat e përhapjes publike

Vendimi Kuadër i BE-së gjithashtu udhëzon shtetet anëtare të ndalojnë me ligj përhapjen ose shpërndarjen publike të traktateve, fotografive ose materialeve të tjera që nxisin urrejtje ose dhunë. Megjithatë, kodet penale ekzistuese të shteteve anëtare të BE-së jo gjithmonë kërkojnë që sjellja e përhapjes të nxisë urrejtje ose dhunë. Për shembull, Kodi Penal i Danimarkës përfshin një vepër për përhapjen, e cila nuk lidhet shprehimisht me nxitjen e dhunës ose urrejtjes.

Shembull i një dispozite kombëtare që e parashikon përhapjen publike të komunikimeve ose deklaratave raciste (etj.) si vepër penale

Neni 266 b i Kodit Penal të Danimarkës⁸⁰

“Kushdo që **publikisht ose me qëllim përhap ndonjë deklaratë ose komunikim tjetër** me anë të së cilit kërcënohet, fyhet ose degradohet një grup personash për shkak të **racës, ngjyrës, originës kombëtare ose etnike, besimit fetar, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes së gjinisë ose karakteristikave seksuale** të atij grupi, dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.”

79 Austri, [Bundesrecht konsolidiert: Gesamte Rechtsvorschrift für Verbotsgesetz 1947, Fassung vom 17.10.2024](#), [Ligji i Ndalimit i vitit 1947, Ligji Federal i Konsoliduar, Version i datës 13. 10 2024, (në gjermanisht, përkthim jozyrtar).

80 Danimarkë, [Bekendtgørelse af straffeloven](#) [Kodi Penal], (në danisht, përkthim jozyrtar).

Veprat e shpifjes

Shpifja kundër një individi ose grupi si vepër penale bazuar në karakteristika specifike mund të gjendet në kodet penale kombëtare. Megjithatë, standardet ndërkombëtare nuk rekomandojnë ose kërkojnë kriminalizimin e saj.⁸¹

Shembull i një dispozite për shpifje

Neni 355 i Kodit Penal të Republikës Çeke⁸²

(1) **Kushdo që shpif publikisht ndaj:**

- a) një kombi, gjuhës së tij, një race ose grupi etnik, ose
- b) një grupi personash për shkak të racës së tyre reale ose të perceptuar, përkatësisë në një grup etnik, kombësi, besim politik, fe ose për shkak se janë realisht ose supozohet se janë pa fe,

dënohet me burgim deri në dy vjet.

Veprat e fyerjeve të motivuara nga paragjykimet

Mund të ketë forma të ndryshme të dispozitave që kriminalizojnë fyerjet e motivuara nga paragjykimet të disponueshme për prokurorët në nivel kombëtar. Gjithashtu, është e mundur që dispozitat përkatëse për fyerje të jenë të disponueshme vetëm në legjislacionin civil ose të mos ekzistojnë fare.

Neni 5 i Protokollit Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik⁸³ parashikon: "1. Secila Palë duhet të miratojë masa legjislative dhe të tjera që mund të jenë të nevojshme për të përcaktuar si vepra penale sipas legjislacionit të saj të brendshëm, kur kryhen me qëllim dhe pa të drejtë, sjelljet e mëposhtme: fyerja publike, përmes një sistemi kompjuterik, (i) ndaj personave për arsye se i përkasin një grupi të dallueshëm për shkak të racës, ngjyrës, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike, si dhe fesë, nëse përdoret si pretekst për ndonjë nga këta faktorë; ose (ii) ndaj një grupi personash të dallueshëm për shkak të ndonjë prej këtyre karakteristikave. 2. Një Palë mund ose: a. të kërkojë që vepra e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni të ketë efektin që personi ose grupi i personave të përmendur në paragrafin

81 Për një rishikim dhe analizë të qasjeve aktuale ndaj kriminalizimit të shpifjes dhe fyerjes në të gjithë rajonin e OSBE-së, shih Scott Griffen, *Ligji për shpifjen dhe fyerjen në rajonin e OSBE-së*.

82 Republika Çeke, *Zákon trestní zákoník* [Criminal Code], (në çekisht, përkthim jozyrtar).

83 *Protokolli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike, fyerjeve me motive raciste dhe ksenofobike*, Këshilli i Evropës, Strasburg, 2003.

1 ekspozohet ndaj **urrejtjes, përbuzjes ose talljes**; ose b. të ruajë të drejtën për të mos zbatuar, në tërësi ose pjesërisht, paragrafin 1 të këtij neni.”

Paragrafi 11 i Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Shtetet Anëtare për luftimin e “gjuhës së urrejtjes”⁸⁴ rekomandon që fyerjet publike seksiste dhe fobike ndaj LGBTI-ve në kushte të tilla si ato të përcaktuara specifikisht për fyerjet në internet në Protokollin Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik të jenë gjithashtu objekt i përgjegjësisë penale.

Shembull i një dispozite për fyerje

Sipas nenit 448 të Kodit Penal të Belgjikës:⁸⁵ “Kushdo që **fyen një person** qoftë me fakte, qoftë me shkrime, imazhe apo emblema, në një nga rrethanat e parashikuara në nenin 444, dënohet me burgim nga tetë ditë deri në dy muaj dhe gjobë nga njëzet e gjashtë [euro] deri në pesëqind [euro], ose vetëm një nga këto dënime.”

Neni 444 i Kodit Penal të Belgjikës parashikon: “Fajtori dënohet me burgim nga tetë ditë deri në një vit dhe me gjobë nga njëzet e gjashtë deri në dyqind euro, kur akuzat janë bërë në takime ose vende publike; qoftë në prani të disa individëve, në një vend jopublik, por të hapur për një numër të caktuar njerëzish që kanë të drejtë të mblidhen ose ta frekuentojnë atë; qoftë në çdo vend, në prani të personit të ofenduar dhe para dëshmitarëve.”

Sipas nenit 453bis të Kodit Penal të Belgjikës, “dënimi minimal për përgojim, shpifje dhe **fyerje** mund të **dyfishohet nëse motivohet nga urrejtja, përbuzja ose armiqësia ndaj personave për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, trashëgimisë, origjinës kombëtare ose etnike të supozuar, lindjes, moshës, pasurisë, bindjeve fetare ose filozofike, gjendjes aktuale ose të ardhshme të shëndetit, paaftësisë, gjuhës, bindjes politike, bindjes sindikale, karakteristikave fizike ose gjenetike ose origjinës shoqërore.**”

Siç shpjegohet në një studim të kontraktuar nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias, “termi ‘fyerje’ nuk është përcaktuar në statut, por, në përgjithësi, përbëhet nga një akuzë e pasaktë që mund të cenojë nderin e një personi. Në praktikë, fyerja kërkon edhe një element keqdashjeje.”⁸⁶

84 Rekomandimi CM/Rec (2022) 16 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, Këshilli i Evropës, paragrafi 11 (d).

85 Kodi Penal i Belgjikës.

86 Scott Griffen, Ligjet për shpifjen dhe fyerjen në rajonin e OSBE-së.

Shembull i një fyerje të motivuar nga paragjykimi dhe ndjekja penale e saj (Belgjikë)⁸⁷

“Autori shkruan sharje raciste dhe grafite fyese në shkallët e një ndërtese apartamentesh me stilolaps të zi dhe një shigjetë që tregon banesën e viktimës.

“Kjo vepër ndiqet penalisht si fyerje sipas neneve 448 dhe 444 të Kodit Penal, e kryer me një motiv paragjykimi, i cili parashikohet nga neni 453bis. Aty ku nuk është e mundur ndjekja penale e fyerjes me motive paragjykimi, prokurorët duhet të synojnë të zgjedhin një vepër që merr parasysh shenjëstrimin e drejtpërdrejtë të demonstruar nga shigjeta që tregon banesën e viktimës dhe ndikimin e mundshëm të veprës mbi viktimën. Për shembull, prokurorët mund të shqyrtojnë mundësinë e zbatimit dëmit të rënduar për shkak të racës mbi veprën penale kundër pronës, ose në varësi të rrethanave, mund të shqyrtojnë kërcënimin ose ngacmimin si masë rëndësuese”.

Shënim për prokurorët – kundërvajtjet civile dhe administrative⁸⁸

Mjetet juridike civile dhe administrative janë veçanërisht të rëndësishme në rastet e “gjuhës së urrejtjes” që nuk plotësojnë prapësinë për ndjekje penale. Mjetet juridike civile mund të përfshijnë pagesën e dëmshpërblimeve, masa urgjente për të parandaluar ngjarje të mëtejshme dhe publikimin e njoftimeve se disa deklaratat përbëjnë “gjuhë urrejtjeje”. Mjetet juridike administrative përfshijnë veprimet e ndërmarra nga agjencitë qeveritare për të zbatuar rregulloret dhe mund të përfshijnë gjopa, bllokim ose fshirje të përmbajtjes fyese dhe humbje të licencave. Këto mjete juridike mund të ndiqen paralelisht me proceset penale ose në mënyrë të pavarur nga to.

Prokurorët mund të luajnë një rol kyç sa i takon tërheqjes së vëmendjes së viktimave dhe avokatëve të tyre ndaj këtyre mjeteve të mundshme juridike dhe të bëjnë referime aty ku është e përshtatshme.

⁸⁷ Ky shembull është publikuar nga organi belg i barazisë në [faqen e tij të internetit](#).

⁸⁸ Memorandumi shpjegues për Rekomandimin CM/Rec(2022)16 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për luftimin e gjuhës së urrejtjes, Komitetin Drejtues Kundër Diskriminimit, Diversitetin dhe Përfshirjen (CDADI) dhe Komitetin Drejtues për Median dhe Shoqërinë e Informacionit (CDMSI), takimi 1434, 11, 13 dhe 17 maj 2022.

2.3 VEPRAT PENALE NË UDHËKRYQ

Ky grup veprash përfshin sjelljen kërcënuese dhe ngacmuese në një vend publik, duke u shkaktuar të tjerëve frikë, alarm dhe shqetësim. Në rastin e huliganizmit, këto vepra mund të përfshijnë edhe dhunën në grup. Siç përcaktohet në Pemën e Vendimmarrjes së Prokurorit në Kreun 3, në varësi të kontekstit dhe rrethanave, këto vepra mund të ndodhin krahas veprave të “gjuhës së urrejtjes”, përfshirë nxitjen e urrejtjes ose dhunës. Një pyetje e rëndësishme për prokurorët do të jetë nëse kjo sjellje i nxit të tjerët për dhunë ose urrejtje (të udhëzuar nga testi me gjashtë pjesë i Planit të Rabatit), rast në të cilin aspektet e lirisë së shprehjes do të jenë të rëndësishme.

Ky seksion përfshin gjithashtu veprat që përfshijnë mbishkrime me grafit, sepse, në varësi të kontekstit dhe karakteristikave të tyre të veçanta, këto incidente mund të përbëhen nga krime të urrejtjes, fyerje të motivuara nga paragjykimi, kërcënime ose vepra të “gjuhës së urrejtjes”. Siç shpjegohet në Kreun 3, në disa rrethana, mbishkrimet me grafit mund të jenë gjithashtu një tregues paragjykimi për një vepër të krimit të urrejtjes.

2.3.1 PRISHJA E QETËSISË DHE VEPRAT E SHQETËSIMIT TË MOTIVUARA NGA PARAGJYKIMI

Ky grup veprash janë fjalë ose shprehje ku forma themelore jo e rëndë e veprës parashikohet në Kodin Penal dhe përmbajtja e gjuhës përfshin tërësinë e veprës. Në disa shtete, shqetësimet në nivele më të ulëta ose prishja e qetësisë, si dhe shkelje të tjera të rendit dhe shqetësimit publik, kategorizohen si kundërvajtje dhe shkelje administrative.

Shembull i një shkeljeje të dispozitës për prishje të qetësisë (rendit publik) të motivuar nga paragjykimi

Ligji i Rendit Publik 1986, Seksioni 5, Ngacmimi, alarmi ose shqetësimi (Mbretëria e Bashkuar (Angli dhe Uells))⁸⁹

- (1) Një person është fajtor për një vepër penale nëse ai
 - a) përdor fjalë ose sjellje kërcënuese [ose fyese], ose sjellje të çrregullt, ose

⁸⁹ Mbretëria e Bashkuar, [Ligji për Rëndin Publik](#), 1986, Seksioni 5.

- b) shfaq ndonjë shkrim, shenjë ose paraqitje tjetër vizive që është kërcënuese [ose fyese], që është e dëgjueshme ose e shikueshme nga një person të cilit mund t'i shkaktojë ngacmim, alarm ose shqetësim.
- (2) Vepra penale sipas këtij neni mund të kryhet në një vend publik ose privat; nuk ka asnjë vepër penale kur përdoren fjalët ose sjelljet, ose kur paraqitet shkrimi, shenja ose paraqitje tjetër vizive, nga një person brenda një banesë dhe personi tjetër është gjithashtu brenda asaj banese ose në një banesë tjetër.
- (3) I takon të akuzuarit të vërtetojë -
 - a) se ai nuk kishte asnjë arsye të besonte se mund ta dëgjonte ose shikonte ndonjë person, ndaj të cilit mund të shkaktohej ngacmim, alarm ose shqetësim, ose
 - b) se ai ishte brenda një banese dhe nuk kishte arsye të besonte se fjalët ose sjellja e përdorur, ose shkrimi, shenja ose paraqitje tjetër e dukshme e shfaqur, do të dëgjoheshin ose shiheshin nga një person jashtë asaj ose ndonjë banese tjetër, ose
 - c) se sjellja e tij ishte e arsyeshme.
- (4) F2.....
- (5) F2.....
- (6) Një person fajtor për një vepër të parashikuar në këtë nen, i nënshtrohet dënimit të shkurtuar me një gjobë që nuk e kalon nivelin 3 të shkallës standarde.

Seksioni 31 i Ligjit mbi Krimet dhe Trazirat i vitit 1998⁹⁰ parashikon forma të rënduara për shkak të racës dhe fesë të kësaj dhe veprave të tjera të ngjashme (veprat themelore).

Shembull i një vepre të prishjes së qetësisë (rendit publik) të motivuar nga paragjykimi

Ndërsa po ecte në një rrugë të mbushur me dyqane në mes të ditës, një burrë bërtet në mënyrë të përsëritur sharje raciste dhe ksenofobike. Ai nuk i drejton këto thirrje ndaj personave të veçantë dhe nuk njuh askënd në zonë. Ai bërtet në drejtim të njerëzve që janë të pranishëm dhe për të cilët është

90 Mbretëria e Bashkuar, Ligji për Rëndin Publik, 1986, Seksioni 31.

i vetëdijshëm. Në rrugë ka disa njerëz që sigurohen ta shmangin atë duke kaluar në anën tjetër të rrugës.

Ky incident përmbush disa elemente të veprës së prishjes së qetësisë. Gjuha është kërcënuese dhe fyese, ndodh në publik dhe ka gjasa të shkaktojë shqetësim ose frikë tek njerëzit që ndodhen brenda rrezes së dëgjimit ose shikimit të personit që po bën këtë sjellje. Vepra gjithashtu përmban qartazi rrethanën rënduese racore.

Këto lloje incidentesh priren të përkojnë me një cilësim juridik më të ulët të veprave të prishjes së qetësisë ose që lidhen me shqetësimin e publikut. Në praktikë, prokurorët duhet të kalibrojnë qasjen e tyre për të marrë parasysh natyrën dhe ndikimin e këtyre veprave dhe të sigurojnë që, kur sjellja shoqërohet me një sulm fizik ose kërcënim të drejtpërdrejtë, përmbajtja e sjelljes fyese ose abuzive të merret parasysh me kujdes si një tregues paragjykimi dhe si një provë e mundshme e një sulmi të motivuar nga paragjykimi (krim urrejtjeje). Prokurorët duhet të kërkojnë prova për kërcënime të drejtpërdrejta, sjellje si mbajtja e armëve ose incidente që përfshijnë grupe autorësh veprash.

Gjithashtu, mund të ketë shembuj kur këto dispozita mund të keqpërdoren për të ndjekur penalisht krime më të rënda urrejtjeje, siç shpjegohet në Kreun 4.

2.3.2 VEPRAT E HULIGANIZMIT TË MOTIVUAR NGA PARAGJYKIMI

“Huliganizmi” zakonisht përfshin sjellje përçarëse, abuzive ose të paligjshme, si vandalizmi dhe dhuna e kryer nga grupe. Sjellja lidhet kryesisht me dhunën në ngjarje sportive, për shembull, në rastet ku tifozët e futbollit udhëtojnë dhe ndjekin ndeshje me qëllim që të veprojnë në mënyrë abuzive dhe të dhunshme. Huliganizmi gjithashtu mund të përfshijë, ose të krijojë kontekstin për krimet e motivuara nga paragjykimi. Për shembull, dhuna që synohet të ushtrohet në aktivitetet e javës së Krenarisë.⁹¹ Në disa juridiksione, prokurorët kanë opsionin që ta cilësojnë një vepër si huliganizëm të motivuar nga paragjykimi ose që t’i tërheqin vëmendjen gjykatës ndaj dispozitave të rritjes së përgjithshme të dënimit për të njohur motivin e paragjykimit në fazën e dënimit. Kur shqyrtohet zbatueshmëria e një akuze për huliganizëm në një incident, është thelbësore që prokurorët të marrin gjithashtu parasysh nëse incidenti përfshin sulme specifike të motivuara nga paragjykimi ose krime të tjera të urrejtjes. Mungesa e identifikimit dhe trajtimit shtesë të këtyre veprave specifike u mohon viktimave individuale të drejtat e tyre për hetim efektiv dhe për pjesëmarrje të plotë, si dhe zvogëlon qasjen e tyre në mbështetje të specializuar.

91 Shih, për shembull, [Huliganët sulmojnë Marshimin e LGBT-ve në Poloni](#), “New York Times”, 27 korrik 2019, video.

Shembull i një dispozite për huliganizëm të motivuar nga paragjykimi

Neni 287 i Kodit Penal të Moldavisë⁹²

- (1) Huliganizmi, domethënë veprimet e qëllimshme që cenojnë rëndë rendin publik, që përfshijnë përdorimin e dhunës ndaj njerëzve ose kërcënimet për përdorimin e saj, rezistencën e dhunshme ndaj një përfaqësuesi të autoriteteve ose një personi tjetër që shtyp veprimet huligane, si dhe veprimet e karakterizuara nga cinizmi i jashtëzakonshëm në përmbajtjen e tyre ose paturpësi të veçantë, dënohen me gjobë nga 550 deri në 1050 njësi konvencionale, ose me punë pa pagesë në komunitet për një periudhë nga 180 deri në 240 orë, ose me burgim deri në 3 vjet.
- (2) I njëjti veprim i kryer: [...] b) nga dy ose më shumë persona; c) në territorin ose ndërtesën e një institucioni shëndetësor publik ose privat, d) në lidhje me një mjek ose punonjës mjekësor gjatë ushtrimit të detyrave të tij zyrtare; e) **për shkak të paragjykit**, dënohet me gjobë nga 750 deri në 1350 njësi konvencionale ose me burgim deri në 5 vjet.
- (3) Huliganizmi keqdashës, domethënë veprimet e parashikuara në paragrafët (1) ose (2), të kryera me përdorimin ose tentativën për përdorim të armëve ose sendeve të tjera që shkaktojnë lëndim trupor ose dëmtim tjetër të shëndetit, dënohet me burgim nga 3 deri në 7 vjet.

Shembull ilustrues i një vepre të huliganizmit të motivuar nga paragjykimi

Në maj të vitit 2018, mbi 30 burra të maskuar sulmuan shtëpitë rome pranë fshatit Rudne në rajonin Lviv të Ukrainës. Incidenti përfshiu zjarrvënien në shtëpitë e njerëzve dhe sulme të rënda fizike. Policia njoftoi shtypin se sulmi ishte cilësuar si "huliganizëm".⁹³

Në këtë rast dhe raste të tjera të ngjashme, i takon prokurorit që të shqyrtojë akuzat për zjarrvënie të motivuara nga paragjykimi dhe sulmet e motivuara nga paragjykimi. Nëse akuza për huliganizëm është gjithashtu e përshtatshme, sipas Kodit Penal të Ukrainës, është gjithashtu e mundur për prokurorin që t'i sjellë në vëmendje gjykatës zbatueshmërinë e një dispozite të

⁹² Kodi Penal i Moldavisë, CP985/2002, (në rumanisht, përkthim jozyrtar).

⁹³ Jonathan Lee, [Romët e djegur në shtëpitë e tyre nga burra të maskuar ndërsa dhuna përshkallëzohet në Ukrainë](#), Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, 12 maj 2018. Rasti përmendet gjithashtu në raportin [Kuptimi i krimeve të urrejtjes kundër romëve dhe trajtimi i nevojave të sigurisë së komuniteteve rome dhe sinti](#), OSBE/ODIHR, 18 maj 2023, f. 17.

përgjithshme të rritjes së dënimit për të njohur motivin e paragjykit (neni 67 Rrethanat rënduese të dënimit).

Neni 67 i Kodit Penal të Ukrainës⁹⁴

1. Për qëllime të dhënies të dënimit, rrethanat e mëposhtme do të konsiderohet rënduese:
 - 1), 2) ...
 - 3) kryerja e veprës penale për shkak të urrejtjes ose përçarjes racore, kombëtare, fetare ose për shkak të gjinisë;**
 - (4) - (13) ...

2.3.3 MBISHKRIMET ME GRAFIT

Ndërsa mbishkrimet me grafit zakonisht nuk parashikohen si vepra penale në kodet penale kombëtare, në varësi të kontekstit dhe veçorive të tyre të veçanta, këto incidente mund të përfshijnë krime urrejtjeje, fyerje të motivuara nga paragjykimi, kërcënime ose vepra të “gjuhës së urrejtjes”. Për shembull, shkrimet raciste me grafit në një mur mund të cilësohen më së miri si krim urrejtjeje, si “dëmtim prone” në formën e tij të rënduar. Nga ana tjetër, përmbajtja e grafitit, konteksti dhe vendndodhja e tij, duke përfshirë mënyrën se si kjo ndikon në përhapjen e tij të mundshme dhe gjasat për të shkaktuar dëm, mund të sugjerojnë cilësimin si nxitje për urrejtje ose dhunë. Një mundësi tjetër, e shpjeguar në Seksionin 2.2.1, është rasti kur grafitet raciste në murin e apartamentit të viktimës cilësohen si fyerje e motivuar nga paragjykimi. Grafitet e ngjashme, të drejtuara ndaj një individi ose grupi të caktuar, mund të cilësohen si kërcënim i motivuar nga paragjykimi. Siç shpjegohet në Kreun 3, në disa rrethana, grafitet gjithashtu mund të jenë një tregues paragjykimi për një vepër penale të urrejtjes. Prokurorët duhet të konsultohen me Kreun 5 sa u takon nevojave të viktimave.

94 Kodi Penal i Ukrainës, i ndryshuar së fundi më 4 qershor 2021.

Shembull i mbishkrimeve me grafit

Në Šibenik, Kroaci, në murin e një shkolle u shkruan me grafit mesazhe kundër serbëve, duke përfshirë kryqë naziste dhe thirrje për të vrarë fëmijët serbë. Gjuha përfshinte fraza të tilla si: “vramë Arkanin, pastaj Cecën ... vrisni fëmijët serbë”, “vrisni një serb, Vukovar — kurrë ВУКОВАР”.⁹⁵ Grafitet përfshinin gjithashtu një vizatim të një kryqi nazist me vitin 1986 të shkruar në katër katrorët e kryqit.

Prokurori e cilësoi incidentin sipas nenit 235 të Kodit Penal të Kroacisë si “dëmtim të pronës së një personi tjetër”, të kryer me një motiv bazë.⁹⁶

Neni 325 i Kodit Penal të Kroacisë përcakton veprën penale të “Nxitjes publike për dhunë dhe urrejtje”.⁹⁷ Në këto raste, prokurorit i jepet mundësia të shqyrtojë nëse grafitet ose vandalizmi drejtohen ndaj grupit të synuar që zotëron objektin, rast në të cilin krimi ka më shumë të ngjarë të jetë një krim urrejtjeje, ose nëse shprehja synon publikun për të nxitur të tjerët drejt urrejtjes, diskriminimit ose dhunës. Nëse është kështu, prokurorët duhet të shqyrtojnë dispozitat kombëtare, praktikat gjyqësore të disponueshme dhe testet e pragut të Planit Rabat për të përcaktuar nëse akuza për nxitje urrejtjeje është e përshtatshme në këtë rast.

95 Arkani ishte një komandant ushtarak serb gjatë konfliktit në Ballkan. Ceca ishte gruaja e Arkanit. ВУКОВАР është emri i qytetit të Vukovarit në cirilik, që është alfabeti serb. Vukovari kufizohet me Serbinë dhe ishte vendi i një mizorie të kryer nga ushtria serbe në vitin 1991 gjatë konfliktit në Ballkan.

96 Kroacia, [Kazneni zakon](#) [Kodi Penal], neni 235 (1), “Kushdo që dëmton, shkatërron, deformon ose e bën të papërdorshme pasurinë e tjetrit, dënohet me burgim deri në dy vjet ... (3) Nëse autori ka kryer veprën penale të përmendur në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni për motive të ulëta ... dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.” (Në kroatisht, përkthim jozyrtar).

97 Po aty, neni 325 (Nxitja publike për dhunë dhe urrejtje), “(1) Kushdo që në shtyp, nëpërmjet radios, televizionit, sistemit kompjuterik ose rrjetit, në një tubim publik ose në ndonjë mënyrë tjetër nxit publikisht ose vë në dispozicion të publikut trakte, fotografi ose materiale të tjera që nxitin dhunë ose urrejtje të drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi të tillë për shkak të racës, fesë, origjinës kombëtare ose etnike, gjuhës, prejardhjes, ngjyrës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, paafësisë ose çdo veçori tjetër dënohen me burgim jo më shumë se tre vjet.” (Në kroatisht, përkthim jozyrtar).

3 Pema e Vendimmarrjes së Prokurorit

Kjo pemë vendimmarrjeje është krijuar për profesionistët që janë tashmë të trajnuar për identifikimin dhe ndjekjen penale të krimeve të urrejtjes. Ajo synon të theksojë dallimet kryesore në praktikën e ndjekjes penale ndërmjet krimeve të urrejtjes dhe veprave të “gjuhës së urrejtjes” dhe të ofrojë pyetje udhëzuese për të mbështetur prokurorët në zbatimin e dispozitave të legjislacionit kombëtar. Ajo nuk mund të zbatohet për të gjitha situatat, dhe prokurorët duhet të përdorin gjykimin e tyre dhe të zbatojnë ligjin kombëtar si të jetë e nevojshme. Për më shumë informacion mbi bazat e konceptit të krimeve të urrejtjes, referojuni Kreut 1 dhe udhëzimeve ekzistuese të ODIHR-it mbi ndjekjen penale të krimeve të urrejtjes.⁹⁸ Ky seksion e çon lexuesin nëpër strukturën e pemës së vendimmarrjes dhe duhet të lexohet së bashku me grafikën përkatëse.

Pema e vendimmarrjes nis nga momenti kur një çështje referohet te prokurori. Në varësi të sistemit ligjor dhe kompetencave dhe rolit të prokurorit, një çështje mund t'i referohet prokurorit në një moment gjatë ose drejt përfundimit të hetimit, ose në pikën e ngritjes së akuzës. Deri në këtë fazë, procesi i hetimit me shumë të ngjarë ka identifikuar një vepër të mundshme penale që sugjeron një akuzë të mundshme. Vepra penale mund të përfshijë çdo krim të parashikuar në Kodin Penal.

Krimet e urrejtjes raportohen në mënyrë të pamjaftueshme nga viktimat dhe mund të mos identifikohen dhe regjistrohen nga hetuesit e policisë. Për të ulur rrezikun e mosraportimit dhe mosregjistrimit, ky mjet synon të krijojë një “rrjetë të gjerë” për të kapur krimet e mundshme të urrejtjes duke bërë pyetje të hapura dhe duke inkurajuar përdorimin e treguesve të paragjykit (shih Pyetjen 1 më poshtë).

Pyetjet 1–3 synojnë të mbështesin prokurorët për:

- përcaktimin nëse janë të përfshira urrejtja, paragjykimi ose anshmëria; dhe
- përcaktimin nëse provat e urrejtjes ose paragjykit tregojnë për një cilësim si krim urrejtjeje apo si “gjuhë urrejtjeje” si vepër penale.

98 OSBE/ODIHR, *Ndjekja Penale e Krimeve të Urrëjtjes*.

1: A përfshin incidenti urrejtje, paragjykim apo anshmëri?

Qëllimi i kësaj pyetjeje është që rrjeta të zgjerohet sa më shumë të jetë e mundur, veçanërisht e rëndësishme për identifikimin, regjistrimin dhe reagimin ndaj veprave penale të krimeve të urrejtjes.

Siç shpjegohet në Kreun 1, prania e urrejtjes, paragjykimeve ose anshmërisë është më e dukshme në rastet e “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale. Për rastet e krimeve të urrejtjes, hetuesit dhe prokurorët mund të duhet të koordinohen ngushtë për të identifikuar dhe kapur prova të një motivi paragjykimi. Në fazën më të hershme, rekomandohet përdorimi i treguesve të paragjykimit për të identifikuar provat e mundshme të paragjykimit. Këto teste duhet të rivizitohen dhe të rizbatohen nga prokurorët, sipas rastit.

Treguesit e paragjykimit: një përmbledhje⁹⁹

Treguesit e paragjyimeve janë “fakte objektive, rrethana ose modele që ndjekin një akt kriminal ose disa akte kriminale, të cilat, duke qëndruar të vetme ose në lidhje me fakte ose rrethana të tjera, sugjerojnë se veprimet e autorit ishin të motivuara, tërësisht ose pjesërisht, nga çfarëdolloj forme paragjykimi.”¹⁰⁰ Si të tillë, treguesit e paragjyimeve janë një mjet vendimtar për identifikimin e krimeve të urrejtjes.

Treguesit e paragjyimeve që hasen më shpesh mund të përcaktohen në tetë kategori kryesore të renditura më poshtë. Mund të ndodhë që në një rast të mundshëm të krimit të urrejtjes të jetë i pranishëm më shumë se një tregues paragjykimi. Treguesit e paragjyimeve mund të ndryshojnë gjithashtu bazuar në llojin e krimit të urrejtjes. Raportimi vjetor i ODIHR-it për krimet e urrejtjes përfshin incidente mbi krime të urrejtjes raciste dhe ksenofobike, krime të urrejtjes kundër romëve, krime të urrejtjes antisemite, krime të urrejtjes kundër myslimanëve, krime të urrejtjes kundër të krishterëve, krime të tjera të urrejtjes bazuar në fe ose besim, krime të urrejtjes me bazë gjinore, krime të urrejtjes kundër LGBTI-ve dhe krime të urrejtjes të lidhura me aftësitë e kufizuara.¹⁰¹

⁹⁹ Shih, Përdorimi i treguesve të paragjykimit: Një mjet praktik për policinë, OSBE/ODIHR, 28 maj 2019.

¹⁰⁰ Protokoll i Modeli i Masaçusetsit për Hetimin e Krimit të Paragjyimeve; cituar në: [Mekanizmat e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave për krimin e urrejtjes: një udhëzues praktik](#), OSBE/ODIHR, 29 shtator 2014, f. 15.

¹⁰¹ Mbledhja e fletëve të fakteve për krimin e urrejtjes, OSBE/ODIHR; Raporti i ODIHR-it për krimin e urrejtjes.

Perceptimi i viktimës dhe dëshmitarit

Edhe në mungesë të treguesve të tjerë të paragjykit, është me rëndësi jetike mënyra se si viktimat ose dëshmitarët e perceptojnë krimin që përjetojnë ose dëshmojnë. Ndërsa ata fillimisht mund të mos jenë në gjendje të përcaktojnë me saktësi faktorët që i bëjnë ata t'i shohin veprimet e autorëve si të motivuara nga paragjykimi, përshtypja e tyre mbi sulmin nuk mund të hidhet poshtë. Në fakt, hetuesit dhe prokurorët shpesh gjejnë tregues të tjerë paragjykimi për të konfirmuar perceptimin e tyre.

Komente, deklarata të shkruara, gjeste apo mbishkrime

Autorët e krimeve të urrejtjes shpesh i bëjnë të qarta paragjykimet e tyre para, gjatë ose pas aktit. Ata që kryejnë krime të urrejtjes në përgjithësi duan t'u dërgojnë një mesazh viktimave të tyre dhe të tjerëve, dhe këto mesazhe, nga fyerjet me bërtitje të gjestet e deri te mbishkrimet dhe publikimet në internet, janë tregues të fuqishëm të motivit të paragjykit.

Dallimet etnike, fetare ose kulturore midis dhunuesit dhe viktimës

Dallimet midis autorëve të krimeve dhe viktimave mund të jenë një tregues i paragjykit. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur viktimat mund të identifikohen në mënyrë të dukshme si anëtarë të një grupi të caktuar. Këta identifikues mund të përfshijnë ngjyrën e lëkurës, veshjet fetare, si p.sh. një grua myslimane me shami, ose veshje të tjera identifikuese, si p.sh. veshja e një flamuri me ngjyrë ylberi në mbështetje të lëvizjes për barazi LGBTI.

Grupet e organizuara të urrejtjes

Ndërsa jo të gjitha krimet e urrejtjes kryhen nga grupe të organizuara, anëtarët ose bashkëpunëtorët e grupeve të tilla shpesh përfshihen në kryerjen e këtyre krimeve.

Vendndodhja dhe koha

Ku dhe kur ka ndodhur një incident mund të jenë tregues të rëndësishëm paragjykimi. Kjo mund të përfshijë vendndodhje specifike dhe kohë të rëndësishme për, ose të lidhura me një komunitet të caktuar të synuar. Meqenëse autorët e krimeve të urrejtjes mund t'i perceptojnë veprimet e tyre si të justifikuara nga ideologjitë nacionaliste, datat dhe lokalitetet e rëndësishme që lidhen me kulturën, fenë apo edhe festimet kombëtare dominuese mund të ofrojnë gjithashtu kontekstin për krimet e urrejtjes.

Modele ose krime ose incidente të shpeshta të mëparshme

Nëse një viktimë individuale ka qenë më parë objekt i një krimi të motivuar nga paragjykimi, motivi i mundshëm i paragjykimit duhet të merret parasysh seriozisht. Nëse është vërejtur një *modus operandi* i ngjashëm më parë në një zonë të caktuar, nëse ka një rritje të incidenteve të motivuara nga paragjykimi ose një grup i caktuar ka marrë kërcënime, edhe këto duhet të shkaktojnë dyshimin për një motiv paragjykimi. Po kështu, nëse të dyshuarit kanë një histori të përfshirjes në krime të motivuara nga paragjykimi, ky duhet të konsiderohet si tregues paragjykimi.

Natyra e sulmit

Për shkak se krimet e urrejtjes janë krime mesazhi, d.m.th., që synojnë përhapjen e frikës tek të tjerët që kanë të përbashkët karakteristikën e mbrojtur të viktimës ose viktimave, niveli i dhunës, dëmtimit dhe brutalitetit priret të jetë serioz. Si shprehje e epërsisë dhe refuzimit ndaj grupit të synuar, krimet e urrejtjes mund të përfshijnë gjithashtu trajtim degradues që synon uljen e dinjitetit të viktimave.

Mungesa e motiveve të tjera

Krimet e urrejtjes shpesh shënjestrojnë viktimat si “përfaqësues” të grupit të tyre. Për rrjedhojë, zgjedhja e objektivit mund të duket e rastësishme dhe, duke pasur parasysh mungesën e lidhjes midis autorit dhe viktimës, asnjë motiv nuk mund të jetë i dukshëm. Në këto raste, mundësia e një motivi paragjykimi nuk duhet të përjashtohet.

Është e rëndësishme të theksohet se **perceptimi i viktimës** është tregues kyç i paragjykimit. Është praktikë e mirë që kur krimet perceptohen nga viktimat si paragjykim, ato të regjistrohen edhe nëse nuk ka prova të mjaftueshme për të përfshirë motivin e paragjykimit në akuzë ose për ta paraqitur më vonë në fazën e dënimit. Është gjithashtu praktikë e mirë për policinë dhe, kur është e përshtatshme, edhe për prokurorin, që të pranojë perceptimin e viktimës se vepra ishte një krim urrejtjeje dhe të sigurojë referimin e tyre te një organizatë e specializuar mbështetëse aty ku është e mundur. Përgjigja e policisë dhe prokurorëve ndaj viktimave dhe komuniteteve që perceptojnë se vepra është e motivuar nga paragjykimi mund të ketë një ndikim afatgjatë. Një përgjigje e dobët mund të shkaktojë dëme të mëtejshme individuale, viktimizimin dytësor dhe dëmtim afatgjatë në besimin e komunitetit, duke çuar në më pak krime urrejtjeje të raportuara.

Nëse përgjigjja për Pyetjen 1 është “po”, prokurorët duhet të kontrollojnë nëse viktimat është referuar te një shërbim mbështetës i specializuar dhe, kur është e përshtatshme, te një avokat. Nëse prokurori parashikon se viktimat mund të nevojitet për të dhënë dëshmi në rast se çështja përparon, nuk është shumë herët të konsiderohet nevoja për organizime procedurale dhe të tjera. Prokurorët gjithashtu duhet t'i referohen Kreut 5 për udhëzime të mëtejshme mbi nevojat e viktimave.

Nëse përgjigjja për Pyetjen 1 është “jo”, ose kur një prokuror nuk është i sigurt, ai/ ajo inkurajohet që të rishikojë çështjen, veçanërisht nëse viktimat ose dëshmitari e percepton veprën si një krim urrejtjeje ose të motivuar nga paragjykimi. Mund të merret parasysh kërkimi i këshillave të një koleg më me përvojë ose, nëse është e mundur, të një specialisti për krimet e urrejtjes. Nëse, pas shqyrtimit të kujdesshëm, përgjigjja mbetet “jo”, atëherë çështja nuk është një krim urrejtjeje ose një vepër e “gjuhës së urrejtjes” dhe duhet të trajtohet sipas legjislacionit dhe procedurave kombëtare.¹⁰²

Shënim për prokurorët – përgjigje të së drejtës civile dhe administrative

Nëse urrejtja ose paragjykimet janë të pranishme dhe pragu penal nuk plotësohet, është e rëndësishme të mbani mend se veprat nën-penale mund të tregojnë një rrezik përshkallëzimi të veprave penale më të rënda dhe gjithashtu të shkaktojnë dëm të konsiderueshëm për viktimat. Prokurorët duhet të koordinohen me viktimat dhe avokatët e tyre dhe palët e tjera të interesit, si organet e barazisë, rregullatorët e medias ose autoritete të tjera që mund të çojnë përpara një përgjigje sipas legjislacionit civil ose administrativ.

2: A përfshin incidenti gjuhë apo shprehje paragjykuese?

“Shprehja paragjykuese” mund të jetë verbale, me gjeste ose e shkruar (përfshirë në internet ose mbishkrime grafiti).

Prokurorët duhet të vlerësojnë nëse ka ndonjë shprehje të urrejtjes ose paragjykit. Në këtë pikë, nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse përmbajtja e vetë shprehjes arrin pragu penal (kjo vlerësohet nga pyetja 3 e më pas). Nëse nuk ka paragjykime ose shprehje të urrejtjes të dukshme, prokurorët mund të shqyrtojnë

¹⁰² Udhëzime ose komente për ndjekjen penale të rasteve që nuk janë krime të urrejtjes ose “gjuhë urrejtjeje” si vepra penale janë jashtë objektit të këtij udhëzuesi.

edhe një herë nëse ka ndonjë tregues tjetër të paragjykimit ose anshmërisë të pranishëm në vepër, siç përshkruhet në pikën 1 më sipër.

Nëse përgjigja është “po”, vazhdoni në pyetjen 3.

Nëse përgjigja është “jo”, ndërkohë që në pyetjen 1 janë identifikuar tregues të tjerë të paragjykimit, atëherë shkoni te pyetja 4.

3: A është incidenti krim nëse hiqet shprehja paragjyuese?

Krimet e urrejtjes janë vepra penale të kryera me një motiv paragjykimi. “Paragjykimi” manifestohet kur një autor ka shënjestruar qëllimisht një individ ose pronë për shkak të një ose më shumë tipareve të identitetit ose ka shprehur armiqësi ndaj këtyre tipareve të identitetit gjatë krimit. Kjo do të thotë se, edhe nëse hiqet paragjykimi, një krim i identifikueshëm, i përfshirë në Kodin Penal, si për shembull një sulm, ka ndodhur pavarësisht kësaj. Nga ana tjetër, në rastin e “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale, është përmbajtja e shprehjes ajo që përbën veprën penale. Me fjalë të tjera, nëse shprehja paragjyuese hiqet, nuk ka vepër. Këto pika janë eksploruar në Kreun 1.

Nëse përgjigja është “po”, incidenti ka të ngjarë të jetë një krim urrejtjeje. Nëse përgjigja është “jo”, incidenti ka të ngjarë të përfshijë një formë të “gjuhës së urrejtjes” të parashikuar si vepër penale.

Për krimet e urrejtjes ...

4: Për çfarë krimi bëhet fjalë? Cila është vepra bazë?

4a: Shkelja bazë nuk përfshin gjuhën ose shprehjen

Këto vepra priren të jenë krime që gjenden zakonisht në kodet penale kombëtare, si format e sulmit fizik dhe seksual, vrasjet dhe dëmtimi i pronës.

4b: Shkelja bazë përfshin gjuhën ose shprehjen

Veprat penale si kërcënimet kryhen përmes gjuhës ose shprehjes, për shembull, një kërcënim për të vlarë ose për të shkaktuar dëm serioz ose ngacmim. Me fjalë të tjera, këto vepra vazhdojnë të mbeten krime edhe nëse hiqet shprehja paragjyuese; vetë vepra bazë kryhet edhe nëpërmjet shprehjes.

5: Identifikoni, mblidhni dhe pasqyroni prova të treguesve të motivit të paragjykimit

Në këtë fazë, prokurorët mund t'u kthehen provave të treguesve të paragjykimit të identifikuar në pyetjet 1 dhe 2 dhe të punojnë me policinë, aty ku është e

përshtatshme, për të mbledhur prova të motivit të paragjykitimit që mund t'i paraqiten gjykatës. Këta hapa janë trajtuar plotësisht në udhëzimet e tjera të ODIHR-it.¹⁰³

6: Zgjidhni dispozitën e motivit të paragjykitimit

Prokurorët duhet të rishikojnë me kujdes seksionin 2.1, së bashku me kodet e tyre penale për të identifikuar dispozitën më të përshtatshme për të njohur motivin e paragjykitimit (6a, 6b, 6c): veprën penale themelore, rritjen specifike të dënimit ose rritjen e përgjithshme të dënimit.

Mund të ndodhë që nuk ka asnjë dispozitë ligjore që korrespondon me motivin e paragjykitimit (6d). Për shembull, vepra mund të përfshijë një motiv homofobik, por legjislacioni kombëtar për krimet e urrejtjes nuk e përfshin orientimin seksual si një karakteristikë të mbrojtur. Në këtë rast, prokurorët mund të pranojnë motivin e paragjykitimit ndaj viktimës, të kontrollojnë nëse kanë mbështetje dhe të shpjegojnë se si do të vazhdojë çështja kur Kodi Penal nuk përmban një mjet juridik të përshtatshëm për të trajtuar motivin specifik të paragjykitimit. Mund të ndodhë që gjykata të marrë parasysh politikat e përgjithshme të dënimit për faktorët rëndues dhe lehtësues, siç është motivi i autorit, të cilat nuk përmenden në mënyrë specifike motivin e paragjykitimit, por që mund të zbatohen për çështjen në fjalë.

Në mungesë të një dispozite të përshtatshme për krimin e urrejtjes, prokurorët mund të tundojnë të përdorin një dispozitë penale të “gjuhës së urrejtjes” për të njohur elementin e paragjykitimit të veprës. Siç shqyrtohet në seksionin 4.2, kjo nuk mund të jetë një strategji e përshtatshme e ndjekjes penale dhe rrezikon të minojë parimet e ligshmërisë dhe proporcionalitetit. Prokurorët inkurajohen të identifikojnë akuza të tjera të përshtatshme dhe mund të mbështeten në Kreun 4, veçanërisht në shembullin e dhënë në Seksionin 4.2. Siç shpjegohet edhe në Kreun 4, në kohën e duhur në procesin e politikëbërjes, prokurorët mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të theksuar për vendimmarrësit dhe ligjvënësit mjetet juridike që mungojnë për të trajtuar krimet e urrejtjes.

Për “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale ...

Ky botim nuk ofron udhëzime për ndjekjen penale të “gjuhës së urrejtjes” të parashikuar si vepër penale. Qëllimi i tij është të tregojë se këto forma veprash janë të ndryshme nga krimet e urrejtjes dhe kërkojnë qasje të ndryshme teknike dhe lidhur me viktimat. Për rrjedhojë, kjo pjesë e pemës së vendimmarrjes identifikon dispozitat më të përhapura të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale për të mbështetur prokurorët për hartimin e mjeteve juridike kombëtare.

Pikat 7 dhe 8 të pemës së vendimmarrjes trajtojnë objektivin dhe efektin e gjuhës ose të shprehjes. Siç shpjegohet në Hyrje, veprat penale të “gjuhës së urrejtjes”

103 OSBE/ODIHR, *Ndjekja Penale e Krimeve të Urrëjtjes*.

janë të natyrës publike; megjithatë, kuptimi ligjor i termave “publik” ose “publikisht” dhe personi që është objekt i gjuhës ose shprehjes mund të ndryshojnë shumë.

Veprat e “gjuhës nxitëse”

Në këto raste, gjuha ose shprehja synon të nxisë të tjerët në urrejtje ose dhunë kundër një grupi të caktuar (7c + 8d). Siç shpjegohet në Kreun 2, prokurorët duhet të mbështeten në testin me gjashtë pjesë të Planit të Rabatit, praktikën gjyqësore kombëtare dhe, sipas rastit, vendimet përkatëse të GJEDNJ-së si udhëzues për të bërë vlerësimin e tyre.

Është e rëndësishme të shënohet se, në rastin e veprave të “gjuhës nxitëse”, pema e vendimmarrjes thekson kërkesat teknike të përfshira kur vërtetohet një vepër e papërfunduar. Me fjalë të tjera, duhet treguar se gjuha e përdorur do të çonte në nxitjen e **të tjerëve** në urrejtje ose dhunë kundër grupit të synuar.¹⁰⁴ Në këtë kuptim, ajo çfarë është e rëndësishme është të tregohet se gjuha u drejtohet atyre që do të nxiteshin në urrejtje ose dhunë kundër një grupi të mbrojtur, ose anëtarëve të atij grupi, dhe jo të trajtohet drejtpërdrejt objektivi individual.

Është po aq e rëndësishme të mbahet parasysh ndikimi i kësaj gjuhe te individët që janë objektivi i mundshëm dhe fundor i kësaj urrejtjeje apo dhune, edhe nëse ata nuk janë element përbërës apo fokusi teknik i këtyre veprave penale. Për shembull, në çështjen “Beizaras dhe Levickas kundër Lituanisë”, GJEDNJ-ja mori parasysh refuzimin nga autoritetet lituaneze për të hetuar dhe sanksionuar komentet e “gjuhës së urrejtjes” në internet që synojnë nxitjen e urrejtjes dhe dhunës kundër personave lezbike, homoseksualë, biseksualë dhe transgjinjorë në përgjithësi, si dhe personalisht kundër dy burrave. Gjykata u shpreh se Lituania kishte shkelur nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës, të marrë në lidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe se neni 13 (e drejta për një mjet juridik efektiv) ishte shkelur gjithashtu nga autoritetet lituaneze.¹⁰⁵

Fyerje të motivuara nga paragjykim

Në këto raste, gjuha ose shprehja synon një viktimë individuale (7a) dhe mund të jetë ngacmuese, fyese, kërcënuese dhe ofenduese ose e ekspozon viktimën ndaj urrejtjes dhe/ose talljes (8a). Prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm se kjo lloj sjelljeje mund të përshkallëzohet në kërcënime të drejtpërdrejta me dhunë, dhe në këtë rast cilësimi i veprës si “kërcënim” ose diçka e ngjashme mund të jetë zgjidhja më e përshtatshme. Prokurorët duhet të konsultohen me Kreun 5 në lidhje me nevojat e viktimave, Seksionin 2.2.1 për shembuj dhe dispozitat ligjore dhe Seksionin 4.4 për shembuj në nivel kombëtar.

¹⁰⁴ ZKLDNJ, një faqe për “nxitjen për urrejtje”.

¹⁰⁵ “Beizaras dhe Levickas k. Lituanisë”, çështja nr. 41288/15, GJEDNJ, 14 janar 2020; Mbrojtja e të drejtave të pakicave; Një udhëzues praktik për zhvillimin e legjislacionit gjithëpërfshirës kundër diskriminimit, ZKLDNJ, Trusti për të Drejtat e Barabarta, Nju-Jork dhe Gjenevë, 2023, f. 178.

Për veprat në udhëkryq ...

Prishja e qetësisë dhe veprat e shqetësimit të motivuara nga paragjykimi


Në këto raste, gjuha ose shprehja zakonisht ndodh jashtë internetit dhe në publik (7c), dhe synon ose ka efektin e të qenit abuziv, alarmues ose shqetësues (8b). Megjithatë, nxitja e të tjerëve për urrejtje ose veprim nuk është një element përbërës i këtyre veprave. Shembujt dhe pikat për t'u marrë parasysh jepen në seksionin 2.3 dhe seksionin 4.4.

Huliganizmi i motivuar nga paragjykimi

Në këto raste, sjellja përfshin dhunën e kryer nga grupe. Këtu vëmendja kryesore i kushtohet shkeljes së rendit publik, por sjellja mund të përfshijë edhe shënjestrimin e viktimave individuale. Sjellja synon, ose ka efektin e të qenit abuziv, alarmues ose shqetësues (8b) për publikun përreth (7c). Megjithatë, nxitja e të tjerëve për urrejtje ose veprim nuk është një element përbërës i këtyre veprave. Shembujt dhe pikat për t'u marrë parasysh jepen në seksionin 2.3.2.

PEMA E VENDIMMARRJES PËR PROKURORËT LIDHUR ME KRIMIN E URREJTJES/GJUHËN E URREJTJES SI VEPËR PENALE*

1: A PËRFSHIN INCIDENTI URREJTJE, PARAGJYKIM APO ANSHMËRI?




2: A PËRFSHIN INCIDENTI GJUHË APO SHPREHJE PARAGJYKUESE?




3: A MBETET INCIDENTI KRIM NËSE HIQET SHPREHJA PARAGJYKUESE?



4: PËR ÇFARË KRIMI BËHET FJALË: CILA ËSHTË VEPRA BAZË





* Përdorni Pemën e Vendimmarries së Prokurorit në lidhje me Kreun 3 të udhëzimit, i cili jep informacion për përdorimin e këtij instrumenti.

4 Shembuj të ndjekjeve penale në praktikë

Ky kre paraqet ilustrime me raste studimore të lidhura me sfidat praktike të ndjekjes penale në këtë fushë, të marra nga kontekste kombëtare. Këto përfshijnë: praktikën e zbatimit të dispozitave të “gjuhës së urrejtjes” për të ndjekur penalisht krimet e urrejtjes, përfshirë në rrethana ku nuk ka ligje të zbatueshme për krimet e urrejtjes, dhe cilësimin e gabuar juridik të veprave penale të urrejtjes. Në këtë kre shqyrtohen gjithashtu shembuj të rasteve të përziera, ku një incident i vetëm përfshin vepra penale që lidhen me krimet e urrejtjes dhe “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale, si dhe vepra “në kufi”, ku incidentet janë të vështira për t'u kategorizuar, pasi përmbajnë karakteristika si të krimeve të urrejtjes ashtu edhe të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale.

SHËNIM: Dispozitat ligjore të përmendura në rastet studimore në këtë kre janë ato që ishin në fuqi në kohën kur janë ndjekur penalisht incidentet. Shënimet në fund të faqes u referohen teksteve ashtu siç kanë qenë; kodet aktuale mund të jenë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme.

4.1 ZBATIMI I DISPOZITAVE TË “GJUHËS SË URREJTJES” PËR NDJEKJEN PENALE TË KRIMEVE TË URREJTJES

Ky seksion përmban dy raste studimore ku janë përdorur dispozitat e “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale për të ndjekur penalisht veprat e krimeve të urrejtjes.

4.1.1 RASTI 1

Ky rast ka ndodhur në bashkinë Žepče, kantonin Zenica-Doboj, Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 2022 dhe u ndoq penalisht sipas ligjit në fuqi.

*Përmbledhje e shkurtër e çështjes*¹⁰⁶

Gjatë natës, dy persona i kanë rezistuar arrestimit nga policia dhe kanë sulmuar dy punonjës policie, pasi u është kërkuar të ndalojnë në anë të rrugës për shkelje të shumta të rregullave të trafikut. Autorët ishin të përkatësisë etnike kroate ndërsa policët kishin distinktivë me emrat e tyre në uniforma që tregonin identitetin e tyre etnik boshnjak. Teksa njëri nga punonjësit e policisë po shënonte me shkrim një gjobë kundër shoferit, shoferi i tha: “Ti je ai sherifi nga Zavidovići¹⁰⁷ që erdhi në Zhepçe për të vendosur rendin” dhe shau me fyerje raciste antiboshnjake. Shoferi gjithashtu i hodhi nga duart policit dokumentacionin zyrtar. Punonjësi i policisë është përpjekur të kapë shoferin, i cili është kundërpërgjigjur duke e shtyrë policin dhe duke i shkelmuar nga duart elektrikun e dorës dhe prangat. Në të njëjtin moment pasagjeri ka dalë nga automjeti dhe ka sulmuar të njëjtin polic duke e kapur nga jeleku dhe duke ia grisur atë. Shoferi grisi edhe këmbishën e punonjësit të policisë. Punonjësi i dytë i policisë, duke synuar të ndihmonte kolegun e tij, e kapi pasagjerin nga duart në mënyrë që kolegu të kapte shoferin. Pasagjeri i ka rezistuar arrestimit duke sulmuar policin e dytë, duke i flakëritur me shkelm syzet, celularin dhe distinktivin. Më në fund, edhe ai u kap. Shoferi ofendoi dhe kërcënoi më tej punonjësin e parë të policisë, përfshirë me sharje antiboshnjake dhe duke thënë: “Herët a vonë do të të ther. Ju keni ardhur këtu në territorin e *ustaša*-s”¹⁰⁸ për të zbatuar ligjet.”

Si pasojë e këtij sulmi, të dy policët pësuan lëndime të lehta trupore.

Vendimi i prokurorisë

Drejtuesi i automjetit dhe pasagjeri u akuzuan për “Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së punës së sigurisë”. Shoferi u akuzua gjithashtu për “Nxitje të urrejtjes, përçarjes ose armiqësisë kombëtare, për shkaqe racore ose fetare”. Të dy të akuzuarit akuzohen për kryerjen e këtyre veprave penale si bashkëpunëtorë.

Koment

Kur analizohet qasja e ndërmarrë nga autoritetet e ndjekjes penale duhen marrë parasysh disa pika. Elementet thelbësore të nenit 163 të Kodit Penal të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës¹⁰⁹ (FbIH) janë: a) publiciteti, b) nxitja, c) urrejtja, për-

106 Ky rast ka ndodhur në një komunitet të përzier. Kantoni Zenica-Doboj, bashkia Žepče, i përbërë nga kroatë etnikë dhe boshnjakë etnikë, me një histori ndarjeje etnike dhe dhune.

107 Qyteti aty pranë ishte 90% i banuar nga boshnjakë.

108 Ustashe ishte një organizatë kroate fashiste dhe ultranacionaliste aktive, si organizatë e vetme, në periudhën nga viti 1929 deri në 1945, e njohur zyrtarisht si Ustaša — Lëvizja Revolucionare Kroate. Shih, p.sh., *Ustaša | Regjimi Fashist, Gjenocidi dhe Krimet e Luftës | Britannica*.

109 Kodi Penal i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, neni 163, në vitin 2022: “Kushdo që publikisht nxit dhe ndez urrejtje, përçarje ose armiqësi kombëtare, racore ose fetare, midis popujve përbërës dhe të tjerëve që jetojnë në Federatë, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.” (Në gjuhën boshnjake, përkthim jozyrtar).

çarja ose armiqësia kombëtare, racore ose fetare, , d) popujt përbërës. Elementi a), publiciteti, nënkupton një shkelje të kryer publikisht me një audiencë që është në gjendje të shohë, dëgjojë ose lexojë, dhe jo një vepër të kryer në një vend publik. Me rëndësi është se vetë neni 163 parashikon se vepra penale duhet të jetë nxitje ose nderje e urrejtjes (si veprim i vazhdueshëm) midis "popujve përbërës dhe të tjerëve që jetojnë në FBIH".

Në këtë rast, vetëm katër persona kanë qenë në dijeni të sulmit në momentin e krimit (dy policët dhe dy autorët), dhe ngjarja ka ndodhur në orën 04:20 në një zonë relativisht të izoluar. Kjo vepër penale duhet të kryhet me dashje dhe, duke pasur parasysh rrethanat, është e vështirë të tregohet se të akuzuarit sulmuan punonjësit e policisë me qëllim që të nxisnin urrejtje midis popujve përbërës ose të tjerëve në FBIH ose duke qenë në dijeni se një përfundim i tillë do të ishte rezultat i mundshëm i veprimeve të tyre. Prandaj, nëse nuk ka audiencë ose vetëdije për incidentin, është e vështirë të argumentohet se një akt është, me të vërtetë, nxitje e urrejtjes midis popujve të caktuar.

Duke marrë parasysh sa më sipër, do të kishte qenë e mundur për prokurorin të ngrinte një akuzë në bazë të nenit 359 të Kodit Penal, pika 2, "Sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së punës së sigurisë",¹¹⁰ kryer me motivin e paragjykit. Neni 2.11 i Kodit Penal e parashikon paragjykimin si rrethanë rënduese për çdo vepër penale.¹¹¹ Me një akuzë të tillë, edhe nëse prokurori nuk do të ishte në gjendje të vërtetonte motivin e paragjykit, ka të ngjarë të kishte prova të mjaftueshme për të vërtetuar se sulmi, pra vepra themelore, ka ndodhur në të vërtetë. Është e rëndësishme që prokurorët të vënë në dukje në këto raste se treguesit e paragjytimeve të sharjeve racore që shoqërojnë kryerjen e një krimi të urrejtjes nuk duhet të "akuzohen dyfish" si "gjuhë urrejtjeje" dhe krim urrejtjeje. Në këto raste, ndjekjet penale për krimet e urrejtjes dhe "gjuhën e urrejtjes" janë strategji alternative dhe nuk duhet të kombinohen.

Zbatimi i Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit

- Përgjigja për pyetjen 1 dhe 2 është "po". Incidenti përmban tregues të fortë paragjykimi, duke përfshirë dallimin e përkatësisë etnike ndërmjet viktimave dhe të akuzuarve; dhe dhunën e përvokuar. Një tregues kryesor i paragjykit ishte gjithashtu gjuha/shprehja specifike e përdorur gjatë sulmit.

110 Po aty, neni 359, para. 2, i vitit 2022: "Kushdo që sulmon ose kërcënon seriozisht se do të sulmojë një person zyrtar ose një person që ndihmon një person zyrtar në kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me sigurinë publike ose sigurinë e Federatës, ose detyra që lidhen me ruajtjen e rendit publik, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet." (Në gjuhën boshnjake, përkthim jozyrtar).

111 Po aty, neni 2.11, i vitit 2022: "Krimi i urrejtjes është çdo vepër penale e kryer për shkak të racës, ngjyrës, besimit fetar, origjinës kombëtare ose etnike, gjuhës, aftësisë së kufizuar, seksit, orientimit seksual ose identitetit gjinor. Një veprim i tillë konsiderohet rrethanë rënduese, përveç rasteve kur ky Kod parashikon shprehimisht një dënim më të rëndë për formën e rëndë të krimit të kryer për shkak të urrejtjes." (Në gjuhën boshnjake, përkthim jozyrtar).

- Përgjigja për pyetjen 3 është “po”. Incidenti përfshinte disa sulme, të cilat do të mbeten krime edhe pa shprehjen e paragjykit. Në këtë rast, prokurori duhet të ndjekë anën e majtë të pemës së vendimmarrjes për të përcaktuar llojin e veprës penale të krimit të urrejtjes dhe për të përcaktuar zbatueshmërinë e legjislacionit përkatës kombëtar.
- Pyetja 4 (për çfarë krimi bëhet fjalë?): vepra bazë mund të ishte identifikuar si neni 359 i Kodit Penal, paragrafi 2, “Sulm ndaj një personi zyrtar gjatë ushtrimit të punës së sigurisë” (4a).
- Pika 5: Treguesit e paragjykit u identifikuan më sipër dhe provat duhet të merreshin përmes deklaratave të dëshmitarëve nga dy punonjësit e policisë.
- Pika 6: Dispozita përkatëse e motivit të paragjykit identifikohet si neni 2.11, rritja e përgjithshme e dënimit, e cila e përcakton paragjykimin si rrethanë rënduese për çdo vepër penale (6c).

Vëzhgime të tjera

- Në zgjedhjen e akuzës për nxitjen e urrejtjes në vend të akuzës si krim urrejtjeje, zyra e prokurorit mund të përballet me vështirësi sa i takon vërtetimit të elementeve të veprës penale, gjë që mund të çojë në pafajësi për të gjitha akuzat.
- Shprehja e paragjykit e përshkruar në këtë rast dukej në fakt të ishte provë e një motivi të mundshëm diskriminimi për sulmet dhe jo të përbënte veprën penale të nxitjes së dhunës ose urrejtjes.
- Nëse prokurori nuk arrin të provojë nxitjen e urrejtjes, dënimi më i butë që do të jepej në këtë rast do të kontribuonte *de facto* në pandëshkueshmëri për motivin e paragjykit. Kjo, nga ana tjetër, nuk përmbush qëllimin ligjor të dënimit, sipas nenit 42 të Kodit Penal, domethënë, për të dënuar veprën, për të penguar si autorin në fjalë, ashtu edhe të tjerët që të kryejnë vepra të tilla dhe për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit për rrezikun e veprës penale. Një pasiguri dhe mungesë e tillë njëtrajtshmërie mund të cenojë qëllimin e sanksionimit, i cili duhet të jetë proporcional me shkeljet e autorit dhe i cili, me individualizimin e dënimit, duhet të shërbejë si baza ku mbështeten sanksionet që kërkohen/zbatohen.
- Në rastet kur akuzat jo të duhura i mbijetojnë shqyrtimit gjyqësor, krijohet jurisprudencë e bazuar në përshkrime faktike që nuk përkojnë me elementet e krimit të pretenduar. Kjo mund të vërë në pikëpyetje ligjshmërinë dhe drejtësinë e proceseve gjyqësore, të cilat janë të rëndësishme për aspekte më të gjera të sistemit të drejtësisë penale në tërësi.

Më në përgjithësi, ky rast ilustron një model praktike në vendet ku dispozitat e “gjuhës nxitëse” mund të mbipërdoren për të ndjekur penalisht krimet e urrejtjes. Për të shmangur këto zbatime të gabuara të ligjit, nevojiten përpjekje të shumë agjencive për të garantuar marrjen e vendimeve të sakta në të gjitha fazat e procesit, nga hetimi, përgjatë ndjekjes penale deri te dënimi.

Ndikimi mbi të dhënat

Sipas nenit 163 të Kodit Penal, baza e të dhënave gjyqësore duhet të kishte të dhëna për këtë çështje si vepër penale më vete e nxitjes publike të urrejtjes. Për rrjedhojë, këto të dhëna do të jepnin një përshtypje jo të drejtë për përhapjen e “gjuhës së urrejtjes” si krim, dhe mungesën e përgjithshme të krimeve të urrejtjes, dhe do të çonin në vendime politikash të mbështetura në informacion të pasaktë. Viktimat si të krimeve të urrejtjes ashtu edhe të “gjuhës së urrejtjes” duhet të jenë në gjendje të mbështeten te të dhënat e disponueshme për të kuptuar të drejtat e tyre dhe për të menaxhuar pritshmëritë. Të dhënat e sakta janë gjithashtu të nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjerë mbi natyrën dhe përhapjen e krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale.

Implikimet e mundshme për viktimat

Akuzat e përzgjedhura nga prokurori nuk i njohin punonjësit e policisë si viktimat të krimit të urrejtjes dhe policët janë intervistuar si dëshmitarë dhe jo si palë të dëmtuara. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se, gjatë shqyrtimit gjyqësor, kryetari i trupës gjyqësore i pyeti policët nëse do të dëshironin të parashtronin kërkesë për kompensim si rezultat i dëmit të shkaktuar ndaj tyre.

4.1.2 RASTI 2

Ky rast është përshtatur nga një rast i botuar në faqen e internetit të Komisionit Federal Zviceran kundër Racizmit.¹¹² Rasti ka ndodhur në Zvicër dhe është gjykuar në vitin 2016 sipas ligjit në fuqi.

Përmbledhje e shkurtër e çështjes

Një grua që përdorte një mjet ndihmë për lëvizje i kërkoi një shoferi të lëvizte makinën në mënyrë që ajo të mund të përdorte pjesën e ulur të trotuarit për të hyrë në një dyqan. Shoferi nuk pranoi të lëvizte automjetin dhe i bërtiti asaj nga dritarja duke i thënë “kujdesu vetë për veten”. Një kalimtare u afrua për ta ndihmuar gruan. Shoferi i drejtoi sharje raciste dhe konkretisht antishqiptare kalimtares dhe e goditi me grusht, duke i shkaktuar një plagë dy centimetra në fytyrë.

112 Ky rast është përshtatur nga faqja e internetit e Komisionit Federal Kundër Racizmit, Zvicër.

Vendimi i prokurorisë

Organi i ndjekjes penale i cilësoi veprat si lëndim të thjeshtë trupor (neni 123.1, par. 1), fyerje (neni 177, par. 1) dhe diskriminim racor (neni 261bis, par. 4). Ai argumentoi se kur shprehjet raciste përdoren për të portretizuar shqiptarët si njerëz me vlerë më të vogël, ato përbëjnë një sulm ndaj dinjitetit njerëzor dhe se nuk është e nevojshme që personat e diskriminuar t'i përkasin “racës”, grupit etnik ose fesë së pretenduar.

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin për të tria akuzat e renditura më sipër. Ai u dënua me një gjobë materiale prej 60 ditësh në vlerën 30.00¹¹³ franga zvicerane dhe mbulimin e shpenzimeve të procesit gjyqësor në vlerën e 510.00 frangave zvicerane.

Koment

Neni 261bis para. 4 i Kodit Penal të Zvicrës¹¹⁴ është një dispozitë komplekse që përmban si krimet e urrejtjes ashtu edhe veprat e “gjuhës së urrejtjes” dhe, si rezultat, zbatimi i saj mund të paraqesë vështirësi sa i takon ndjekjes penale. Formulimi i dispozitës është: “Kushdo që publikisht, me fjalë, shkrim, imazh, gjest, me sulm ose në ndonjë mënyrë tjetër, poshtëron ose diskriminon në një mënyrë që cenon dinjitetin njerëzor një person ose një grup njerëzish për shkak të racës, etnisë ose përkatësia fetare ose orientimit të tyre seksual [...] dënohet me burgim deri në tre vjet ose me gjobë.” Elementet që i referohen “publikisht”, “fjalëve, shkrimit, imazhit dhe gjestit” në pjesën e parë të dispozitës korrespondojnë me “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale, ndërsa “sulmi” mund të korrespondojë me veprën bazë të një krimi të urrejtjes.

Në këtë rast, një dispozitë tjetër relevante që nuk është përdorur është neni 47 i Kodit Penal të Zvicrës, i cili mund të zbatohet si dispozitë e përgjithshme për rritjen e dënimit: (1) Gjykata e cakton dënimin në bazë të fajit të autorit. Ajo merr parasysh sjelljen e mëparshme dhe rrethanat personale të autorit, si dhe efektin që do të ketë dënimi në jetën e tij. (2) Fajësia vlerësohet në bazë të ashpërsisë së dëmit ose rrezikut mbi interesin ligjor në fjalë, dënueshmërisë së sjelljes, **moti-veve dhe qëllimeve të autorit**, dhe nivelit në të cilën autori, duke pasur parasysh rrethanat personale dhe të jashtme, mund të kishte shmangur shkaktimin e rrezikut ose dëmtimit.

Është gjithashtu e mundur për prokurorët që të ndajnë këtë dhe raste të ngjashme me politikëbërësit për të ilustruar mangësitë dhe vështirësitë e shkaktuara nga legjislacioni kombëtar aktual. Për shembull, shumë krime të urrejtjes mund

113 Një ditë gjobë ('un jour-amende') është e barabartë me një ditë burgim (neni 36 i Kodit Penal të Zvicrës). Në rast të pagesës së pjesshme të dënimit financiar, kohëzgjatja e dënimit me burg reduktohet në varësi të shumës së paguar. Vlera e gjobës ditore përcaktohet nga gjyqtari.

114 [Kodi Penal Zviceran](#), SR 311.0, i 21 dhjetorit 1937 (Statusi që nga 1 korriku 2024).

të jenë jashtë fushës së mbrojtjes së neni 261bis para. 4 për shkak të kërkesës që vepra të kryhet “publikisht”. Për më tepër, opsioni i përgjithshëm i rritjes së dënimit i ofruar nga neni 47 nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare të rëndësishme për ligjet për krimet e urrejtjes, të cilat rekomandojnë që të specifikohen karakteristikat e mbrojtura në lidhje me “motivin”.¹¹⁵

Zbatimi i Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit

- Në këtë rast, përgjigjja për pyetjen 1 dhe 2 është “po”. Incidenti përmban tregues të fortë të paragjykit, dhunës së paprovokuar dhe gjuhës/shprehjes specifike të përdorur gjatë sulmit. Mund të ishin gjithashtu të pranishëm edhe tregues të tjerë të paragjykit, si perceptimi i viktimës dhe përkatësia e ndryshme etnike ndërmjet viktimave dhe të akuzuarit.
- Përgjigjja për pyetjen 3 është gjithashtu “po”. Incidenti përfshinte një sulm, i cili do të mbetej një krim edhe pa shprehjen e paragjykit. Në këtë rast, prokurori duhet të ndjekë anën e majtë të pemës së vendimmarrjes për të përcaktuar llojin e veprës penale të krimit të urrejtjes dhe për të përcaktuar zbatueshmërinë e legjislacionit përkatës kombëtar.
- Pyetja 4 (për çfarë krimi bëhet fjalë?): Vepra penale bazë e lëndimit të thjeshtë trupor (neni 123.1, paragrafi 1) duket se përputhet më mirë me incidentin dhe ishte një nga cilësimet juridike të zgjedhura nga prokurori. Dy akuzat e tjera për fyerje dhe diskriminim racor mund të mos jenë të nevojshme, sepse fyerjet janë të lidhura ngushtë me sulmin dhe, për këtë arsye, interpretohen më saktë si tregues të motivit paragjykit për sulmin dhe jo si vepra të veçanta shitesë. Incidenti, duke përfshirë motivin e paragjykit, duket se është trajtuar siç duhet si një sulm me rrethana rëndësuese për shkak të racës (shih pikën 6 më poshtë).
- Pika 5: Treguesit e paragjykit janë identifikuar më lart dhe provat duhet të merren përmes deklaratave të dëshmitarëve të dy viktimave: gruaja që përdor një mjet për ta ndihmuar për të ecur dhe kalimtarja që u sulmua.
- Pika 6: Dispozita përkatëse e motivit të paragjykit është neni 47 i Kodit Penal Zviceran, i cili mund të zbatohet në këtë rast si një dispozitë e përgjithshme për rritjen e dënimit (6c). Në juridiksionet ku ligji për krimet e urrejtjes është një dispozitë për rritjen e dënimit dhe dënimi dhe fajësia janë faza të veçanta të procesit gjyqësor, gjyqtari mund të refuzojë dënimin mbi bazën e një motivi paragjykim nëse elementi i paragjykit nuk përfshihet në prova gjatë fazës së gjykit. Në mënyrë të ngjashme, në rastin e pranimit të fajësisë, motivimi duhet të përfshihet brenda fakteve të pranuar në mënyrë që të zbatohet rritja e dënimit. Në juridiksionet ku ligjet për krimet e urrejtjes përdoren rrallë, mund të jetë e dobishme për

¹¹⁵ Për një shpjegim dhe diskutim të karakteristikave të mbrojtura në ligjet për krimet e urrejtjes, shihni seksionin 2.1.3 të këtij udhëzuesi dhe OSBE/ODIHR, [Ligjet për krimin e urrejtjes](#), f. 46–56.

prokurorët të sigurojnë që dosja e çështjes të përfshijë një analizë të qartë se përse dënimi duhet të marrë parasysh motivin e paragjykit. Analiza duhet të specifikojë qartë praninë e një motivi racist ksenofobik, duke përfshirë referenca ndaj standardeve ndërkombëtare, dhe të bazohet në argumente që tregojnë se autori e ka zgjedhur viktimën për shkak të karakteristikës së mbrojtur të saj, ose që paragjykimi është demonstruar gjatë sulmit. Kjo duhet të jetë e mjaftueshme që gjykata ta konsiderojë veprën penale si krim urrejtjeje.¹¹⁶

- Pika 6d: Prokurorët mund të përdorin gjithashtu këtë dhe raste të ngjashme si provë të mangësive të mundshme në ligjet kombëtare të krimeve të urrejtjes, të cilat aktualisht nuk njohin motive të veçanta paragjyqimesh, si p.sh. motivin për shkaqe raciste ose ksenofobike.

Ndikimi mbi të dhëna

Siç u shpjegua më lart, dispozita që u përdor për të ndjekur penalisht incidentin e përshkruar në këtë rast përfshinte një përzierje të krimeve të urrejtjes dhe veprave të tjera. Si rezultat, të dhënat specifike të krimit të urrejtjes nuk do të ishin të disponueshme për autoritetet dhe politikëbërësit.

Implikimet e mundshme për viktimat

Mungesa e pasqyrimin të krimeve të urrejtjes në të dhënat dhe statistikën zyrtare mund të pengojë përpjekjet për të mbrojtur shërbimet e specializuara të viktimave ose trajnimin për autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore.

4.2 PËRDORIMI I DISPOZITAVE TË “GJUHËS SË URREJTJES” SI VEPËR PENALE NË MUNGESË TË DISPOZITAVE PÛRKATËSE TË KRIMIT TË URREJTJES

Në kontekstet ku nuk ka ligje të zbatueshme për krimet e urrejtjes, prokurorët mund të kërkojnë të zbatojnë dispozitat e “gjuhës së urrejtjes” për të ndjekur penalisht një krim urrejtjeje. Ndërsa kjo mund të jetë një taktikë e kuptueshme në përpjekjet për ta njohur urrejtjen si vepër penale, ajo rrezikon të minojë parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, të cilat kërkojnë që individët të akuzohen për veprën që përputhet me sjelljen e tyre.

116 OSBE/ODIHR, *Ndjekja penale e krimeve të urrejtjes*.

4.2.1 RASTI 3

Ky rast studimor është përshtatur nga një rast i botuar në faqen e internetit të Gjykatave të Rrethit të Islandës.¹¹⁷ Rasti ka ndodhur në Rejkjavik në vitin 2016 dhe është ndjekur penalisht sipas ligjit në fuqi.

Përmbledhje e shkurtër e çështjes

Viktima, me prejardhje arabe dhe myslimane, punonte si roje sigurie në një dyqan. Gjatë një incidenti të zgjatur, autori i veprës, një burrë islandez, e kapi viktimën prej fyti duke i bllokuar rrugët e frymëmarrjes, e goditi me bërryl në kokë dhe trup, e shtyu në cep dhe i shkaktoi rënien në parmakë. Këto veprime u shoqëruan me kërcënime për vrasje. Viktima pësoi fraktura në brinjë, mavijosje në gjoks, lëndime në kokë dhe ndrydhje të qafës.

Gjatë incidentit, autori e shau viktimën dhe tha se do të kujdesej personalisht që arabët që punonin në dyqan të pushoheshin nga puna. Ai tha gjithashtu se “ju arabët nuk duhet të jeni këtu dhe duhet të shkoni në shtëpitë tuaja” dhe e ofendoi viktimën me një përzierje sharjesh raciste dhe homofobike.

Vendimi i prokurorisë

Në kohën kur ndodhi vepra penale, në vitin 2016, Kodi Penal i Islandës¹¹⁸ nuk përfshinte veprën e krimeve të urrejtjes. Çështja u procedua duke përdorur nenin 218 (Kanosja), nenin 233 (Sulm me dashje) dhe nenin 233a (Shpifja dhe vepra penale kundër paprekshmërisë së jetës private).

Koment

Edhe pse incidenti ka ndodhur në publik, neni 233a kërkon që autori “të tallë, shpif, denigrojë ose kërcënojë publikisht një person ose grupe njerëzish me komente, ose shprehje një natyre tjetër ... lidhur me origjinën e tyre etnike, ngjyrën, racën, fenë ...”. Ekziston një ndryshim në kuptim midis fjalëve “në publik” dhe “publikisht”. Termi i fundit sugjeron që autori përfshihet në komente dhe shprehje me publikun si audienca e tij e synuar. Në këtë rast, duket se komentet ofenduese kanë qenë të lidhura ngushtë me sulmin dhe kuptohen më mirë si tregues paragjykimi, d.m.th., fyerje dhe gjuhë paragjyuese drejtuar viktimës në fjalë gjatë kryerjes së veprës penale. Të marra së bashku, faktet e çështjes duket se përputhen më mirë me cilësimin juridik të krimit të urrejtjes, pasi sulmi ishte i motivuar nga paragjykimi ndaj “racës” ose fesë ose besimit të viktimës. Elementi i parë i ndjekjes penale të krimit të urrejtjes është sulmi (neni 218), dhe elementi i dytë, motivi i paragjykimit,

¹¹⁷ Faqja e internetit e [Gjykatave të Rrethit të Islandës](#).

¹¹⁸ Kodi Penal i Përgjithshëm i Islandës Nr. 19, 12 shkurt 1940, 1 mars 2004, siç ishte në vitin 2016.

duhet të trajtohet nga rritja e dënimit për veprën penale themelore, pra nga rritja specifik ose e përgjithshme e dënimit mbi dënimin për veprën penale themelore.

Ky incident ndodhi përpara se të parashikohej me ligj rritja e përgjithshëm i dënimit në Islandë. Në këtë situatë, nuk kishte asnjë mjet të disponueshëm për të provuar dhe lejuar ndëshkimin e motivit të paragjykit. Edhe ose prirja për përdorimin e veprave të tjera, në këtë rast neni 233a, mund të jetë e madhe për të kërkuar njohjen e motivit të paragjykit në një sulm racist, prokurorët duhet të jenë të kujdesshëm kur zgjedhin cilësimet juridike që nuk pasqyrojnë plotësisht veprimet e të pandehurit. Akuzat që nuk përputhen me krimin e kryer cenojnë parimet më të gjera të shtetit të së drejtës, si ligjshmëria dhe proporcionaliteti. Në rastet ku nuk ekzistojnë dispozitat e duhura legjislative, prokurorët mund të konsiderojnë rritjen e ndërgjegjësimin për këto mangësi ligjore, në mënyrë që ligjvënësit t'i marrin ato parasysh gjatë rrjedhës së debatit dhe hartimit të legjislacionit për krimet e urrejtjes. Në këtë drejtim, është e rëndësishme që prokurorët të mbledhin shembuj të rasteve të tilla dhe të bëjnë publike të dhëna të tjera që informojnë politikëbërësit për llojet e dispozitave legjislative që janë të nevojshme për ndjekje penale më efektive dhe të drejta të krimeve të urrejtjes.

Zbatimi i Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit

- Në këtë rast, përgjigjja për pyetjen 1 dhe 2 është “po”. Incidenti paraqiti tregues të fortë të paragjykit, duke përfshirë dhunën e paprovokuar, gjuhën/shprehjen specifike të përdorur gjatë sulmit dhe dallimin në përkatësinë etnike ndërmjet viktimës dhe të akuzuarit.
- Përgjigjja për pyetjen 3 është gjithashtu “po”. Incidenti përfshiu një sulm, i cili do të mbetej një krim edhe pa shprehjen e paragjykit. Në këtë rast, prokurori duhet të ndjekë anën e majtë të pemës së vendimmarrjes për të përcaktuar llojin e veprës penale të krimit të urrejtjes dhe për të përcaktuar zbatueshmërinë e legjislacionit përkatës kombëtar.
- Siç u shpjegua më lart, në lidhje me pyetjen 4 (Për çfarë krimi bëhet fjalë?), veprat bazë janë identifikuar si neni 218, kanosja, dhe neni 233, sulm me dashje. Gjithashtu u përzgjedh vepra penale “Shpifje dhe vepra kundër paprekshmërisë së jetës private”; megjithatë, siç u shpjegua më lart, faktet e çështjes nuk duket se përputhen me këtë akuzë.
- Lidhur me pikën 5, edhe në kushtet e mungesës së mjetit juridik për të trajtuar motivin e paragjykit në këtë vepër, është ende e rëndësishme të mblidhen prova të motivit të paragjykit dhe që viktima të informohet për ekzistencën e motivit të paragjykit.¹¹⁹

119 Islanda që atëherë ka miratuar një dispozitë të përgjithshme për rritjen e dënimit: neni 70 (Kreu VIII. Faktorët që ndikojnë për ashpërsimin e dënimit), “Kur vendoset dënimi, duhet të merren parasysh në veçanti faktorët e mëposhtëm. [...] 10. Nëse vepra mund t'i atribuohet origjinës etnike ose kombëtare, ngjyrës, racës, fesë, aftësisë së kufizuar, karakteristikave gjinore, seksualitetit, identitetit gjinor ose faktorëve të tjerë të ngjashëm.” (Në versionin në islandisht, përkthim jozyrtar).

- Lidhur me pikën 6, në kohën e veprës penale, nuk kishte asnjë mjet të disponueshëm për t’i paraqitur gjykatës që ajo të pranonte motivin e paragjykit. Megjithatë, prokurorët kanë mundësi që të marrin parasysh pikën 6d të pemës së vendimmarrjes dhe, siç u shpjegua më lart, të përdorin këta shembuj për të nxjerrë në pah mangësitë ligjore që ekzistojnë për mbrojtjen ligjore të viktimave të krimeve të urrejtjes.

Ndikimi mbi të dhënat

Në kohën e veprës penale, Kodi Penal i Islandës nuk përfshinte një ligj për krimet e urrejtjes. Meqenëse çështja u ndoq penalisht duke përdorur veprat bazë (Kërcënimin dhe sulmin) së bashku me veprën e shpifjes, çështja nuk do të pasqyrohet në asnjë të dhënë ose statistikë të disponueshme për krimet e urrejtjes.

Ndikimet e mundshme mbi viktimat

Kuadri ligjor i kufizuar i krimit të urrejtjes e pengoi gjykatën të njihte dhe të ndëshkonte siç duhet motivin e paragjykit, duke i mohuar viktimës një mjet juridik efektiv. Kjo mangësi gjithashtu kufizon pasqyrimin e krimeve të urrejtjes në të dhënat dhe statistikën zyrtare, duke penguar përpjekjet për të mbrojtur shërbimet e specializuara të viktimave ose trajnimin për autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore.

4.3 RASTE TË PËRZIERA: INCIDENTET QË PËRFSHIJNË KRIMIN E URREJTJES DHE VEPRAT PENALE TË “GJUHËS SË URREJTJES”

4.3.1 RASTI 4

Ky rast ka ndodhur në Liezhë, Belgjikë, në vitin 2023 dhe është ndjekur penalisht sipas ligjit në fuqi.

Përmbledhje e shkurtër e çështjes

Në këtë rast, një familje i siguroi strehim një 35-vjeçari të pastrehë, duke i ofruar atij një vend për të jetuar. Sa më shumë ai përshtatej me mjedisin, aq më shumë ndryshonte sjellja e tij në mënyra specifike. Në emër të besimeve “ekstremiste”, ai shënjestroi vajzën e mitur të familjes në postimet në Facebook, duke deklaruar synimet e tij për t’u martuar me të me detyrim, për ta rrëmbyer atë dhe për të qenë babai i fëmijëve të saj.

Në bazë të deklaratave në polici të babait dhe nënës së viktimës, si dhe të publikimeve të vetë të dyshuarit në rrjetin social Facebook, i pandehuri kishte pohuar se është zgjedhur për Mbret, se viktimë (17 vjeçe) ishte e destinuar për të dhe

se ai do ta bënte atë mbretëreshën e tij, do të martohej me të, do ta kthente në myslimane dhe do të bënte fëmijë me të, pavarësisht kundërshtimeve të prindërve të saj apo çdokujt tjetër.

Viktima u tha hetuesve: “(...) Dje u vura në dijeni nga babai im për videot në rrjetet sociale ku i dyshuari flet për identitetin tim dhe planet e tij me mua. Si rezultat, jam thellësisht e tronditur dhe kam frikë për integritetin tim fizik. Kam frikë të hasem me të. Kam pasur disa raste ku e kam gjetur veten në grupe të ndryshme ku ka qenë i pranishëm edhe ai (vaktet me familjen time) dhe kam mbetur pa fjalë nga sjellja e tij. Ai ka shfaqur interes për mua. Ai ka pasur kontakt me nënën time, por nuk e di se si (...) Sot, nga frika, qëndroj me vëllain tim (...) Mendoj se i dyshuari është i çmendur. Ai shpesh fliste me vete dhe ndonjëherë thoshte me zë të lartë gjëra jo koherente (luftë, konspiracion, ...). Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar përveç se nuk dua ta shoh më atë njeri.”

Babai i viktimës tha: “Kur u mësua më shumë me mua, fjalët e tij u bënë të padurueshme dhe ai u bë agresiv. E dëbova nga shtëpia dhe ndryshova kodin e portës (...) Arrita të regjistroj disa video më pak komprometuese, por situata ishte ende e frikshme (ai është kundër sistemit, etj. ...). Bëra një ankesë dhe kërkova urdhër urgjent mbrojtjeje (...) Kam frikë për integritetin tim fizik, si dhe të vajzës sime. Ai e përmend qartë se kushdo që e pengon do të vuajë pasojat (...)”. Babai e konfirmoi këtë shqetësim të rëndë të qetësisë së tij shpirtërore, duke thënë: “Më frikësoi vërtet me fjalët e tij (...) Më trembi me mostolerancën e tij dhe më jep përshtypjen se mund të dëmtojë dikë. Për mua, ai është një bombë me sahat që endet lirshëm. Komentet e tij për shoqërinë janë të frikshme. Janë vetëm fjalë, por ai më trembi (...) Unë e kam humbur besimin dhe ai më frikëson.”

Gjatë intervistës së tij në polici dhe gjatë gjykimit, i pandehuri pranoi saktësinë e veprimeve dhe deklaratave të tij të raportuara në lidhje me viktimën, por sqaroi në seancën e datës 22 shtator 2023 se: “Qëllimi im ishte i mirë. Nuk doja ta trembja.” Ai shpjegoi gjithashtu se në atë kohë ishte në një gjendje të shqetësuar shpirtërore, të cilën ia atribuoi konsumimit të tepërt të alkoolit dhe drogës.

Përmes profileve të tij në Facebook, ai ka postuar shumë shkrime dhe video personale në të cilat shprehte dëshirën për vdekjen e individëve ndaj të cilëve ushqente urrejtje të madhe. Nga njëra anë, për shkak të origjinës së tyre etnike ose kombëtare, duke synuar veçanërisht individët e bardhë perëndimorë, flamandët, holandezët dhe belgët, dhe nga ana tjetër, për shkak të fesë së tyre, duke synuar veçanërisht të krishterët dhe këdo që nuk ndjek Islamin. Veprimet e tij u përshkallëzuan më tej kur ai i komunikoi këto pikëpamje në mënyrë të përsëritur si në një rrjet televiziv kombëtar ashtu si edhe në zyrën e Kryeministrit.

Vendimi i prokurorisë

Çështja iu caktua një prokurori specialist për krimet e urrejtjes/“gjuhën e urrejtjes”, i cili zgjodhi një përzierje të krimeve të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si akuza. Strategjia e ndjekjes penale të krimit të urrejtjes mbështetej në ndërtimin e çështjes mbi ngacmime të motivuara nga paragjykimet, duke u mbështetur në veprën specifike të ngacmimit dhe një dispozitë të përgjithshme për rritjen e dënimit për të njohur motivin e paragjykimit. Prokurori u mbështet në nenin 78 të Kodit Penal belg¹²⁰ për të argumentuar se “një nga motivet e autorit ishte urrejtja, përbuzja ose armiqësia ndaj një personi për shkak të racës, ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, origjinës kombëtare ose etnike, kombësisë, gjinisë ... besimit fetar ose filozofik të pretenduar..., pavarësisht nëse kjo karakteristikë ishte vërtet e pranishme ose vetëm e supozuar prej tij, ose se një nga motivet e tij përbëhej nga një lidhje reale ose e supozuar midis viktimës dhe një personi ndaj të cilit ai ushtronte urrejtje, përbuzje ose armiqësi për një ose më shumë nga karakteristikat e vërteta ose të supozuara të lartpërmendura, në dëm të BF-së (babait të viktimës) dhe RF-së (viktimës).”¹²¹

Strategjia e ndjekjes penale të “gjuhës së urrejtjes” mbështetej në ndërtimin e një çështjeje për veprën penale themelore të nxitjes së urrejtjes sipas nenit 444 të Kodit Penal belg.¹²² Bazuar në sjelljen e autorit lidhur me publikimin e mesazheve dhe videove në rrjetet sociale “duke uruar vdekjen e të bardhëve perëndimorë, flamandëve, holandezëve dhe belgëve në disa raste në periudhën ndërmjet 1 majit 2023 dhe 8 qershorit 2023”, i pandehuri u akuzua për nxitje të urrejtjes ose dhunës ndaj një grupi, komuniteti ose anëtarëve të tyre për shkak të njërit prej kriterëve të mbrojtura të përmendura në nenin 4, 4° të Ligjit, datë 30 korrik 1981.¹²³

Koment

Korrigjimi i strategjisë së prokurorisë u bë sepse prokurori kujdestar tregoi vëmendjen e duhur për të kërkuar caktimin e kolegut të specializuar. Nëse kjo nuk do të ishte bërë, akuzat specifike të përcaktuara më sipër mund të mos ishin ndjekur kurrë.

Është e rëndësishme të theksohet se akuzat e përzgjedhura ishin potencialisht të paplota. I dyshuari ka publikuar edhe një sërë komentesh me urrejtje për

120 Kodi Penal i Belgjikës, siç ishte në vitin 2023.

121 Është ofruar nga një kontribuues i udhëzuesit, pa u specifikuar burimet.

122 Po aty.

123 *Loi tendant à réprimer certains actes inspirés par le racisme ou la xénophobie* [Ligji për shtypjen e disa akteve të frymëzuara nga racizmi ose ksenofobia], 30 korrik 1981, dhe ndryshimet përkatëse, neni 4, 4°: “kriteret e mbrojtura: kombësia, raca e supozuar, ngjyra e lëkurës, prejardhja ose origjina kombëtare ose etnike; neni 20 4°: “Dënohet me burgim nga një muaj deri në një vit dhe me gjobë nga pesëdhjetë euro deri në një mijë euro, ose një nga këto dënime: cilido që, në një nga rrethanat e parashikuara në nenin 444 të Kodit Penal, nxit urrejtje ose dhunë ndaj një grupi, një komuniteti ose anëtarëve të tyre, për shkak të njërit prej kriterëve të mbrojtura...”, (në frëngjisht, përkthim jozyrtar).

komunitetin LGBTI, por këto veprime nuk mund të ndiqen penalisht, pasi sipas Gjykatës së Kasacionit, ato përbëjnë një vepër shtypi. Neni 150 i Kushtetutës¹²⁴ nuk lejon që një gjykatë penale të gjykojë një vepër shtypi me natyrës homofobike (përgjashtimi i parashikuar nga neni 150 që mbulon vetëm veprat penale të shtypit me natyrë raciste ose ksenofobike). Për këto komente homofobike në Facebook, do të ishte e nevojshme që çështja t'i referohej një gjykate më të lartë, gjë që nuk ishte e realizueshme nga këndvështrimi pragmatik.

Zbatimi i Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit

Në këtë rast, të dyja degët e Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit janë me rëndësi. Së pari, merret parasysh sjellja e autorit ndaj vajzës në familje.

- Përgjigja për pyetjen 1 dhe 2 është “po”. Incidenti përmban tregues të fortë paragjykimi, duke përfshirë perceptimin e viktimës, përkatësitë etnike të ndryshme të viktimave dhe të të akuzuarit, dhe gjuhën/shprehjen specifike të përdorur gjatë sulmit.
- Përgjigja për pyetjen 3 është “po”. Incidenti përfshin ngacmimin, i cili do të mbetej një krim edhe pa shprehjen e paragjykit. Në këtë rast, prokurori ndoqi anën e majtë të pemës së vendimmarrjes për të përcaktuar llojin e veprës penale të krimit të urrejtjes dhe për të përcaktuar zbatueshmërinë e legjislacionit përkatës kombëtar.
- Pyetja 4 (Për çfarë krimi bëhet fjalë?): vepra penale bazë përfshin shprehjen dhe u cilësua si ngacmim (4b).
- Pika 5: Treguesit e paragjykit u identifikuan më sipër dhe provat u siguruan përmes deklaratave të dëshmitarëve të marra nga vajza dhe babai.
- Pika 6: Dispozita përkatëse e motivit të paragjykit identifikohet si një rritje e përgjithshme e dënimit, neni 78 i Kodit Penal belg, i cili e përcakton paragjykimin si rrethanë rënduese për çdo vepër penale (6c).

Së dyti, u shqyrtuan elementet penalë të “gjuhës së urrejtjes” gjatë incidentit.

- Përgjigja për pyetjet 1 dhe 2 është “po”. Profilet e të akuzuarit në Facebook përmbanin shprehje të paragjykit ndaj grupeve specifike etnike dhe fetare.
- Përgjigja për pyetjen 3 është “jo”. Nëse shprehja e paragjykit hiqet nga përmbajtja, atëherë nuk do të kishte krim të cilësueshëm. Për rrjedhojë, përmbajtja e shprehjes përbën veprën e mundshme penale. Në këtë rast, prokurori duhet të ndjekë anën e djathtë të pemës së vendimmarrjes për të përcaktuar objektivin e shprehjes (7), që duket të jetë publiku i gjerë si dhe Kryeministri (7c), dhe qëllimin e shprehjes, i cili është përcaktuar në

124 Kushtetuta e Belgjikës.

pikat 8a, 8c, 8d dhe 8d. Në këtë rast, prokurori e cilësoi shprehjen si nxitje urrejtjeje sipas nenit 444 të Kodit Penal belg (8d).

Ndikimi mbi të dhënat

Meqenëse policia nuk e regjistroi saktë ankesën si krim urrejtjeje dhe “gjuhë urrejtjeje” si vepër penale, ajo nuk do të pasqyrohet si e tillë në statistikën e policisë. Megjithatë, korrigjimi u bë në nivel gjyqësor.

Implikimet e mundshme mbi viktimat

Deklaratat e viktimës dhe familjes së saj tregojnë se sjellja e autorit ka qenë shumë shqetësuese, me ndikim të rëndë në mirëqenien e tyre. Veprimet e prokurorëve dhe rezultati i procesit gjyqësor¹²⁵ gjithashtu u dhanë atyre kompensim dhe siguri.

4.4 TRAJTIMI I ABUZIMIT VERBAL DHE AKTEVE TË GJUHËS NË KUFITË TË KRIMIT TË URREJTJES DHE “GJUHËS SË URREJTJES”

4.4.1 RASTI 5

Rasti ka ndodhur në Budapest, Hungari, në vitin 2021, dhe u ndoq penalisht sipas ligjit në fuqi.

Përmbledhje e shkurtër e çështjes

Një natë, një çift homoseksual po shëtiste në qendër të Budapestit. Gjatë shëtitjes, një burrë filloi të ndiqte çiftin, duke i sharë me fjalë që përbënin abuzim homofobik dhe tha: “Do t’ju arrij dhe do t’ju rrah”. Çifti u përpoq të fshihej në një dyqan që ishte i hapur gjatë gjithë ditës dhe natës, ku burri i zuri ata. Ata u përpoqën të fshiheshin në dyqan, ku autori deshi t’i ndiqte, ndaj njëri prej tyre i zuri rrugën. Pas një debati të shkurtër, autori e qëlloi me pëllëmbë në fytyrë njërin prej viktimave dhe e kapi për qafe. Jashtë dyqanit gjendej një grup prej tre personash për të mbështetur autorin e veprës, dhe vetëm njëri prej tyre u përpoq të mbronte viktimat kur autori e kapi njërin prej tyre nga qafa. Ndërkohë mbërriti patrulla e parë e policisë, pasi viktimat kishin telefonuar disa herë numrin e urgjencës. Një anëtar i grupit që gjendej jashtë dyqanit i tërhoqi flokët njërit prej viktimave në prani të patrullave të policisë dhe komentoi se viktimë ishte “gej”.

¹²⁵ I pandehuri u shpall fajtor për të gjitha krimet dhe u dënua me 20 muaj, përfshirë 10 muaj burg. Ai gjithashtu mori urdhra për trajtim të detyrueshëm dhe iu ndalua kontakti me viktimat dhe të jetonte në të njëjtin fshat për pesë vjet.

Vendimi i prokurorisë

Viktimat kanë telefonuar disa herë në numrin e telefonit të policisë ndërkohë që burri i ndiqte dhe gjithashtu kanë telefonuar edhe kur ishin duke pritur në dyqan në sheshin Kolosy. Në fillim ata u këshilluan të ndalonin dhe të prisnin policinë, por kur autori vazhdoi të afrohej në mënyrë agresive, viktimat vazhduan rrugën. Viktimat ishin në telefon me policinë gjatë gjithë sulmit jashtë dyqanit. Hetimi është nisur në bazë të ankesës së njërit prej viktimave, ndërsa policia ka hetuar rastin për kundërvajtje sulmi. Shoqëria Háttér, e cila ofron mbështetje ligjore dhe praktike për viktimat e krimit të urrejtjes, kërkoi që të vazhdohej hetimi për veprën e krimit të urrejtjes me dhunë ndaj një anëtari të komunitetit. Si rezultat, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë e Qarkut III të Budapestit ia transferoi procedimin penal Departamentit të Policisë Penale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Budapestit, i cili është organi kompetent për hetimin. Shoqëria Háttér kërkoi një përditësim në lidhje me hapat procedural të ndërmarrë, pasi nuk mori asnjë informacion pas transferimit të hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Budapestit.

I pandehuri në këtë rast u akuzua për shqetësim (vandalizëm) sipas nenit 339 të Kodit Penal në vitin 2021.¹²⁶ I pandehuri u dënua me një gjobë (300.000 HUF, përafërsisht 790 EUR).

Koment

Faktet e çështjes tregojnë se incidenti përbënte veprën e krimit të urrejtjes me dhunë ndaj një anëtari të një komuniteti. Treguesit e paragjykit ishin të pranisëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë e Qarkut III të Budapestit ra dakord me kërkesën e Shoqërisë Háttér për transferimin e çështjes tek organi kompetent. Për akuzën e “shqetësimit”, elementi përbërës i krimit është shfaqja e sjelljeve që mund të shkaktojnë zemërim apo alarm te të tjerët dhe, si e tillë, nuk ka viktima të drejtpërdrejta. Nëse krimi do të ishte cilësuar sipas nenit 216, Dhuna kundër një anëtari të komunitetit,¹²⁷ personat e synuar në këtë rast do të kishin të drejtën e pjesëmarrjes në proces si viktima.

126 Seksioni 339 (Shqetësimi Publik) i Kodit Penal të Hungarisë, në vitin 2021 (në hungarisht, përkthim jozyrtar): “(1) Çdo person që shfaq një sjellje në dukje antisociale dhe të dhunshme që synon të nxisë indinjatën ose alarmin te njerëzit e tjerë është fajtor për kundërvajtje të dënueshme me burgim deri në dy vjet, përderisa vepra nuk ka çuar në një vepër penale më e rëndë.

(2) Dënimi për vepër penale është me burgim jo më shumë se tre vjet nëse shkaktohet shqetësim publik: a) në një bandë;

b) në një mënyrë që shqetëson rëndë qetësinë publike;

c) duke ekspozuar një armë vdekjeprurëse; d) duke mbajtur një armë vdekjeprurëse, ose e) në një ngjarje publike.”

127 Seksioni 216 (Dhuna kundër një anëtari të një komuniteti) i Kodit Penal të Hungarisë në vitin 2021 (në hungarisht, përkthim jozyrtar): “(1) Një person i cili, për shkak të faktit se një person tjetër, i përket realisht ose perceptohet se i përket një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar ose një grupi tjetër të shoqërisë, veçanërisht për shkak të paaftësisë së tij, identitetit gjinor ose orientimit seksual, shfaq në mënyrë të dukshme një sjellje antisociale që mund të shkaktojë alarm te anëtarët e grupit përkatës shpallet fajtor për një vepër penale dhe dënohet me burgim deri në tre vjet.”

Zbatimi i Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit

- Në këtë rast, përgjigjja për pyetjen 1 dhe 2 është “po”. Incidenti paraqiti tregues të fortë paragjykimesh, duke përfshirë perceptimin e viktimave, dhunën e paprovokuar dhe gjuhën/shprehjen specifike të përdorur gjatë sulmit.
- Përgjigjja për pyetjen 3 është gjithashtu “po”. Incidenti përfshiu një sulm, i cili do të mbetej një krim edhe nëse nuk do të kishte shprehje të paragjykimit. Në këtë rast, prokurori duhet të ndjekë anën e majtë të pemës së vendimmarrjes për të përcaktuar llojin e veprës penale të krimit të urrejtjes dhe për të përcaktuar zbatueshmërinë e legjislacionit përkatës kombëtar.
- Siç u shpjegua më lart, në lidhje me pyetjen 4 (Për çfarë krimi bëhet fjalë?), veprat bazë duhet të cilësohen sipas nenit 216, Dhuna kundër një anëtari të Komunitetit.
- Pika 5: Treguesit e paragjykimit u identifikuan më lart dhe provat duhet të mbledhen përmes deklaratave të dëshmitarëve të marra nga dy viktimat dhe nga kalimtarët e pranishëm gjatë sulmit.
- Pika 6: është në dorë të prokurorit të përdorë si akuzë formën e rënduar të nenit 216, Dhuna kundër një anëtari të komunitetit, në kohën e kryerjes së veprës penale, e cila është një vepër themelore e krimit të urrejtjes (6a).

Ndikimi mbi të dhënat

Meqenëse çështja nuk është hetuar apo ndjekur penalisht si një krim urrejtjeje, ajo nuk është regjistruar si krim urrejtjeje ose nuk është pasqyruar në të dhënat ose statistikat e krimit të urrejtjes.

Implikimet e mundshme për viktimat

Për arsye kërkimore, Shoqëria Háttér intervistoi një nga viktimat në nëntor të vitit 2022. Procesi gjyqësor pati një ndikim të rëndë tek ai, duke i shkaktuar periudha depresioni. Mosveprimi i policisë, mungesa e informacionit të përshtatshëm e bënë atë të ndihej se “kallëzimi i bërë prej tij ishte futur në një sirtar dhe ishte lënë aty”. Ai nuk mori informacion të përshtatshëm gjatë procesit gjyqësor. Oficerët e policisë nuk treguan asnjë ndjeshmëri ndaj tyre. Ndjesia që ai kishte ishte që çështja e tij ishte një “temë pesë minutëshe” përpara se të gjithë të vazhdonin më tej. Ai ka humbur statusin e viktimës në proces gjyqësor dhe nuk i është bërë asnjë komunikim i akuzave. Ai dhe përfaqësuesit e tij ligjorë u informuan vetëm për qëndrimin e prokurorisë në seancën gjyqësore, pa paralajmërim. Ai tha se si pasojë e kishte humbur besimin te sistemi i drejtësisë penale. Në përgjithësi, cilësimi i gabuar i krimeve të urrejtjes kufizon pasqyrimin në të dhënat dhe statistikat

zyrtare, duke penguar përpjekjet për të mbrojtur shërbimet e specializuara të viktimave ose trajnimin për autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore.

4.4.2 RASTI 6

Ky rast është përshtatur nga Raporti 2010–2011 për krimet e urrejtjes dhe krimet kundër të moshuarve¹²⁸ i Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës për Anglinë dhe Uellsin. Rasti ka ndodhur në Uest Jorkshir, Angli, dhe është ndjekur penalisht sipas ligjit në fuqi.

Përmbledhje e shkurtër e çështjes

Tre burra me aftësi të kufizuara intelektuale dhe ndihmësi i tyre ishin jashtë në qendër të qytetit kur një burrë, i pandehuri, iu afrua pranë dhe u kërkoi para. Kur ata refuzuan t'i jepnin para, i pandehuri u bë shumë agresiv dhe filloi të bërtiste, duke përdorur ofendime invaliditeti ndaj burrave. Ndihmësi i inkurajoi tre burrat të shkonin në një kishë aty pranë dhe më pas mori në telefon policinë. I pandehuri i ndoqi burrat në kishë, ku u identifikua nga ndihmësi dhe u arrestua nga policia me dyshimin për kryerjen e veprës penale të prishjes së rendit publik në rrethana rënduese për shkak të paaftësisë së viktimave, të parashikuar në seksionin 4a. Policia mori deklaratën e dëshmitarit nga ndihmësi. Tre burrave nuk u morën deklarata sepse ata ishin shumë të shqetësuar.

Vendimi i prokurorisë

Autori u akuzua sipas nenit 4a të Ligjit për Rendin Publik të vitit 1986 në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. I pandehuri u deklarua i pafajshëm, por u dënua pas gjykimit me një urdhër për shërbim në komunitet për 12 muaj me 12 muaj mbikëqyrje, si dhe ndjekjen e një kursi gjashtë-mujor për trajtim varësie ndaj alkoolit. Gjatë seancës së dënimit, prokurori ndoqi udhëzimet kombëtare për të tërhequr vëmendjen e gjykatës për ligjin përkatës që lejon gjykatën të njohë faktorin rëndues të “urrejtjes për shkak të aftësisë së kufizuar” në vendimin e saj të dënimit.

Koment

Ka disa pika për t'u marrë parasysh në këtë rast. Seksioni 4A i Ligjit për Rendin Publik të vitit 1986,¹²⁹ Ngacmimi, alarmimi ose shqetësimi me dashje është një shkelje themelore dhe parashikon sa vijon:

128 Raporti 2010–2011 për krimet e urrejtjes dhe krimet kundër të moshuarve, Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës për Anglinë dhe Uellsin, 2011, f. 28.

129 Mbretëria e Bashkuar, Ligji për Rendin Publik 1986, Seksioni 4A.

"Një person është fajtor për një vepër penale nëse, me synimin për t'i shkaktuar një personi tjetër ngacmim, alarmim ose shqetësim, ai-

- (a) përdor fjalë ose sjellje kërcënuese, fyese ose poshtëruese, ose sjellje të çrregullt, ose
- (b) shfaq shkrime, shenja ose pamje të tjera të dukshme që janë kërcënuese, fyese ose fyese,

duke i shkaktuar atij personi ose një tjetri ngacmim, alarmim ose shqetësim.

Në këtë ngjarje i pandehuri u ka bërë titur tre burrave pasi ata nuk i kanë dhënë para. Më pas i ka ndjekur në kishë ku ata kishin kërkuar mbrojtje.

I pandehuri gjithashtu i shau dhe i ofendoi burrat, duke demonstruar kështu armiqësi ndaj aftësisë së kufizuar në kohën e kryerjes së veprës themelore të shkeljes së rendit publik. Në këtë rast zbatohet neni 66 i Ligjit të Dënimit të vitit 2020 (s.66 SA)¹³⁰.

Formulimi përkatës është si më poshtë:

"Neni 66 Armiqësia

Ky seksion zbatohet kur një gjykatë shqyrton ashpërsinë e një veprë penale e cila rëndohet nga:

...

(c) armiqësia në lidhje me aftësinë e kufizuar,

...

Kjo bie në fushën e veprimit të nënseksionit (3).

(2) Gjykata -

duhet të trajtojë si faktor rëndues faktin që vepra është rënduar nga armiqësia e ndonjërit prej këtyre llojeve, dhe

duhet të deklarojë në gjykatë të hapur se vepra është kryer në rrethana rënduese.

130 Ligji përkatës në atë kohë ishte Seksioni 146, Ligji i Drejtësisë Penale 2003, i cili që atëherë është përfshirë në Ligjin e Dënimit të vitit 2020.

...

Për qëllimet e këtij seksioni, një vepër kryhet në rrethana rënduese kur ekziston armiqësia e një prej llojeve të përmendura në nënseksionin (1) nëse-

(a) në kohën e kryerjes së veprës penale, ose menjëherë para ose pas kryerjes së saj, autori i veprës ka treguar armiqësi ndaj viktimës së veprës penale për shkak të:

...

(iii) një paaftësie (ose paaftësie të supozuar) të viktimës,

...

(b) vepra ishte e motivuar (plotësisht ose pjesërisht) nga—

...

(iii) armiqësia ndaj personave që kanë një paaftësi ose një paaftësi të veçantë,

...

(5) Për qëllimet e paragrafëve (a) dhe (b) të nënseksionit (4), është e parëndësishme nëse armiqësia e autorit bazohet ose jo, në çfarëdo mase, në ndonjë faktor tjetër që nuk përmendet në atë paragraf.

(6) Në këtë seksion -

...

(d) “paaftësi” nënkupton çdo kufizim fizik ose mendor;

...

(f) “i supozuar” do të thotë i supozuar nga autori.”

Në këtë rast, ishin të pranishëm të dyja elementet e ndjekjes penale të krimit të urrejtjes – vepra themelore dhe motivi i paragjykitimit.

Shqyrtimi i dytë është se si zbatohet rritja e dënimit nga gjykata. Nëse i pandehuri pranon veprën bazë, por mohon elementin e krimit të urrejtjes, detyra e prokurorit është të paraqesë më pas provat për të vërtetuar elementin e krimit të urrejtjes në standardin penal. Vetëm pasi elementi i krimit të urrejtjes pranohet nga i pandehuri ose vërtetohet nga prokuroria, gjykata mund të zbatojë s.66 SA 2020 për të rritur dënimin e të pandehurit.

Pasi të pranohet ose vërtetohet elementi i krimit të urrejtjes, praktika gjyqësore e Anglisë dhe Uellsit kërkon që gjykata të miratojë qasjen e mëposhtme me dy faza për dënimin:

- Së pari, gjykata duhet të llogarisë (duke përdorur udhëzimet përkatëse të dënimit) dënimin e duhur nëse nuk ka pasur motiv paragjykim dhe ta shpallë atë në gjykatë të hapur;
- Së dyti, gjykata duhet të llogarisë dënimin e duhur, duke marrë parasysh faktorin shtesë rëndues të motivit të paragjykitimit dhe ta shpallë atë në gjykatë të hapur si dënimin konkret që merr i pandehuri.

Zbatimi i Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit

- Përgjigja e pyetjeve 1 dhe 2 është “po”. Incidenti përfshinte tregues të fortë paragjykimesh, nëpërmjet gjuhës/shprehjeve specifike të përdorur gjatë incidentit.
- Përgjigja e pyetjes 3, “A është incidenti krim nëse hiqen shprehjet e paragjykitimit”, e vendos incidentin në kufirin e krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale. I pandehuri bërtiste dhe i ndiqte tre burrat me aftësi të kufizuara intelektuale. Këto akte në vetvete mund të përbëjnë “synim për të shkaktuar ngacmim, alarmim ose shqetësim të një personi”. Përfshirja e fyerjeve të personave me aftësi të kufizuara si pjesë e sjelljes ngacmuese është gjithashtu e rëndësishme për pyetjen nëse sjellja e të pandehurit përputhet me veprën penale. Për rrjedhojë, është në dorën e prokurorit të vlerësojë se përmbajtja e të gjithë shprehjes përfshin krimin.
- Duke ndjekur pemën e vendimmarrjes poshtë në krahun e djathtë, përgjigja e pyetjes 7, “Kujt i drejtohet gjuha” është një përzierje e objektivave individuale (7a) dhe një grupi të synuar specifik (7b).
- Në përgjigje të pyetjes 8, sjellja i përshtatet përshkrimit të pikës 8b “abuzive, shqetësuese, alarmuese”, që çon në veprat “kufitare” të “prishjes së qetësisë”, “shqetësimit” dhe në këtë rast, veprës së “rendit publik”. Është e rëndësishme të theksohet se, në varësi të fakteve dhe rrethanave

të sakta të çështjes dhe legjislacionit në fuqi, prokurorët mund të marrin parasysh akuza si kërcënime ose ngacmime, ose fyerje krahas prishjes së qetësisë, shqetësimit dhe veprave të tjera të ngjashme.

- Në pikën 6, prokurori zgjodhi t'i kërkonte gjykatës një rritje të përgjithshme dënimi, e cila u pranua prej kësaj të fundit.

Ndikimi mbi të dhënat

Udhëzimet mbi regjistrimet për prokurorët në Angli dhe Uells lejojnë që ky dhe incidente të ngjashme të regjistrohen si krim i urrejtjes për shkak të aftësisë së kufizuar, edhe pse Kodi Penal nuk parashikon vepra themelore të krimit të urrejtjes për shkak të aftësisë së kufizuar. Kjo qasje është veçanërisht pozitive sepse lejoi që incidenti të pasqyrohej në të dhënat e performancës së prokurorisë dhe gjithashtu të theksohej në raportin vjetor të krimit të urrejtjes të Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës.

Implikimet e mundshme për viktimat

Hetimi, regjistrimi dhe ndjekja e saktë e të gjitha elementeve të veprave penale të krimit të urrejtjes për shkak të aftësisë së kufizuar duhet të kontribuojnë për përmirësimin e vizibilitetit të përvojës së viktimës në nivel kombëtar. Nevojat për qasje për viktimat me aftësi të kufizuara intelektuale në lidhje me dhënien e një deklarate dhe, kur është e përshtatshme, për dhënien e dëshmisë duhet të trajtohen gjithashtu në politikat, udhëzimet, trajnimet dhe praktikën kombëtare.

5 Qasja në drejtësi dhe implikimet mbështetëse për viktimat

Ky kre përshkruan disa parime, bazuar në udhëzimet e ODIHR-it, që duhet të merren parasysh nga autoritetet kombëtare për të siguruar mbrojtje, mbështetje dhe qasje në drejtësi për viktimat e krimeve të urrejtjes.

Së pari, duhet të sigurohet që rastet e krimeve të urrejtjes dhe viktimat e krimeve të urrejtjes të identifikohen sa më shpejt që të jetë e mundur në proces dhe që viktimat e krimeve të urrejtjes të njihen si të tilla. Kjo ndihmon që rastet e krimeve të urrejtjes dhe viktimat e krimeve të urrejtjes të identifikohen sa më shpejt që të jetë e mundur gjatë procesit.

Së dyti, duhet të garantohet që viktimat e krimeve të urrejtjes të mund të kërkojnë mbrojtje dhe mbështetje si pasojë e dëmit që kanë pësuar.

Së fundi, duhet të sigurohet që viktimat e krimit të urrejtjes mund të dëgjohen gjatë procesit penal dhe mund të marrin pjesë ose të kenë qasje në procesin penal në mënyrë që të flasin për ndikimin që ka pasur krimi mbi to dhe që gjykata të marrë një vendim për kompensimin nga autori në favor të tyre.¹³¹ Prokurorët luajnë një rol të rëndësishëm për zbatimin e këtyre parimeve. Prandaj është thelbësore që krimet e urrejtjes të cilësohen me saktësi si të tilla, në mënyrë që viktimat të kenë qasje në këto përfitime dhe të drejta.

Nëse veprat që duhet të ndiqen penalisht si krime të urrejtjes nuk cilësohen si të tilla, por cilësohen, për shembull, si vepra bazë pa motiv paragjykimi ose “gjuhë nxitëse”, ato mund të kenë pasoja të rënda mbi të drejtat e viktimave. Ato mund të ndikojnë në të drejtën e viktimave për hetim efektiv, qasje në mbështetje dhe të drejtat për pjesëmarrje. Cilësimi i një çështjeje si vepër bazë, pa përfshirë motivin e paragjykimit si pjesë të ndjekjes penale, i mohon viktimës të drejtën e saj për hetim efektiv që demaskon motivin e paragjykimit. Ndjekja penale e asaj që duhet të jetë një krim urrejtjeje si, për shembull, një nxitje urrejtjeje ose dhune, mund t’i largojë viktimat nga të drejtat e tyre nëse, për shembull, ato nuk mund të tregojnë se janë dëmtuar drejtpërdrejt nga sjellja.

131 OSBE/ODIHR, *Viktimat e Krimit të Urrejtjes në Sistemin e Drejtësisë Penale*, Kreu 3.

Në shtetet anëtare të BE-së, Direktiva e BE-së për të Drejtat e Viktimave¹³² përcakton të drejtat për të gjitha viktimat e të gjitha krimeve. Në veçanti, viktimat do të marrin “një vlerësim në kohë dhe individual” për të përcaktuar nevojat specifike të mbrojtjes në lidhje me cenueshmërinë ndaj viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, frikësimit ose hakmarrjes.¹³³ Vëmendje e veçantë në vlerësimin individual u kushtohet disa kategorive të viktimave. Në këtë drejtim, për shembull, viktimat e krimit të urrejtjes duhet të merren parasysh siç duhet. Direktiva e BE-së për të drejtat e viktimave parashikon gjithashtu të drejtën për rishikim të një vendimi për të mos ndjekur penalisht, në përputhje me rolin e viktimës në sistemin përkatës të drejtësisë penale.¹³⁴

Së fundi, është thelbësore që prokurorët të marrin trajnime të vazhdueshme, me të dhëna nga organizatat mbështetëse të viktimave, në mënyrë që të informohen mbi nevojat specifike të viktimave të krimit të urrejtjes, përfshirë shmangien e riviktimizimit të tyre ose të viktimizimit dytësor gjatë fazës së hetimit dhe procedurave vijuese.

5.1 E DREJTA PËR HETIM EFEKTIV

Neni 14 (ndalimi i diskriminimit) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹³⁵ në lidhje me nenin 2 (e drejta për jetën) u imponon autoriteteve të drejtësisë penale detyrën procedurale që të hetojnë në mënyrë të përshtatshme dhe të demaskojnë motivet e mundshme diskriminuese gjatë kryerjes së veprës penale.¹³⁶ Në terma praktikë, kjo do të thotë se provat e plota të motivit duhet të hetohen dhe t'i sillen në vëmendje gjykatës, përfshirë këtu edhe vetëm kur urrejtja konsiderohet në kontekstin e rritjes së dënimit. Kjo detyrë është zgjeruar në nenin 14 në lidhje me nenet 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues)¹³⁷ dhe 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).¹³⁸

132 Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA (Direktiva e BE-së për të Drejtat e Viktimave), OJ L 315, 14 nëntor 2012, f. 57–73.

133 Neni 22 i Direktivës së BE-së për të Drejtat e Viktimave parashikon që viktimat duhet të marrin “një vlerësim në kohë dhe individual, në përputhje me procedurat kombëtare, për të identifikuar nevojat specifike të mbrojtjes dhe për të përcaktuar nëse dhe në çfarë mase do të përfitojnë nga masat e veçanta përgjatë procesit penal, siç parashikohet në nenet 23 dhe 24, për shkak të cenueshmërisë së tyre të veçantë ndaj viktimizimit dytësor dhe të përsëritur, ndaj frikësimit dhe hakmarrjes” dhe se “vëmendje e veçantë duhet të t’u kushtohet viktimave që ... kanë pësuar një krim të kryer me paragjykim ose motiv diskriminues që mund të lidhet veçanërisht me karakteristikat e tyre personale; ... Në këtë drejtim, viktimat e krimit të urrejtjes, ... duhet të merren parasysh siç duhet.”

134 Neni 11 i Direktivës së BE-së për të Drejtat e Viktimave — Të drejtat në rast të një vendimi për mosndjekje penale.

135 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

136 “Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë”, nr. 43577/98 dhe 43579/98, GJEDNJ, 6 korrik 2005; demaskimi i motiveve të paragjykimit në krime: raste të përzgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, FRA, 2018.

137 “Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë”, Nr. 15250/02, GJEDNJ, 13 dhjetor 2005.

138 “Balázs kundër Hungarisë”, Nr. 15529/12, GJEDNJ, 20 tetor 2015.

5.2 QASJA NË MBËSHTETJE

Të drejtat e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat e krimeve të urrejtjes përfshijnë mbështetje të menjëhershme mjekësore, këshillim psikologjik, ndihmë juridike dhe strehim të sigurt. Udhëzimi i ODIHR-it u bën një sërë rekomandimesh autoriteteve shtetërore përgjegjëse që synojnë të sigurojnë qasje të plotë dhe të hershme të viktimave në mbështetje.¹³⁹ Në veçanti, viktimat e krimit të urrejtjes duhet të njihen si një kategori e veçantë dhe veçanërisht e cënueshme e viktimave, në ligj dhe/ose politika. Kjo përfshin futjen e një përkufizimi të viktimës së krimit të urrejtjes dhe përcaktimin e kriterëve për qasje të hershme të viktimës në mbrojtje dhe mbështetje të specializuar. Kjo do të thotë që viktimat duhet t'i kenë këto të drejta pavarësisht nëse e raportojnë apo jo krimin dhe nëse çështja përparon apo jo përmes procesit të drejtësisë penale. Në lidhje me shtetet anëtare të BE-së, sipas nenit 8 të Direktivës së BE-së për të Drejtat e Viktimave,¹⁴⁰ qasja në shërbimet mbështetëse nuk varet nga ankesa formale e viktimave në lidhje me një vepër penale pranë një autoriteti kompetent.

Prokurorët duhet të jenë të ndërgjegjshëm se, pavarësisht se viktimat mund të kenë të drejtën për mbështetje edhe pa bërë një ankesë formale, disa faktorë mund të kufizojnë mundësinë e tyre për ta përdorur këtë të drejtë. Së pari, policia dhe autoritetet e tjera që fillimisht bashkëveprojnë me viktimat e krimit të urrejtjes mund të mos informohen ose të mos komunikojnë disponueshmërinë e shërbimeve mbështetëse. Për më tepër, mund të ketë procese të pamjaftueshme referimi tek shërbimet e specializuara mbështetëse, shoqëruar me një disponueshmëri shumë të kufizuar të këtyre shërbimeve të specializuara për viktimat e krimeve të urrejtjes.¹⁴¹ Prokurorët mund të luajnë një rol të rëndësishëm për të kontrolluar nëse viktimat janë referuar në shërbimet mbështetëse dhe për vlerësimin dhe përmbushjen e nevojave përkatëse për qasje ose mbrojtje.¹⁴²

5.3 QASJA NË TË DREJTAT E PJESËMARRJES

Udhëzimi i ODIHR-it u bën një sërë rekomandimesh autoriteteve shtetërore përgjegjëse që synojnë të sigurojnë të drejtat e viktimave si palë në proces, aty ku ato garantohen në legjislacionin kombëtar. Viktimat e krimeve të urrejtjes duhet gjithashtu të kenë qasje efektive dhe të hershme në proceset penale për t'u mundësuar atyre që, të paktën, të paraqesin dëmin që kanë pësuar dhe të marrin një vendim kompensimi.

139 OSBE/ODIHR, *Viktimat e Krimit të Urrejtjes në Sistemin e Drejtësisë Penale*, Kreu 3..

140 Direktiva e BE-së për të Drejtat e Viktimave.

141 Gjendja e Strukturave Mbështetëse dhe Shërbimeve të Specializuara për Viktimat e Krimit të Urrejtjes, Raporti Bazë, OSBE/ODIHR, 22 tetor 2020.

142 OSBE/ODIHR, *Viktimat e krimit të urrejtjes në sistemin e drejtësisë penale*, f. 112.

Në sistemet e së drejtës zakonore, të drejtat procedurale dhe të pjesëmarrjes për viktimat e krimeve të urrejtjes janë zakonisht të kufizuara. Shteti ndjek penalisht krimet dhe viktimat zakonisht nuk e kanë të drejtën për të marrë pjesë drejtpërdrejt në proces gjyqësor. Megjithatë, viktimat mund të japin dëshmi dhe të paraqesin deklarata të ndikimit gjatë dënimit. Një shembull është Ligji i të Drejtave të Viktimave i Kanadasë,¹⁴³ i cili i lejon viktimat të japin dëshmi dhe të kërkojnë kompensim pa marrë pjesë drejtpërdrejt në ndjekje penale.¹⁴⁴

Nga ana tjetër, në sistemet e së drejtës kontinentale ose civile, viktimat shpesh kanë të drejta më të forta pjesëmarrjeje, duke i lejuar ato të veprojnë si palë e dëmtuar, të bashkohen me prokurorinë dhe të kërkojnë kompensim. Për shembull, në Gjermani, viktimat e krimeve të dhunshme mund të bashkohen si prokurorë privatë ndihmës, duke u dhënë atyre të drejtën për të marrë pjesë në gjykim dhe për të ndikuar në proces.¹⁴⁵

Duke iu kthyer rastit studimor të dhënë në seksionin 4.4.1, ato që dukeshin se ishin sulme të motivuara nga paragjykimet ndaj një çifti homoseksual u cilësuan si shqetësim (vandalizëm) sipas nenit 339 të Kodit Penal. Për akuzën e “shqetësimit”, elementi përbërës i krimit është shfaqja e sjelljeve që mund të shkaktojnë zemërim apo alarm tek të tjerët dhe, duke qenë kështu, nuk ka viktima të drejtpërdrejta. Me këtë akuzë, viktimat humbën çdo qasje në drejtësi dhe të drejta procedurale. Nëse krimi do të ishte cilësuar saktë sipas nenit 216, Dhuna kundër një anëtarit të komunitetit, individët e synuar në këtë rast do të kishin qasje në këto të drejta.

143 Ligji i të Drejtave të Viktimave i Kanadasë.

144 OSBE/ODIHR, *Viktimat e krimit të urrejtjes në sistemin e drejtësisë penale*, f. 136.

145 Po aty, f. 137.

6 Zhvillimi i të dhënave dhe politikave

Siç shpjegohet në Kreun 1, cilësimi i saktë i veprave të urrejtjes nga prokurorët do të çojë në pasqyrim më të mirë të krimeve të urrejtjes në statistika, politika, të dhënat e policisë dhe të dhënat e raportimit të ODIHR-it, si dhe në përmirësimin e përgjigjeve strategjike nga autoritetet kombëtare, veçanërisht shërbimet e prokurorisë. Cilësimi i gabuar i veprave prodhon të dhëna hetimi dhe të ndjekjes penale që krijojnë një pamje jo të saktë të natyrës, shtrirjes dhe nivelit të veprave të urrejtjes, duke çuar në politika, përgjigje ligjore dhe praktike të keqinformuara. Në praktikë, kjo mund të çojë në uljes së përparësisë së angazhimit të komunitetit me shërbimet e mbrojtjes së viktimave.

Forcat e rendit, prokurorët dhe gjykatat duhet të punojnë së bashku për të identifikuar nëse dhe se si rastet e krimeve të urrejtjes regjistrohen dhe cilësohen gabimisht si raste të “gjuhës së urrejtjes”, si dhe gabime të tjera. Aty ku legjislati kombëtar përdor rritje të përgjithshme të dënimeve për të njohur motivin e paragjykitimit në krimet e urrejtjes, duhet të vendosen sisteme specifike sinjalizimi për të siguruar regjistrimin sa më shpejt të jetë e mundur të krimeve të mundshme të urrejtjes. Kjo punë mund të marrë formën e rishikimeve të rasteve në nivel ndërinstitucional, duke marrë gjithashtu parasysh mbështetjen dhe komunikimin e viktimave, dhe në mënyrë ideale duhet të koordinohen nga profesionistë specialistë, duke u mbështetur në praktikën premtuese të kolegëve të juridiksioneve të tjera. Gjetjet mund të shërbejnë si bazë informimi për punën strategjike për të identifikuar nevojat për trajnim, krahas mangësive në legjislati dhe politika. Kjo punë mund të udhëhiqet nga protokollet specifike të agjencitë dhe ndërmjet agjencive që mbështeten nga drejtuesit e lartë të institucioneve përkatëse.¹⁴⁶

Në varësi të kontekstit institucional, kur ligjet për krimet e urrejtjes janë në proces shqyrtimi në parlament, prokurorët mund të luajnë rol të rëndësishëm për të dhënë prova të mangësive në ligj dhe, për rrjedhojë, në “kutinë e veglave” të ndjekjes penale të përdorur prej tyre. Për shembull, provat e tyre mund të përfshijnë raste që nuk mund të ndiqen penalisht sepse grupe të veçanta nuk janë ende të mbrojtura nga ligjet për krimet e urrejtjes. Informacioni që mund të jepet nga

146 Për detaje të mëtejshme se si të krijohet një sistem i procedurave të standardizuara për regjistrimin e krimeve të urrejtjes, ju lutemi shihni OSBE/ODIHR, [Mbledhja e të Dhënave të Krimit të Urrëjtjes dhe Mekanizmat e Monitorimit](#); shih gjithashtu OSBE/ODIHR, [Paketa Informative kundër Krimeve të Urrëjtjes \(INFACHT\)](#).

prokurorët mund të demonstrojnë gjithashtu vështirësitë për mbledhjen e provave dhe mund të tërheqë efektivisht vëmendjen e gjykatës lidhur me mundësinë për të zbatuar dispozitat për rritjen e përgjithshme të dënimit.

Për shkak të natyrës komplekse, të ndjeshme dhe të profilit të lartë të “gjuhës nxitëse” dhe nevojës për të mbrojtur të drejtat themelore të lirisë së shprehjes, për qartësi juridike është shpesh e nevojshme që këto çështje të shqyrtohen nga gjykatat më të larta. Kjo mund të kërkojë kontribut specifik nga autoritetet e prokurorisë për t'i çuar çështjet në gjykata, aty ku është e përshtatshme, në mënyrë që të marrin këtë udhëzim. Palët e prekura, si viktimat e drejtpërdrejta dhe komunitetet e prekura, do të duhet të konsultohen plotësisht në mënyrë që të menaxhohen pritshmëritë.

7 Rekomandime

Siç është theksuar përgjatë të gjithë këtij udhëzuesi, krimet e urrejtjes dhe “gjuha e urrejtjes” si vepër penale janë konceptualisht, juridikisht dhe praktikisht të dallueshme. Kjo është një fushë praktike komplekse, e cila kërkon kuadre të qarta ligjore, udhëzime dhe trajnime për të gjithë personat e përfshirë në identifikimin dhe reagimin ndaj krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale, dhe veçanërisht në kryqëzimin midis këtyre dy fushave. Roli i prokurorit është thelbësor në këto përpjekje. Ky kre përmbledh pikat kyçe të përfshira në udhëzues për t’u ardhur në ndihmë profesionistëve dhe politikëbërësve dhe plotëson udhëzimet ekzistuese për:

- zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve për krimet e urrejtjes;¹⁴⁷
- krijimin e politikave dhe shërbimeve gjithëpërfshirëse për mbështetjen e viktimave;¹⁴⁸
- trajnime, politika dhe procedura për të mbështetur ndjekjen penale efektive të krimet e urrejtjes;¹⁴⁹ dhe
- zbatimin e kuadreve të regjistrimeve dhe mbledhjes së të dhënave të krimeve të urrejtjes.¹⁵⁰

LIGJVËNËSIT

- Rishikimi i legjislacionit aktual për krimet e urrejtjes me synimet për:
1) sigurimin e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës, të qartë dhe të njëtrajtshëm për krimin e urrejtjes, i cili i lejon prokurorët dhe gjykatat të njohin motivet e paragjykitimit në të gjitha krimet e urrejtjes dhe të vendosin sanksione në përputhje me rrethanat; dhe 2) bërjen e një dallimi të qartë midis krimit të urrejtjes dhe dispozitave të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale.

147 OSBE/ODIHR, [Ligjet për krimin e urrejtjes](#).

148 OSBE/ODIHR, [Viktimat e Krimit të Urrejtjes në Sistemin e Drejtësisë Penale](#).

149 OSBE/ODIHR, [Ndjekja e krimeve të urrejtjes](#).

150 Për detaje të mëtejshme se si të krijohet një sistem i procedurave të standardizuara për regjistrimin e krimeve të urrejtjes, ju lutemi shihni OSBE/ODIHR, [Mbledhja e të Dhënave të Krimit të Urrejtjes dhe Mekanizmat e Monitorimit](#); shih gjithashtu OSBE/ODIHR, [Paketa Informative kundër Krimeve të Urrejtjes \(INFAHCT\)](#).

POLITIKËBËRËSIT

- Sigurimi i koordinimit ndërmjet palëve të interesit, përfshirë autoritetet e ndjekjes penale dhe avokatët që punojnë me çështjet e krimeve të urrejtjes, kur hartohen dhe zbatohen politika dhe strategji gjithëpërfshirëse për krimin e urrejtjes për të rritur efektivitetin e reagimit kombëtar ndaj krimit të urrejtjes.
- Ndarja e krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale në strategjitë kombëtare, planet e veprimit dhe politikat përkatëse, si planet kombëtare të veprimit kundër racizmit dhe krimit të urrejtjes.
- Sigurimi i politikave efektive për organet e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjykatat për të siguruar regjistrimin e krimit të urrejtjes dhe veprës penale të “gjuhës së urrejtjes” si vepra të ndryshme.

AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE TË NDEKJES PENALE

- Rishikimi i procedurave ekzistuese standarde të funksionimit të përbashkëta për policinë dhe prokurorët për të marrë parasysh ndikimet praktike të identifikuar në këtë udhëzues, përfshirë mënyrën se si të bëhet dallimi midis krimit të urrejtjes dhe “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale në mënyrë të saktë.
- Zbatimi dhe përshtatja e Pemës së Vendimmarrjes së Prokurorit të paraqitur në këtë udhëzues për përdorim në nivel kombëtar.
- Mbështetja e koordinimit të ngushtë ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve të prokurorisë.
- Shqyrtimi i zbatimit të një reagimi të centralizuar ndaj krimit të urrejtjes dhe referime të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale që mbështeten nga një rrjet specialistësh të trajnuar.
- Harmonizimi i nevojave dhe të drejtave të viktimave gjatë gjithë hetimit dhe procesit gjyqësor.
- Përdorimi i shembujve dhe të dhënave të rasteve për të theksuar mangësitë në kuadrin ligjor kombëtar që kanë të bëjnë me krimin e urrejtjes dhe t'i ndajnë këto gjatë proceseve përkatëse të politikave dhe ligjbërjes.

ORGANIZATAT NDËRQEVERITARE PARTNERE

- ONQ-të që kanë mandat për të punuar me “gjuhën e urrejtjes” duhet të shqyrtojnë mundësinë për ta shfrytëzuar këtë udhëzues për të zhvilluar udhëzime plotësuese për ndjekjen penale të “gjuhës së urrejtjes” si vepër penale.

SHOQËRIA CIVILE

- Përdorimi i këtij udhëzuesi në veprimtaritë e vazhdueshme të avokimit, mbështetjes së viktimave dhe rritjes së kapaciteteve për të siguruar ligje, politika dhe praktikë të përshtatshme dhe efektive në këtë fushë.

Shtojcë: Standardet ndërkombëtare dhe burime mbi “gjuhën e urrejtjes” si vepër penale

STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Neni 20(2) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP)¹⁵¹

2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohej me ligj.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KNEDC), neni 4¹⁵²

Shtetet Palë (a) Do të deklarojnë një vepër të dënueshme me ligj ... nxitjen e diskriminimit racor, si dhe të gjitha aktet e dhunës ose nxitjes për akte të tilla kundër çdo race ose grupi personash me ngjyrë ose origjinë etnike tjetër ...

Vendimi Kuadër i Këshillit Evropian 2008/913/JHA për luftimin e formave të caktuara dhe shprehjes së racizmit dhe ksenofobisë me anë të së drejtës penale, Neni 1¹⁵³

1. Çdo shtet anëtar do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që sjellja e mëposhtme e qëllimshme të jetë e dënueshme:
 - (a) **nxitja publike për dhunë ose urrejtje drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi të tillë** të përcaktuar për shkak të racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike;
 - (b) [...]
 - (c) tolerimi, mohimi ose minimizimi i konsiderueshëm publik i krimeve të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës siç përkufizohen në nenet 6, 7 dhe 8 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale,

151 OKB, [CNDKP](#).

152 OKB, [KNEDC](#).

153 Këshilli Evropian i BE-së, [Vendimi Kuadër 2008/913/JHA](#).

drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi të tillë të përcaktuar për shkak të racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike **kur sjellja kryhet në një mënyrë që ka gjasa të nxisë dhunën ose urrejtjen kundër një grupi të tillë ose një anëtar të një grupi të tillë;**

- (d) tolerimi, mohimi ose minimizimi i konsiderueshëm publik i krimeve të përcaktuara në nenin 6 të Kartës së Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar bashkëlidhur Marrëveshjes së Londrës të 8 gushtit 1945, drejtuar kundër një grupi personash ose një anëtar të një grupi të tillë të përcaktuar në bazë të racës, ngjyrës, fesë, prejardhjes ose origjinës kombëtare ose etnike **kur sjellja kryhet në një mënyrë që mund të nxisë dhunë ose urrejtje ndaj një grupi të tillë ose një anëtar të një grupi të tillë.**

Rekomandimi CM/Rec(2022)16 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për luftën kundër “gjuhës së urrejtjes”, Këshilli i Evropës¹⁵⁴

E drejta penale

- 11. Shtetet Anëtare duhet të specifikojnë dhe të përcaktojnë qartë në legjislacionin e tyre penal kombëtar se cilat shprehje të “gjuhës së urrejtjes” i nënshtrohen përgjegjësisë penale, si p.sh.:
 - a) nxitja publike për të kryer gjenocid, krime kundër njerëzimit ose krime lufte;
 - b) nxitje publike për urrejtje, dhunë ose diskriminim;
 - c) kërcënime raciste, ksenofobike, seksiste dhe LGBTI-fobike;
 - d) fyerje publike raciste, ksenofobike, seksiste dhe LGBTI-fobike në kushte të tilla si ato të përcaktuara posaçërisht për fyerjet në internet në Protokollin Shtesë të Konventës për Krimin Kibernetik në lidhje me kriminalizimin e akteve të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike (ETS Nr. 189);
 - e) mohimi, minimizimi dhe tolerimi publik i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës; dhe
 - f) përhapja e qëllimshme e materialit që përmban shprehje të tilla të “gjuhës së urrejtjes” (të renditura në pikat a-e më lart), përfshirë idetë e bazuara në epërsinë racore ose urrejtje.

154 Këshilli i Evropës, [Rekomandimi për Luftimin e Gjuhës së Urrejtjes](#).

Protokolli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik, për penalizimin e akteve me natyrë raciste dhe ksenofobe të kryera nëpërmjet sistemeve kompjuterike, Këshilli i Evropës¹⁵⁵

Neni 2 – Përkufizimi

1 Për qëllimet e këtij Protokoll: "material racist dhe ksenofobik" është çdo material i shkruar, çdo imazh ose përfaqësim tjetër i mendimeve ose teorive, që favorizon, përhap ose nxit urrejtje, diskriminim ose dhunë kundër çdo individi ose grupi individësh, bazuar mbi racën, ngjyrën, prejardhjen, origjinën kombëtare ose etnike, si edhe fenë, nëse përdoret si pretekst për çdonjërin nga këta faktorë.

[...]

Neni 3 – Shpërndarja e materialeve raciste dhe ksenofobike në një sistem kompjuterik

1 Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislativë, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si vepër penale, sipas ligjit të brendshëm, sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:- shpërndarjen ose ndryshe bërjen publike nëpërmjet një sistemi kompjuterik të materialeve raciste dhe ksenofobike..

[...]

Neni 4 – Kërcënimi me motive racizmi dhe ksenofobie

1 Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislativë, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si vepër penale, sipas ligjit të brendshëm, sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:- kërcënimin, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, me kryerjen e një veprë të rëndë penale sipas parashikimit në ligjin e brendshëm, (i) të personave për arsyen se i përkasin një grupi, të dalluar nga raca, ngjyra, prejardhja, origjina kombëtare ose etnike, si dhe feja, kur përdoret si pretekst për njërin nga këta faktorë, ose (ii) të një grupi personash që dallohet nga njëra prej këtyre karakteristikave.

Neni 5 – Fyerje me motive racizmi dhe ksenofobie

1 Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislativë, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si vepër penale, sipas ligjit të brendshëm, sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:- fyerjen, nëpërmjet një sistemi kompjuterik, publikisht, (i) të personave për arsyen se i përkasin një grupi, të dalluar nga raca, ngjyra, prejardhja, origjina kombëtare ose etnike, si dhe feja, kur përdoret

155 Këshilli i Evropës, [Protokolli Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik](#).

si pretekst për njërin nga këta faktorë, ose (ii) të një grupi personash që dallohet nga njëra prej këtyre karakteristikave

[...]

Neni 6 – Mohimi, minimizimi i konsiderueshëm, aprovimi ose justifikimi i gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit

1 Çdo shtet palë ndërmerr masa legjislative, si dhe masa të tjera, të nevojshme për të përcaktuar si vepër penale sipas ligjit të brendshëm sjelljen e mëposhtme, kur kryhet me qëllim dhe pa të drejtë:- shpërndarjen ose ofrimin në publik nëpërmjet një sistemi kompjuterik të materialit që mohon, minimizon në mënyrë të konsiderueshme, aprovon ose justifikon akte që përbëjnë gjenocid ose krime kundër njerëzimit, sipas të drejtave ndërkombëtare dhe të njohura si të tilla me vendime të formës të prerë dhe të detyrueshme të Gjykatës Ndërkombëtare Ushtarake, të krijuara nga Marrëveshja e Londrës e 8 prillit 1945 ose të ndonjë gjykate tjetër ndërkombëtare, të krijuar me instrumentet përkatëse ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është njohur nga ky shtet palë.

BURIME TË TJERA

Plani i Veprimit i Rabatit¹⁵⁶ mbi ndalimin e thirrjeve për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë bashkon përfundimet dhe rekomandimet e disa seminareve të ekspertëve të ZKLDNJ-së (të mbajtura në Gjenevë, Vjenë, Nairobi, Bangkok dhe Santiago të Kilit). Duke e bazuar debatin në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, objektivi ka qenë i trefishtë:

- të përftohet një kuptim më i mirë të modeleve legjislative, praktikave dhe politikave gjyqësore në lidhje me konceptin e nxitjes së urrejtjes kombëtare, racore ose fetare, duke garantuar respektimin e plotë të lirisë së shprehjes siç përshkruhet në nenet 19 dhe 20 të Paktit Ndërkombëtar për Të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP);
- të arrihet në një vlerësim gjithëpërfshirës të gjendjes së zbatimit të ndalimit të nxitjes në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe;
- të identifikohen veprimet e mundshme në të gjitha nivelet.

Plani i Veprimit i Rabatit u miratua nga ekspertët në takimin përfundimtar në Rabat më 4-5 tetor të vitit 2012.

156 OKB ZKLDNJ, [Plani i Veprimit i Rabatit](#).

Parimet e Camden-it mbi Lirinë e Shprehjes dhe Barazinë, “Parimet e Camden-it”,¹⁵⁷ u përgatitën nga ARTICLE 19 mbi bazën e diskutimeve që përfshinin një grup zyrtarësh të nivelit të lartë të OKB-së dhe të tjerë, si dhe të shoqërisë civile dhe ekspertëve akademikë në fushën e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut mbi lirinë e shprehjes dhe çështjet e barazisë. Parimet përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet Lirisë së Shprehjes dhe Barazisë dhe “përfaqësojnë një interpretim progresiv të ligjit dhe standardeve ndërkombëtare, praktikës së pranuar të shtetit (siç pasqyrohet, ndër të tjera, në ligjet kombëtare dhe vendimet e gjykatave kombëtare) dhe parimeve të përgjithshme të ligjit të njohur nga bashkësia e kombeve”.

Kursi në internet i Këshillit të Evropës për Luftën kundër “gjuhës së urrejtjes”

Paketa e Këshillit të Evropës për Gjuhën e të Drejtave të Njeriut

Paketa e ZKLDNJ-së e Besimit për të Drejtat

Rekomandimet 7 dhe 15 të Politikave të Përgjithshme të ECRI-t¹⁵⁸

157 Neni 19, [Parimet Camden-it mbi Lirinë e Shprehjes dhe Barazinë](#).

158 Rekomandimet 7 dhe 15 të Politikave të Përgjithshme të ECRI-t.